Tabela e përmbajtjes

Lista e akronimeve dhe përkufizimeve 4
Hyrje....6
I. Konteksti i Programit....6
1.1. Arsyetimi....6
1.2. Objektivat e Programit 7
1.3. Përmbajtja e Programit 7
1.3.1. Përmbajtja e Programit dhe skema e zbatimit....7
1.3.2. Entet e pranueshme 8
1.3.3. Investime të pranueshme 8
II. Qasja e Programit ndaj menaxhimit të riskut MS 8
2.1. Risqet dhe ndikimet MS....8
2.2. Standardet Mjedisore dhe Sociale 9
2.3. Qasja e AFD-së ndaj MRMS 13
2.3.1. Parimet e AFD-së për MRMS për projektet e financuara drejpërdrejt....14
2.3.2. Parimet e AFD-së për MRMS për projektet e ndërmjetësuara 15
2.3.3. Parimet e AFD-së për MRMS për asistencë teknike 16
2.4. Qasja e Proparco-s ndaj MRMS....17
2.4.1. Parimet e Proparco-s për MRMS për projektet e financuara drejtpërdrejt 17
2.4.2. Parimet e Proparco-s për MRMS për projektet me ndërmjetësim 18
2.4.3. Parimet e Proparco-s për MRMS për asistencë teknike 19
2.5 Qasja e GIZ-it ndaj MRMS....19
III. Skema e Menaxhimit të Riskut MS për Programin 21
3.1. MRMS në nivel Projektesh për projekte të financuara drejtpërdrejt 22
3.1.1 Identifikimi 22
3.1.2. Udhëzimi 25
3.1.3. Zotimi....25
3.1.4. Mbikëqyrja 28
3.1.5. Vlerësimi mbas 28
3.2 MRMS në nivelin e Projekteve për projektet me ndërmjetësim 29
3.2.1. Identifikimi 29
3.2.2. Udhëzimi 30
3.2.3. Zotimi....32

3.2.4. Mbikëqyrja 35
3.2.5. Vlerësimi mbas 36
3.3. MRMS në nivelin e Nënprojekteve 36
3.3.1. Masat mbrojtëse të zbatueshme 37
3.3.2. Kriteret për vlerësimin e riskut 37
3.3.3. PVMS e pritshme sipas kategorive të riskut 37
3.3.4. Lista me treguesit e risqeve dhe ndikimeve MS për secilin sektor të pranueshëm në Program 38
3.4. Çështje MS të veçanta 40
3.4.1. Zhvendosja e Pavullnetshme 40
3.4.2. Popujt Autoktonë 40
3.4.3. Ruajtja e biodiversitetit dhe kontrolli i ndotjes 41
3.4.4. Marrëdhëniet e punës dhe shëndeti e siguria e komunitetit 41
3.4.5. Trashëgimia Kulturore 41
IV. Ndarja e informacionit, angazhimi i palëve të interesit dhe zgjidhja e ankesave 42
4.1. Angazhimi i palëve të interesit dhe ndarja e informacionit 42
4.1.1. Qasja e AFD-së për angazhimin e palëve të interesit dhe ndarjen e Informacionit 42
4.1.2. Qasja Proparco për angazhimin e palëve të interesit dhe ndarjen e informacionit 42
4.1.3. Qasja për Programin 43
4.2. Mekanizmat e zgjidhjes së ankesave MS 44
4.2.1. Mekanizmi i ankesave MS i AFD-së dhe Proparco-s 44
4.2.3. Mekanizmat e ankesave të GIZ-it në nivelin e entit zbatues 45
4.2.3. Mekanizmat e ankesave në nivel Projekti dhe Nënprojektesh 45
V. MRMS në nivelin e Asistencës Teknike 46
5.1. Përmbajtja e Programeve të Asistencës Teknike MS 46
5.2. Procesi i rekrutimit të AT-së 46
5.3. MRMS në nivelin e “projektit të politikës” 47
Shtojcat 48
Shtojca 1 – Lista e Përjashtimit e AFD-së 48
Shtojca 2 – Model i Planit të Veprimit MS për ndërmjetësit financiarë të financuar nga AFD-ja 50
Shtojca 3 – Modeli tregues për raport vjetor të monitorimit MS për projektet me ndërmjetësim 52
Shtojca 4 – Skica trueguese e Vlerësimit të Ndikimit MS (VNMS) 56
Shtojca 5 – Skica treguese e Planit të Menaxhimit MS (PMMS) 58
Shtojca 6 – Kuadri i Politikës së Zhvendosjes 60

Shtojca 7 – Kushtet e Referencës dhe TR për Plan Veprimi për Zhvendosje (PVZh) ose Plan të Rikthimit të Mjeteve të Jetesës (PRMJ) 68
Shtojca 8 – Kuadri i Planifikimit për Popujt Autoktonë.....72
Shtojca 9 – Skica treguese e Planit të Popujve Autoktonë (PPA) 76
Shtojca 10 – Skica treguese e angazhimit të palëve të interesuara.....79
Shtojca 11 _ Modeli i Planit të Zotimit Mjedisor dhe Social (PAMS) 80
Shtojca 12_ Udhëzime për raportin e monitorimit Mjedisor dhe Social 81

Lista e akronimeve dhe përkufizimeve

'Projekt' ose 'Projekte'	**Nënkupton partneritetin mes AFD-së ose PROPARCO-s dhe një enti vendor publik ose privat, që do të thotë lehtësim financues dhe/ose lehtësim për asistencë teknike, që do të financohet në kuadër të Programit.**
'Nënprojekte'	**Nënkupton huat e dhëna nga një EZ për kompanitë vendore në kuadër të Programit**
'Programi'	**Nënkupton të gjithë nismën AFD-FKGj 'Program për Efiçencën e energjisë në ndërtesa dhe ftohjes ("PEEB Cool")'**
AFD	*Agencie Française de Développement* (Agjencia Franceze për Zhvillim)
Grupi AFD	Grupi AFD përmbledh (i) AFD-në, institucion financimi publik francez, (ii) Proparco-n, Institucion financiar zhvillimi që nxit investimet private
MLK	Marrëveshje për Lehtësim Kreditimi
MS	Mjedisor dhe Social
PVMS	Plan Veprimi Mjedisor dhe Social Nënkupton një seri aktivitetesh për t'u zbatuar nga një EZ për të ngritur kapacitete dhe për të përmirësuar organizimin e brendshëm për menaxhimin e risqeve MS në përputhshmëri me kërkesat e Programit
PZMS	Plan Zotimi Mjedisor dhe Social
PVMS	Proces vlerësimi i kujdesshëm MS / Due diligence
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social Nënkupton instrumentin për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme MS të një projekti të propozuar, vlerësimin e alternativave dhe hartimin e masave të duhura për zbutjen, menaxhimin dhe monitorimin
KMMS	Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social Nënkupton instrumentin që kontrollon risqet dhe ndikimin kur projekti përbëhet nga një program dhe/ose një seri nënprojektesh, dhe risqet e ndikimet nuk mund të përcaktohen deri sa të identifikohen hollësitë e programit ose nënprojektit. KMMS-ja përcakton parimet, rregullat, udhëzimet dhe procedurat për vlerësimin e risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale. Ai përmban masa dhe plane për të reduktuar, zbutur dhe/ose mënjanuar risqe dhe ndikime të padëshirueshme, dispozita për përllogaritjen dhe buxhetimin e kostove për masa të tilla dhe informacion mbi agjencinë ose agjencitë përgjegjëse për adresimin e risqeve dhe ndikimeve të projekteve, përfshirë dhe kapacitetin e tij për të menaxhuar risqe dhe ndikime mjedisore dhe sociale. Përmban informacion të mjaftueshëm për zonën në të cilën mendohet të vendosen nënprojektet, përfshirë çfarëdo dobësie të mundshme mjedisore dhe sociale në zonë; dhe mbi ndikimet e mundshme që mund të ndodhin dhe masat zbutëse që pritet të përdoren
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social Nënkupton instrumentin që detajon (a) masat që duhet të merren gjatë zbatimit dhe veprimtarisë së një projekti për të shmangur ose mënjanuar ndikime të padëshirueshme MS, ose për t'i reduktuar ato në nivele të pranueshme; dhe (b) veprimet që nevojiten për të zbatuar këto masa
SMMS	Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social Nënkupton të gjitha procedurat, mjetet, proceset dhe masat e kapacitetet organizative të ngritura nga një organizatë për të

	menaxhuar çështjet MS dhe në veçanti risqet MS.
MRMS	Menaxhimi i Riskut Mjedisor dhe Social
RKMS	Raporti i Kontrollit Mjedisor dhe Social
NF	Ndërmjetës/it financiarë Nënkupton institucionet financiare si bankat, institucionet e mikrofinancës, fondet, etj. të cilat financohen nga AFD-ja nëpërmjet lehtësimit të kredive në kuadrin e projekteve të ndërmjetësuara financiarisht.
PLPI	Pëlqim i lirë, paraprak dhe i informuar
FKGj	Fondi i Klimës së Gjelbër
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GES	Gazet me Efekt Serë
EZ	Ent zbatimi: palë opozitare në kontratë ose transaksion financiar e krijuar në kuadër të Programit. Zotëruesit e projekteve për projektet e pranueshme, institucionet financiare dhe vendet partnere
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
PPA	Plani i Popujve Autoktonë
KPPA	Kuadri i Planifikimit për Popujt Autoktonë
PRMJ	Plani i Rivendosjes së Mjeteve të Jetesës
KPK	Kontributet e Përcaktuara Kombëtare
Proparco	Proparco është Institucion Financiar Zhvillimi zotëruar pjesërisht nga Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD) dhe aksionarë privatë nga vende të zhvilluara dhe kombe në zhvillim.
SP	Standard(e) Performance
PVZh	Plan Veprimi për Zhvendosjen
KPZh	Kuadri i Politikave për Zhvendosjen
PAPI	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit
VSMS	Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social Nënkupton kontrollin sistematik të risqeve dhe ndikimeve e çështjeve mjedisore dhe sociale, lidhur me një politikë, plan ose program, në mënyrë tipike në nivel kombëtar por gjithashtu edhe në zona më të vogla. VSMS-të nuk janë në mënyrë tipike të lidhura me një vendndodhje. Si rrjedhojë, përgatiten së bashku me studimet për projektin dhe veçantitë e vendndodhjes që vlerëson risqet dhe ndikimin e projektit
(P)AT	(Programi) për Asistencë Teknike
TR	Termat/Kushtet e Referencës
OKB	Kombet e Bashkuara

Hyrje

I. Konteksti i Programit

1.1. Arsyetimi

Ndërtimi dhe veprimtaria e ndërtesave janë përgjegjëse për 40% të emetimeve të dyoksidit të karbonit që lidhen me gjithë llojet e energjisë. Ndaj shkarbonizimi i shpejtë i sektorit të ndërtimit duhet të arrijë në synimin 2 gradë, përcaktuar në Marrëveshjen e Parisit (miratuar në konferencën për klimën në Paris (COP21) në dhjetor të vitit 2015).

Ndërsa përparohet drejt shtimit të efiçencës me energjinë në ndërtesa në shumicën e vendeve, përmirësimet nuk po ecin me ritmin e sektorin në rritje dhe kërkesën në ngritje për shërbime energjie. Jeta e ndërtesave varion nga 30-80 vite dhe si rrjedhojë konsumi i energjisë prej tyre dhe emetimet e CO2 mbeten të bllokuara në to për dekada.

Si rrjedhojë e rritjes së popullsisë, urbanizimit të shpejtë dhe zhvillimit ekonomik, kërkesa finale për energji nga ndërtesat parashikohet të rritet 50% deri në vitin 2050 krahasuar me nivelet e vitit 2015 sipas skenarëve të punës si zakonisht. Vetëm kërkesa globale për ftohje pritet të trefishohet deri në vitin 2050. Kjo rritje do të ndodhë kryesisht në vendet e nxehta dhe vendet në zhvillim të shpejtë ku ftohja e ajrit (ajri i kondicionuar) do të arrijë majat.

Nëse vendosen politika gjithëpërfshirëse për efiçencën e energjisë për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese si edhe për pajisjet, hapësira globale e ndërtimeve mund të rritej me 60% deri në vitin 2040 pa çuar në përdorim shtesë energjie.

Prandaj duhet të veprohet. Ndërtesat që ndërtohen tani dhe në të ardhmen duhet të ndjekin standardet më të larta të efiçencës së energjisë.

Për t'u përballur me këtë sfidë dhe për të përmirësuar efiçencën e energjisë të sektorit të ndërtimit, Gjermania dhe Franca nisën Programin për Efiçencën e Energjisë në Ndërtesa (PEEN).

PEEN, ndërmarrë nga Aleanca Globale për Ndërtesat dhe Ndërtimin (GlobalABC), mbështet përpjekjet globale për të përfshirë sektorin e ndërtimit në axhendën e klimës dhe për të forcuar zbatimin e KPK-ve në ndërtesa.

PEEN mbështet vendet për transformimin e sektorit të ndërtimit në to. Në fillim të vitit 2018, ky program nisi veprimtarinë me 5 vende partnere: Meksika, Maroku, Tunizia, Senegali dhe Vietnami dhe vende të tjera kanë shprehur tashmë interesin për të marrë mbështetje nga PEEN-i.

PEEN-i u ofron vendeve partnere mbështetje për zbatimin e politikës, trajnime dhe ndarje njohurie si edhe asistencë financiare për të zbatuar projekte ndërtimi të shkallës së lartë me standarde të larta efiçence në energji.

PEEN-i ka patur kërkesë të lartë për mbështetje nga vende të tjera (Nigeria, Jordania, Ekuadori, Indonezia, etj.) dhe përpiqet të zgjerojë shtrirjen. Vendet e shohin rëndësinë e përmirësimit të kuadrit të politikës për të patur më shumë efiçencë energjie në ndërtesa duke krijuar njëkohësisht Programe për shtysa financiare për ndërtesa me EE.

Buxheti aktual i PEEN-it për veprimtari në nivel politike është caktuar për 5 vendet e para partnere të PEEN-it. Megjithatë, PEEN-i ka nisur mbështetjen dhe financimin e projekteve të ndërtimit të ndërtesave në shkallë të lartë dhe rinovimit përtej 5 vendeve të para partnere. Programi ka nisur tashmë të ofrojë mbështetje dhe financim për 16 projekte dhe programe ndërtimi në shkallë të lartë dhe rinovimi në 11 vende, duke arritur kështu në investim të përgjithshëm prej rreth 900 milion Euro.

Pasi të tregojë efiçencën e tij, programi do të rritet me shkallëzim për të arritur rrjedhën/linjën aktuale të projekteve të identifikuara të ndërtimit në shkallë të lartë dhe të rinovimit, deri në shumën 1.6 miliard Euro në mbi 20 vende (nga të cilat 1.2 miliard Euro në vendet e *PEEN Cool*) dhe të zbatojë nivelin e duhur të politikës dhe veprimtarive teknike për të sjellë transformimin e sektorit të ndërtesave në vendet e synuara. Mbi të gjitha, AFD-ja dëshiron të rrisë përvojën me programin PEEN për të shkuar përtej dhe për të ndërtuar në këtë nismë duke sjellë larmi në sisteme ftohjeje me efiçencë në energji dhe duke zgjeruar gamën gjeografike për të ndihmuar në zhvendosjen e modelit drejt sistemeve me karbon të ulët dhe ndërtesa të qëndrueshme.

1.2. Objektivat e Programit

Objektivat e Programit janë të:

- Transformojë ndjeshëm sektorin e ndërtesave duke nxitur plane dhe ndërtim të qëndrueshëm të ndërtesave;
- Ulë kërkesën për energji në ndërtesa në mënyrë me kosto-efektive si edhe të reduktojë në nivel minimal dhe shmangë sa më shumë që të jetë e mundur emetimet e gazeve me efekt serë;
- Aktivizojë përfitime sociale, ekologjike dhe ekonomike të pashfrytëzuara;
- Nxisë sisteme ftohjeje të pastra.

1.3. Përmbajtja e Programit

1.3.1. Përmbajtja e Programit dhe skema e zbatimit

Ky Program përbëhet nga dy pjesë plotësuese:

1. **Lehtësim financiar** për aktorë publikë dhe privatë dhe shtysa financiare të përshtatura për të nxitur investimet më të mira të ndërtesave të gjelbra. Ky fleksibilitet do të lejohet nga shumëllojshmëria e instrumenteve financuese të përdorura në këtë pjesë. Këto mund të kenë formën e huave, huave koncesionale ose granteve të investimit. Lehtësimi financiar do të kryejë veprimtaritë si më poshtë:
    a. Identifikimin e projekteve të realizueshme të financimit;
    b. Krijimin e rregullimeve financiare për projektet e identifikuara;
    c. Monitorimin dhe mbështetjen teknike të projekteve të financuara.

2. **Lehtësim Politike** për të ndihmuar në transformimin e sektorit të ndërtimit në nivel kombëtar, i përbërë nga:
    a. Zhvillimin e planeve (KPK) në sektorin e ndërtesave;
    b. Përpunimin e propozimeve të politikës për sektorin e ndërtesave;
    c. Zbatimin e masave për ngritje kapacitetesh për profesionistë në sektorin e ndërtesave.

1.3.2. Entet e pranueshme

Entet e pranueshme listohen për secilin përbërës të realizuar nga Programi:

- Lehtësi financiare: të gjithë zotëruesit e projekteve (i) brenda linjës së AFD-së ose PROPARCO-s, (ii) në një prej vendeve të zbatimit të *PEEN Cool*, (iii) projekti i të cilëve përfshin potencial për efiçencë energjie. Enti i pranueshëm mund të jetë kompani e sektorit privat, ministri, institucion publik, institucion financiar publik ose privat.
- Lehtësi politike: çdo organizëm publik (institucion publik, ministri, ente rregullatorë, etj.) nga një prej vendeve të zbatimit të *PEEN Cool* që është aktor në sektorin kombëtar të ndërtesave.

1.3.3. Investime të pranueshme

- Lehtësi financiare: të gjitha projektet (i) brenda linjës së AFD-së ose PROPARCO-s, (ii) në një prej vendeve të zbatimit të *PEEN Cool*, (iii) që përfshijnë ndërtimin/rinovimin e ndërtesave ose përmirësimin e efiçencës së energjisë në industri, dhe (iv) që nuk janë kategorizuar A nga kategorizimi në Grupe i AFD-së për riskun mjedisor dhe social.

II. Qasja e Programit ndaj menaxhimit të riskut MS

2.1. Risqet dhe ndikimet MS

Në përputhje me Kuadrin MS të Grupit të Bankës Botërore, risqet dhe ndikimet MS të marra parasysh nga AFD-ja në procesin e vlerësimit janë të lidhura me projektin dhe përfshijnë si më poshtë:

- **Risqet dhe ndikimet mjedisore, përfshirë**: (i) ato që janë identifikuar në Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë të Grupit të Bankës Botërore (MShSMM); (ii) ato që lidhen me sigurinë e komunitetit (përfshirë sigurinë e digave dhe përdorimin e sigurt të pesticideve); (iii) ato që lidhen me ndryshimin e klimës dhe risqe dhe ndikime të tjera ndërkufitare dhe globale; (iv) çdo kërcënim material ndaj mbrojtjes, ruajtjes, mirëmbajtjes dhe rigjallërimit të habitateve natyrale dhe biodiversitetit; dhe (v) ato që lidhen me shërbimet e ekosistemit dhe përdorimin e burimeve natyrore për jetesë, si për shembull peshkimit dhe pyjet; dhe
- **Risqet dhe ndikimet sociale, përfshirë**: (i) kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore nga rritja e konfliktit, krimit apo dhunës personale, komunitare apo ndër-shtetërore; (ii) risqe që ndikimet e projektit të bien në mënyrë jo të përshkallëzuar në individë dhe grupe të cilët, për shkak të rrethanave të tyre të veçanta, mund të jenë në disavantazh ose të cenueshëm; (iii) çdo paragjykim ose diskriminim ndaj individëve ose grupeve në lejimin e burimeve të zhvillimit dhe përfitimeve të projektit, veçanërisht në rastin e atyre që mund të jenë në disavantazh ose të cenueshëm; (iv) ndikime negative ekonomike dhe sociale lidhur me blerjen e pavullnetshme të tokës ose kufizime në përdorimin e tokës; (v) risqe ose ndikime që lidhen me zotërimin dhe përdorimin e tokës dhe burimeve natyrore, përfshirë (sipas rastit) ndikime të mundshme të projektit në modelet e përdorimit të tokës dhe marrëveshjet e zotërimit, aksesi dhe disponueshmëria e tokës, siguria ushqimore dhe vlerat e tokës, dhe çdo risk korrespondues që lidhet me konflikt apo kontestim për tokën dhe burimet natyrore; (vi) ndikime në shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve dhe komuniteteve që ndikohen nga projekti; dhe (vii) risqe ndaj trashëgimisë kulturore.

2.2. Standardet Mjedisore dhe Sociale

Për Programin *PEEN Cool*, SMMS-të e AFD-së, Proparco-s dhe GIZ-it do të jenë në funksion.
AFD-ja dhe Proparco-ja synojnë të nxisin zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë në të gjitha veprimtaritë e financuara, duke siguruar që këto veprimtari të kontribuojnë në mënyrë të efektshme drejt objektivit të zhvillimit të qëndrueshëm (për të luftuar varfërinë dhe siguruar kënaqjen e nevojave njerëzore, forcimin e solidaritetit mes njerëzve dhe mes territoreve, ruajtjen e biodiversitetit, ruajtjen e habitateve dhe burimeve natyrore, luftën ndaj ndryshimit të klimës).
Të gjitha veprimtaritë e financuara nga AFD-ja dhe Proparco-ja duhet të jenë në përputhshmëri me rregulloret ndërkombëtare të vendit ku zbatohet veprimtaria, përfshirë çështje mjedisore dhe sociale. Megjithatë, duke qenë se rregulloret në vendet ku vepron AFD-ja ndonjëherë janë të paplota ose në zhvillim e sipër, AFD-ja përdor si referencë një sërë rregullash, praktika të mira dhe direktiva të nxjerra nga organizata ndërkombëtare që përcaktojnë standarde dhe të provuara me më shumë se 70 vite përvojë në projekte financimi dhe zhvillimi. Këto përfshijnë kryesisht:
- Politikat e Sigurisë të Bankës Botërore për financimit e sektorit publik;
- Parimet e OKB-së për Investim të Përgjegjshëm (UNPRI);
- Standardet e Performancës të IFC-së.

Konventat ndërkombëtare kryesore të ratifikuara nga vendet ku vepron AFD-ja përdoren gjithashtu si referencë, kryesisht:
- Deklarata Universale për Drejtat e Njeriut e OKB-së;
- Konventat themelore të ILO-s për ligjin e punës;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave;
- Udhëzimet e OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe.

Për sa i përket menaxhimit të riskut MS, Grupi AFD nuk ka standarde të veçanta MS. AFD-ja ka përvetësuar standardet mjedisore dhe sociale operacionele në veprim të Bankës Botërore.[1] Këto standarde vlejnë për projektet me risqe mjedisore dhe sociale të kategorizuara si të larta ose të konsiderueshme. Për veprimtari të tjera, projektet duhet të vlerësohen dhe zbatohen në përputhje me rregullore kombëtare mjedisore dhe sociale në fuqi në vendin ku ndërmerret veprimtaria. Për projektet me risqe madhore MS, Proparco-ja zbaton Standardet e Performancës të IFC-së dhe Shënimet dhe Interpretimet e Udhëzimeve përkatëse[2].

Standardet MS të Referencës për Programin *PEEN Cool* do të jenë legjislacioni kombëtar dhe Standardet e Performancës të IFC-së dhe Shënimet Udhëzuese përkatëse.

Qasja e menaxhimit të riskut ME për Programin ndjek Shënimin e Interpretimit të IFC-së mbi Ndërmjetësuesit Financiarë[3] dhe është në përputhje me Parimet e Ekuatorit[4].
Zbatueshmëria e Standardeve të Performancës të IFC-së për Programin *PEEN COOL* është përmbledhur në Tabelën 1, më poshtë. Ndërsa Shënimi i Interpretimit mbi Ndërmjetësit Financiarë është baza e qasjes së EZ-së ndaj menaxhimit të riskut MS nëse EZ-ja është institucion financiar, Standardet e Performancës së IFC-së janë referenca për projektet dhe nënprojektet dhe do të jenë të zbatueshme për projektet dhe nënprojektet me risk të lartë sipas përkufizimit në këtë manual.

Tabela 1. Zbatueshmëria e Standardeve të Performancës së IFC-së për Programin *PEEN Cool*

Standardet e	Objektivat	Zbatueshmëria për Programin

[1] https://www.worldbank.org/en/projects-operations/environmental-and-social-framework
[2] https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/Topics_Ext_Content/IFC_External_Corporate_Site/Sustainability-At-IFC/Policies-Standards/Performance-Standards
[3] https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/topics_ext_content/ifc_external_corporate_site/sustainability-at-ifc/publications/publications_policy_interpretationnote-fi
[4] https://equator-principles.com/

Performancës të IFC-së		
SP1 – Vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale	○ Të identifikojë dhe vlerësojë risqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit. ○ Të përvetësojë një hierarki zvogëlimi për të parashikuar dhe shmangur, ose aty ku nuk është e mundur shmangia, të minimizojë dhe atje ku ka ndikime nga mbetjet, të kompensojë/mënjanojë rreziqet dhe ndikimet ndaj punonjësve, Komuniteteve të Prekura dhe mjedisit. ○ Të nxisë performancë mjedisore dhe sociale të përmirësuar te klientët nëpërmjet përdorimit të efektshëm të sistemeve të menaxhimit. ○ Të sigurojë se ankesat nga Komunitetet e Prekura dhe nga komunikimet e jashtme nga palë të tjera interesi do të marrin përgjigje dhe do të menaxhohen si duhet. Të nxisë dhe ofrojë mënyra angazhimi të mjaftueshëm me Komunitetet e Prekura gjatë gjithë ciklit të projektit për çështje që mund të ndikojnë tek ata dhe të sigurojë se ndahet dhe përhapet informacioni i duhur mjedisor dhe social.	PO Sektorët e pranueshme për Programin si për shembull industria dhe ndërtesat mund të kenë ndikime MS. SP1 synon të identifikojë risqet dhe ndikimet MS dhe të përkufizojë masat e duhura zvogëluese për projektet dhe nënprojektet me qëllim që të shmangë, minimizojë ose të kompensojë këto risqe. Ai përkufizon gamën përkatëse të menaxhimit të riskut MS për një projekt, kapacitetin e domosdoshëm organizativ dhe proceset e monitorimit. Vëmendje e veçantë është vendosur në angazhimin e palëve të interesit, përfshirë ndarjen e informacionit, konsultimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve, popujve autoktonë dhe mekanizmave të ankesave. EZ-të e mbështetura nga Programi pritet të financojnë vetëm projektet dhe nënprojektet për të cilat ato kanë masat e duhura zbutëse për të menaxhuar risqet dhe ndikimet MS.
SP2 – Marrëdhëniet e Punës dhe Punonjësve	○ Të nxisë trajtimin e drejtë, mos diskriminimin dhe mundësitë e barabartë për punonjësit. ○ Të përcaktojë, ruajë dhe përmirësojë marrëdhënien punonjës-menaxhim. ○ Të nxisë përputhshmërinë me ligjet kombëtare të punësimit dhe të punës. ○ Të mbrojë punonjësit, përfshirë kategoritë e cenueshme të punonjësve si fëmijët, punonjësit migrues, punonjësit e angazhuar nga palët e treta dhe punonjësit në zinxhirin e furnizimit të klientit. ○ Të nxisë kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme dhe të	PO SP2 është në përputhje me konventat dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare, përfshirë ato të ILO-s dhe OKB-së. EZ-të e mbështetura nga Programi duhet të sigurojnë kushtet e duhura të punës dhe punonjësve në organizimin e tyre të brendshëm, por duhet të sigurojnë gjithashtu se projektet dhe nënprojektet që financojnë ata respektojnë kërkesat e SP2, që do të thotë se këto dispozita janë njëlloj të zbatueshme si për klientët e EZ-ve dhe për kontraktuesit e tyre. Kërkesat e SP2 janë të zbatueshme si gjatë fazës së ndërtimit edhe gjatë

	promovojë shëndetin e punonjësve. ○ Të shmangë përdorimin e punës së detyruar.	fazës së zbatimit të Nënprojekteve.
SP3 – Efiçencë burimesh, parandalim dhe reduktim i ndotjes	○ Të shmangë ose minimizojë ndikimet e padëshirueshme mbi shëndetin e njerëzve dhe mbi mjedisin duke shmangur ose minimizuar ndotjen nga veprimtaritë e projektit. ○ Të nxisë përdorim më të qëndrueshëm të burimeve, përfshirë energjinë dhe ujin. ○ Të reduktojë emetimet e GES-ve që lidhen me projektin.	PO Vlerësimi i riskut MS që do të kryhet për projektet dhe nënprojektet duhet të identifikojë ndikimet e mundshme negative të të gjitha llojeve të ndotjes për komunitetet dhe mjedisin, përfshirë edhe përdorimin me tepri të burimit natyror si konsumi i ujit. SP3 është i zbatueshëm në të gjitha projektet që mund të kenë ndikime të tilla dhe nuk kufizohet vetëm në fazën e ndërtimit.
SP4 – Shëndeti, siguria dhe sigurimi i Komunitetit	○ Të parashikojë dhe shmangë ndikime të padëshirueshme në shëndetin dhe sigurinë e Komunitetit të Prekur gjatë jetës së projektit si nga rrethanat rutinë dhe ato jo-rutinë. ○ Të sigurojë se mbrojta e personelit dhe pasurisë kryhet në përputhje me parimet përkatëse të të drejtave të njeriut dhe në mënyrë që shmang ose minimizon risqet ndaj Komuniteteve të Prekura.	PO Sipas SP3, vlerësimi i riskut MS që kryhet për projektet dhe nënprojektet do të marrë parasysh aspektet e shëndetit, sigurisë dhe sigurimit të komunitetit si për zotëruesit e projektet edhe për kontraktuesit e tyre, gjatë gjithë ciklit të kohëzgjatjes së projektit.
SP5 – Blerja i tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme	○ Të shmangë, dhe kur shmangia nuk është e mundur, të minimizojë shpërnguljen duke eksploruar plane alternative projekti. ○ Të shmangë shpronësimin me forcë. ○ Të parashikojë dhe shmangë, ose kur nuk është e mundur shmangia, të minimizojë ndikime të padëshirueshme sociale dhe ekonomike nga përvetësimi i pronës ose kufizimet në përdorimin e tokës duke (i) dhënë kompensim për humbjen e aseteve me koston e zëvendësimit dhe (ii) siguruar se veprimtaritë e zhvendosjes zbatohen duke ndarë informacionin e duhur, konsultime dhe pjesëmarrjen e informuar të	PO Të gjitha nënprojektet duhet të shikojnë shmangien e shpërnguljes, dhe nëse kjo nuk është e mundur, duhet të veprojnë në përputhje me SP5 në kompensimin e komuniteteve dhe personave të prekur. Kjo është e vlefshme për shpërnguljen fizike dhe shpërnguljen ekonomike. Duhet të merren parasysh ndikimet në asete dhe jetesë.

	atyre që janë prekur. ○ Të përmirësojë, ose të rikthejë, jetën dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur. ○ Të përmirësojë kushtet e jetesës së personave të zhvendosur fizikisht nëpërmjet sigurimit të strehimit të përshtatshëm me sigurinë e pronësimit në vendet e zhvendosura.	
SP6 – Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla	○ Të mbrojë dhe ruajë biodiversitetin. ○ Të mirëmbajë përfitimet nga shërbimet e ekosistemit. ○ Të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të gjalla nëpërmjet përvetësimit të praktikave që integrojnë nevojat ruajtëse dhe përparësitë e zhvillimit.	PO Objektiva e Programit është të mbështesë kalimin pa probleme drejt ekonomive miqësore me mjedisin dhe, për këtë, nuk shikon vetëm përshtatjet dhe zvogëlimin e ndryshimit të klimës, por edhe shmangien ose minimizimin e ndikimeve në biodiversitet dhe në burimet natyrore. Kurdo që është e mundur, do të përfshihen në Nënprojekte veprimtari që përmirësojnë ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore të gjalla.
SP7 – Popujt Autoktonë	○ Të sigurojë se procesi i zhvillimit kujdeset për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, dinjitetin, aspiratat, kulturën dhe jetën e bazuar në burime natyrore të Popujve Autoktonë. ○ Të parashikojë dhe shmangë ndikimet e padëshirueshme të projektit në komunitetet e Popujve Autoktonë, ose kur nuk është e mundur shmangia, të minimizojë dhe/ose kompensojë ndikimet e tilla. ○ Të nxisë përfitimet dhe mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm për Popujt Autoktonë në mënyrë të përshtatshme me kulturën e tyre. ○ Të vendosë dhe ruajë marrëdhënie të vazhdueshme bazuar në Konsultime dhe Pjesëmarrje të Informuar (KPI) me Popujt Autoktonë që preken gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. ○ Të sigurojë Pëlqimin e Lirë, Paraprak dhe të Informuar (PLPI)	PO SP7 vlen për të gjitha projektet dhe nënprojektet që mund të kenë ndikime te PA, ndikime të identifikuara nëpërmjet vlerësimit fillestar të riskut MS. Pëlqimi i lirë, paraprak dhe i informuar duhet zbatuar kur PA-të preken nga një projekt në rrethanat e përcaktuara sipas SP7. Kurdo që të jetë e domosdoshme, duhet të hartohen plane të veçanta

	të Komuniteteve të Prekura të Popujve Autoktonë kur janë të pranishme rrethanat e përshkruara në këtë Standard Performance. ○ Të respektojë dhe ruajë kulturën, njohurinë dhe praktikat e Popujve Autoktonë.	
SP8 – Trashëgimia kulturore	○ Të mbrojë trashëgiminë kulturore nga ndikimet e padëshirueshme të veprimtarive të projektit dhe të mbështesë ruajtjen e saj. ○ Të nxisë ndarjen e barabartë të përfitimeve nga përdorimi i trashëgimisë kulturore.	PO SP8 përcakton trashëgiminë kulturore përfshirë objektet dhe vendet e prekshme, si edhe format e paprekshme të kulturës. Vlerësimi fillestar MS i projekteve dhe nënprojekteve duhet të identifikojë nëse preket trashëgimia kulturore dhe, në rast se po, është i zbatueshëm SP8.

2.3. Qasja e AFD-së ndaj MRMS

Qëllimi i qasjes së menaxhimit të riskut MS të AFD-së është të:

- Vlerësojë risqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale për secilin projekt të dorëzuar tek organizmat vendimmarrëse;
- Propozojë masat e duhura për të shmangur, reduktuar, dhe/ose mënjanuar këto risqe dhe ndikime;
- Monitorojë zbatimin e këtyre masave gjatë fazës së zbatimit të punës/operacionit;
- Menaxhojë ngjarje të paparashikuara dhe;
- Përmirësojë cilësinë e projekteve dhe performancën mjedisore dhe sociale të bashkëpunëtorëve/homologëve.

AFD-ja mund të refuzojë të financojë një projekt për arsye mjedisore ose sociale. Në përputhje me Listën e Përjashtimit[5] të AFD-së, ka disa lloje të caktuara veprimtarish që nuk janë të pranueshme për financim për arsye mjedisore dhe sociale. Këto veprimtari janë të renditura me hollësi në Listën e Përjashtimit të AFD-së në Shtojcën 1.

Politikat e Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore, siç janë publikuar dhe në fuqi, janë të zbatueshme për të gjitha projektet me risqe të larta ose të konsiderueshme MS për të cilat kërkohen fonde të AFD-së. Këto standarde mjedisore dhe sociale përcaktojnë parimet me të cilat do të veprojë në përputhshmëri zotëruesi i projektit dhe projekti gjatë gjithë ciklit të kohëzgjatjes së projektit. AFD-ja mund të specifikojë kërkesa shtesë lidhur me projektin për të ndihmuar zotëruesin e projektit të arrijë këto qëllime MS. Përputhshmëria me ligjet kombëtare të vlefshme është pjesë thelbësore e kërkesave të AFD-së.

Zotëruesit e projekteve dhe projektet e tyre duhet gjithashtu të veprojnë në përputhshmëri me detyrimet përkatëse të Udhëzimeve Mjedisore, të Shëndetit dhe të Sigurisë (MShS) të Grupit të Bankës Botërore.

Projektet që kanë të bëjnë me objekte ose veprimtari të reja duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që siguron përputhshmëri të menjëhershme me standardet mjedisore dhe sociale dhe udhëzimet mjedisore, të shëndetit dhe të sigurisë të vendosura nga Grupi i Bankës Botërore.

[5] https://www.afd.fr/en/ressources/exclusion-list-afd-group-foreign-countries

Nëse projekti përfshin objekte ose veprimtari ekzistuese (p.sh. restaurim, rehabilitim ose shtesë/zgjerim) që nuk i përmbushin këto standarde dhe udhëzime në kohën e miratimit nga Bordi i AFD-së, zotëruesi i projektit është i detyruar të marrë masa që vlerësohen si të kënaqshme nga AFD-ja, domethënë që janë të mundshme teknikisht, financiarisht dhe ekonomikisht, në mënyrë që të sillen këto objekte ose veprimtari në përputhje si me standardet mjedisore dhe sociale edhe me udhëzimet mjedisore, të shëndetit dhe të sigurisë brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

2.3.1. Parimet e AFD-së për MRMS për projektet e financuara drejtpërdrejt

Zotëruesi i projektit është përgjegjës për kryerjen e vlerësimit mjedisor dhe social të projektit të tij. Zotëruesi i projektit mobilizon ekspertizën dhe burimet MS të duhura në faza të ndryshme të zbatimit të projektit (përgatitja, ndërtimi, operacioni, çaktivizimi) dhe me kontratë zotohet të përmbushë qëllimet e performancës mjedisore dhe sociale të rëna dakord me AFD-në gjatë procesit të vlerësimit. Zotëruesi i projektit monitoron dhe dokumenton zbatimin e masave të menaxhimit MS gjatë zbatimit të veprimtarive të projektit. Zotëruesi i projektit kërkohet të zbatojë çfarëdo veprimi të domosdoshëm korrigjues nëse vërehet ndonjë avari. AFD-ja duhet të mbahet e informuar për zhvillimet nëpërmjet raporteve periodike të monitorimit.

AFD-ja asiston zotëruesin e projektit në përcaktimin e qëllimeve të perfomancës MS dhe sigurohet për zbatimin e tyre gjatë gjithë ciklit të kohëzgjatjes së projektit. Për këtë arsye, të gjitha kërkesat për financim bërë AFD-së i nënshtrohen kryerjes së procesit të vlerësimit të kujdesshëm mjedisor dhe social. Kjo mundëson vlerësimin nëse projekti ka gjasa të zbatohet sipas objektivave të perfomancës mjedisore dhe sociale të AFD-së. Procesi i vlerësimit MS është integruar nga AFD-ja në rishikimin dhe monitorimin e projektit në tërësi. Procesi artikulohet rreth katër hapave kryesore:

1. Kategorizimi i projektit. Procesi i vlerësimit të kujdesshëm mjedisor dhe social i AFD-së përshtatet me natyrën dhe shkallën e projektit dhe është në proporcion me nivelin e risqeve dhe ndikimeve MS. Për këtë qëllim, në varësi të risqeve të mundshme MS, AFD-ja i klasifikon projektet në katër kategoritë si vijon: Risqe të Larta (A), Risqe të Konsiderueshme (B+), Risqe të Mesme (B) ose Risqe të Ulëta (C).
2. Rishikimi i dokumentacionit të vlerësimit mjedisor dhe social. Në varësi të kategorisë së projektit, AFD-ja përfshihet në hetimin dhe vlerësimin e dokumenteve të vlerësimit mjedisor dhe social dhe mund të kryejë mision në zonën e prekur nga veprimtaritë e projektit me qëllim që të vlerësojë risqet MS.
3. Zotimet mjedisore dhe sociale. AFD-ja e bën financimin të kushtëzuar nga zbatimi i një Plani Zotimi Mjedisor dhe Social (PZMS) që përcaktohet me zotëruesin e projektit dhe i cili do të monitorohet rregullisht gjatë zbatimit të veprimtarive të projektit.
4. Monitorimi MS. Gjatë fazës së zbatimit të projektit, AFD-ja rishikon gjetjet e monitorimit të zotimit mjedisor dhe social. Pas përfundimit të veprimtarisë, AFD-ja mbikëqyr misionin e vlerësimit pas punimeve, në partneritet me zotëruesin e projektit.

Në kuadër të Programit, të gjitha projektet e financuara do t'i nënshtrohen këtij procesi me katër hapa.



Figura 1. MRMS e AFD-së për Financime të drejtpërdrejta

2.3.2. Parimet e AFD-së për MRMS për projektet e ndërmjetësuara

Sa u përket projekteve të financuara nëpërmjet ndërmjetësve financiarë (NF), si për shembull bankat, institucionet e mikrofinancës, fondet e investimit, kompanitë e sigurimit, kompanitë hipotekore, etj., AFD-ja zbaton qasje specifike dhe mbështet ndërmjetësit financiarë partnerë në zbatimin dhe fuqizimin e **Sistemeve të Menaxhimit MS** me qëllim që ato të jenë në përputhshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Objektivat e një qasjeje të tillë janë të sigurohet që NF-të e financuara të jenë në gjendje të menaxhojnë risqet MS në portofolin e tyre dhe që menaxhimet e tyre të brendshme MS të jenë të kënaqshme nga ana sociale, domethënë në përputhje me legjislacionin vendor, dhe nëse është e mundur, të orientuara drejt praktikave më të mira MS të brendshme, me qëllim që të kufizohen risqet ligjore, financiare dhe ato të reputacionit dhe të marrin pjesë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo qasje specifike sipas nevojave është së pari e bazuar në analizën e nivelit të risqeve MS në portofolin e NF-së: prandaj vlerësimi i riskut MS nuk kufizohet në risqet MS që mund të shkaktohen nga projekti i financuar nga AFD-ja. Për sa i përket financimit të drejtpërdrejtë, procesi i vlerësimit të kujdesshëm MS integrohet nga AFD-ja në rishikimin dhe monitorimin e projektit në tërësi, dhe procesi artikulohet rreth katër hapave kryesorë:

1. Kategorizimi i projektit. Bazuar në nivelin e riskut MS të portofolit të NF-së, AFD-ja i klasifikon projektet në tri kategoritë e mëposhtme: **NF-A (Portofol me Risk të Lartë MS), NF-B (Portofol me Risk të Mesëm MS)** ose **NF-C (Portofol me Risk të Ulët MS)**. Këto kategori nuk reflektojnë kapacitetin e NF-së për të menaxhuar risqet MS me portofolin e tyre, gjë që do të jetë thelbësore për PVMS-në vijuese. Megjithatë, kategoria e riskut MS përcakton:
   - Nivelin e analizës së sistemit të menaxhimit MS të NF-së që duhet të kryhet;
   - Nivelin e kërkesës së AFD-së në lidhje me NF-në për sa i përket menaxhimit MS;
   - Nivelin e monitorimit MS që duhet të zbatohet gjatë projektit.
2. Rishikimi i dokumentacionit të vlerësimit mjedisor dhe social. Në varësi të kategorisë së riskut të projektit (NF-A, NF-B, or NF-C), eksperti MS i AFD-së kryen një rishikim shterues të SMMS-së së NF-së nëpërmjet analizës së procedurave dhe mjeteve MS dhe zbatimit të tyre

në veprim, kuadrin organizativ për MRMS, politikat garantuese dhe standardet MS të zbatuara, kuadrin ligjor kombëtar, etj.

3. Zotime mjedisore dhe sociale. Për projektet NF-A dhe NF-B, nëse identifikohen boshllëqe mes kërkesave të AFD-së dhe SMMS të NF-së, AFD-ja e bën financimin me kusht bazuar në zbatimin e një Plani Veprimi Mjedisor Social (PVMS) që përcaktohet me zotëruesin e projektit, dhe i cili do të monitorohet rregullisht gjatë zbatimit të veprimtarive të projektit. PVMS-ja synon fuqizimin e SMMS-së së NF-së me qëllim përputhshmërinë me kërkesat e AFD-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
4. Monitorim MS. Gjatë fazës së zbatimit të projektit, AFD-ja rishikon gjetjet e monitorimit të zotimeve mjedisore dhe sociale. Pas përfundimit të veprimtarisë, AFD-ja mbikëqyr misionin e vlerësimit pas përfundimit të punimeve, në partneritet me zotëruesin e projektit.

Si rrjedhojë, AFD-ja u kërkon ndërmjetësve financiarë partnerë, në të njëjtën qasje që AFD-ja zbaton për projektet e financuara, të hartojnë, zbatojnë dhe të fuqizojnë një Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social që përbëhet së paku nga elementet e mëposhtme:

- Lista e përjashtimit;
- Politika MS e aprovuar nga drejtuesit kryesorë të NF-së;
- Procedura e menaxhimit të riskut MS, bazuar në:
  - kategorizimin e investimeve sipas niveleve të risqeve MS;
  - Proces vlerësimi MS të integruar tërësisht në ciklin e kreditimit;
  - …dhe përputhshmëri me kërkesat MS të legjislacionit kombëtar, përfshirë konventat e ILO-s të ratifikuara në vend dhe me standardet MS të Grupit të Bankës Botërore për projektet NF-A.
- Menaxher dhe ekip MS të trajnuar të përfshirë plotësisht;
- Nene MS në kontratat e firmosura me klientët;
- Raportim vjetor mbi menaxhimin MS;
- Kushte të kënaqshme pune brenda NF-së.

Në kuadrin e Programit dhe në punën me ndërmjetësit financiarë, AFD-ja do të zbatojë rreptësisht këtë qasje MRMS.

2.3.3. Parimet e AFD-së për MRMS për asistencë teknike

Asistentët teknikë shpesh thirren të ushtrojnë paralelisht ose në vijueshmëri një sërë misionesh pa qenë gjithmonë e dukshme t'i kategorizojnë ato. Megjithatë, ato mund të grupohen në gjashtë funksione kryesore:

- zëvendësim / zbatim: zëvendësim i stafit vendor për të mbështetur një organizatë në ndjekje të veprimtarive të saj;
- këshillë: ofrim ekspertize për një temë të caktuar;
- ngritje kapacitetesh: mbështetje për individë, organizata ose sisteme për të hartuar dhe përmirësuar përformancën e tyre;
- roli shoqërimi / mbështetje për ndryshim: funksione si ndërmjetësimi, lehtësimi, negocimi, mbrojtja nga trysnia që lejon shoqërimin e institucioneve / organizatave në procesin e ndryshimit të tyre;
- kontroll financiar / menaxhim projekti: kontroll i burimeve nga EZ-ja në mënyrë që ato të përdoren me efektshmëri dhe transparencë;
- Influencë: mbështetje për përkufizimin e politikave në lidhje me strategjitë nga donatori.

Në kuadrin e Programit, asistenca teknike e monitoruar nga AFD-ja ka të bëjë me lehtësimin financiar. Konsulenti do të kryejë veprimtaritë e mëposhtme:

- Të marrë pjesë në identifikimin e projekteve të realizueshme financuese nëpërmjet realizimit të studimeve teknike, propozimin e masave të efiçencës së energjisë dhe vlerësimin e kostove të tyre. Veprimtaritë e konsulentëve përfshijnë rishikimin e planeve dhe

dokumenteve të prokurimit, kryerjen e diagnozës së kapaciteteve teknike të zotëruesit të projektit në efiçencën e energjisë dhe përgatitjen e një programi përforcimi kapacitetesh.
- Të marrë pjesë në monitorimin dhe mbështetjen teknike të projektit të financuar duke dhënë mbështetje për zotëruesin e projektit gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Konsulentët do të punësohen për Programin nga AFD-ja sipas rregullave që ajo ka për prokurimin dhe do të kryejnë misione sipas kërkesave nga Njësia e Menaxhimit të Programit të *PEEN Cool*.

Asistenca Teknike (AT) në AFD mund të përfshihet brenda përbërësve të projektit ose mund të jetë projekt më vete. Në të dyja rastet, ndikimet mjedisore dhe sociale lidhur me AT-në do të menaxhohen duke ndjekur MRMS-në për projekte të financuara drejtpërdrejt dhe projekte të ndërmjetësuara (shih më sipër). Duke qenë se AT-ja ka të bëjë me shërbime intelektuale, ato klasifikohen kryesisht si projekte me Risk të Ulët (C).

2.4. Qasja e Proparco-s ndaj MRMS

Qasja e menaxhimit të riskut MS Proparco është e ngjashme me atë të miratuar nga AFD-ja. Të gjitha projektet duhet të jenë në përputhshmëri me ligjet kombëtare. Gjithashtu, projektet me risqe të konsiderueshme deri në të larta MS duhet të jenë në përputhshmëri me Standardet e Performancës (SP) MS të IFC-së dhe Udhëzimet Mjedisore, të Shëndetit dhe të Sigurisë (MShS) të Grupit të Bankës Botërore.

Qasja MRMS e Proparco-s përfshin hapat e mëposhtme:

- Kontroll i hershëm i situatës për risqe dhe ndikime të mundshme MS bëhet nga ekspertë të Proparco-s për mjedisin, shoqërinë dhe qeverisjen. Ky kontroll synon të verifikojë përputhshmërinë e projektit me listën e përjashtimit të AFD-së si edhe të sigurojë kategorizim të projektit bazuar në shkallën e risqeve dhe ndikimeve të mundshme MS.
- Niveli i procesit të hetimit MS të kryer gjatë procesit të vlerësimit është në përpjesëtim me nivelin e riskut të mundshëm MS (d.m.th. kategorizimi i projektit).
- Procese të tilla vlerësimi rezultojnë në përcaktimin e një sërë masash menaxhimi MS për të shmangur, zbutur dhe/ose kompensuar ndikime të mundshme si edhe për të përmirësuar performancën e përgjithshme MS të projektit.
- Masat monitoruese, në përpjesëtim me kategorizimin e projektit, zbatohen duke ndjekur Komisionin e Bordit. Një monitorim i tillë synon të vlerësojë përputhshmërinë e projektit me SP-të e IFC-së dhe performancën e përgjithshme MS.

Ngjashëm me qasjen e AFD-së, Proparco-ja do të sigurojë përputhshmëri të menjëhershme me kërkesat MS të Proparco-s për të gjitha objektet ose veprimtaritë e reja duke kërkuar vlerësim ndikimi MS sipas kërkesave MS të Proparco-s. Objektet ose veprimtaritë ekzistuese që nuk përmbushin kërkesat MS të Proparco-s në kohën e financimit, do të duhet të marrin masa shtesë MS për të siguruar përputhshmëri të projektit brenda një afati kohor të arsyeshëm.

2.4.1. Parimet e Proparco-s për MRMS për projektet e financuara drejtpërdrejt

Niveli i procesit të vlerësimit MS dhe kërkesave MS për projektet e financuara drejtpërdrejt është në proporcion me nivelin e risqeve dhe ndikimeve të mundshme MS. Proparco-ja i klasifikon të gjitha projektet brenda katër kategorive, lidhur me një nivel të caktuar risqesh MS: Risqe të Larta (kategoria A), Risqe të Konsiderueshme (B+), Risqe të Mesme (B) ose Risqe të Ulëta (C).

Të gjitha projektet e financuara drejtpërdrejt të klasifikuara si A ose B+ janë objekt i proceseve të vlerësimit gjithëpërfshirës të mbikëqyrur nga ekspertët MS të Proparco-s. Për të gjitha ato projekte caktohen konsulentë të pavarur MS nga klienti/zotëruesi i projektit në emër të Proparco-s të kryejnë vlerësim të hollësishëm të përputhshmërisë së klientit/projektit sipas kërkesave të Proparco-s. Ky

vlerësim përfshin një rishikim të të gjithë dokumentacionit të disponueshëm MS si edhe vizitë në terren (të gjitha projektet e kategorisë A janë objekt i një vizite në terren të kryer nga eksperti dhe konsulentët MS të Proparco-s).

Procese të tilla vlerësimi të kujdesshëm rezultojnë në identifikimin e një liste veprimesh MS dhe masash menaxhimi për t'u zbatuar që të adresohen të gjitha risqet MS të identifikuara dhe të sigurohet përputhshmëria e projektit me kërkesat MS të Proparco-s. Kjo listë veprimtarish formalizohet nën përkufizimin e një Plani Veprimi MS (PVMS), i rënë dakord mes klientit/zotëruesit të projektit dhe Proparco-s dhe aneksuar në Marrëveshjen e financimit. Kërkesat tradicionale MS të Proparco-s të përfshira si pjesë e PVMS të projekteve të financuara drejtpërdrejt lidhen zakonisht me zhvillimin e sistemit të menaxhimit specifik MS, rekrutimit të burimeve MS, zhvillimit të planeve të veprimit të veçanta për të adresuar risqe specifike mjedisore dhe sociale si për shembull biodiversiteti ose zhvendosja. Zbatimi i PVMS-së është përgjegjësi e klientit/zotëruesit të projektit. Garantimi i zhvillimit të një plani veprimi korrigjues për të menaxhuar ngjarje të paparashikuara përfshihet gjithashtu në marrëveshjen e financimit.

Përparimi i zbatimit të PVMS-së (dhe i çfarëdo plani veprimi të mundshëm korrigjues) raportohet nga klienti/zotëruesi i projektit në bazë vjetore dhe është gjithashtu objekt monitorimi të kryer nga një palë e jashtme e caktuar nga klienti/zotëruesi i projektit në emër të Proparco-s. Projektet e financuara drejtpërdrejt të Proparco-s të kategorizuara si A dhe B+ janë përgjithësisht objekt i monitorimeve tremujore gjatë ndërtimit dhe monitorimit vjetor gjatë veprimtarisë.

2.4.2. Parimet e Proparco-s për MRMS për projektet me ndërmjetësim

Projektet e financuara nëpërmjet ndërmjetësve financiarë (NF) janë objekt i një qasjeje të ngjashme me atë të hartuar nga AFD-ja. Nivelet e proceseve të hetimit MS dhe kërkesave MS për projektet e ndërmjetësuara janë në proporcion me nivelet e risqeve dhe ndikimeve të mundshme MS të lidhura me portofolin IFFI (dhe jo të kufizuara me risqet MS që mund të shkaktohen nga projektet e financuara nga Proparco).

Të gjitha projektet FIIF kategorizohen sipas nivelit të risqeve MS që lidhen me portofolin e tyre IF. Identifikohen tri kategori risqesh: NF-A (Portofol me Risk të Lartë MS), NF-B (Portofol me Risk të Mesëm MS) ose NF-C (Portofol me Risk të Ulët MS). Të gjitha projektet e ndërmjetësuara të klasifikuara si NF-A ose NF-B janë objekt procesi vlerësimi MS sipas SP MS 1 dhe 2 të IFC-së. Ky proces vlerësimi të kujdesshëm mbikëqyret nga një ekspert MS i Proparco-s për të gjitha projektet NF-A dhe në rast boshllëqesh të konsiderueshme për projektet NF-B. Ai përfshin analizë të hollësishme MS të vlefshmërisë MS të portofolit dhe veprimtarive të biznesit të IFFI dhe mundësisë së IFI të menaxhojë risqet MS që lidhen me veprimtaritë e saj në përputhje me SP MS të IFC-së.

Procesi i vlerësimit MS mund të rezultojë në përcaktimin e një Plani Veprimi MS (PVMS). Kërkesat e PVMS-së në mënyrë tipike përqendrohen në zhvillimin e kapaciteteve MS të IFFI dhe fuqizimin e sistemit të menaxhimit MS për të kufizuar risqet ligjore, financiare dhe ato të reputacionit dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm me përfshirje. PVMS përfshihet në dokumentacionin e financimit dhe zbatimi i tij përgjithësisht lidhet me disbursimin financiar të Proparco-s.

Raportimi mbi përparimin e zbatimit të PVMS-së dhe performancën e përgjithshme MS të IFI i bëhet Proparco-s në bazë vjetore. Monitorimi nga jashtë, i kryer nga një konsulent i pavarur i caktuar nga IFI në emër të Proparco-s zbatohet nëse konsiderohet e domosdoshme nga eksperti MS i Proparco-s gjatë procesit të vlerësimit.

2.4.3. Parimet e Proparco-s për MRMS për asistencë teknike

Asistenca Teknike (AT) mund të propozohet nga Proparco për projekte të financuara drejtpërdrejt ose për projekte të ndërmjetësuara, dhe synon të katalizojë ndikimet nëpërmjet ndërhyrjeve për ngritje kapacitetesh që mobilizojnë shërbime intelektuale. Projektet zakonisht përqendrohen në gjetjen e homologëve të sektorit privat më performues (ekselencë operacionale, cilësi produktesh dhe shërbimesh, qeverisje, kapital njerëzor) dhe/ose më të gjelbër dhe më përfshirës (përgjegjësi mjedisore dhe sociale, efiçencë energjie dhe financë klime, përfshirje gjinore, akses ndaj të mirave dhe shërbimeve bazike). Nën programin *PEEN Cool*, ato kryesisht do të mbështesin misione për të kryer kontrolle energjie, vlerësim karboni, ose studime përmirësimi performance të energjisë dhe mjedisit.

Duke qenë se projektet e AT-së do të ofrohen vetëm për klientë perspektivë ose ekzistues, ato janë një komponent ose paralel me projektin e drejtpërdrejtë të Proparco-s ose financimin NF. MRMS për asistencë teknike ndërtohet kryesisht mbi gjetjet e MRMS për veprimtarinë kryesore financiare, qoftë projekt i financuar drejtpërdrejt ose projekt i ndërmjetësuar. Pavarësisht se projektet e AT-së nuk janë objekt i ndonjë kategorizimi risku MS specifik, ato duhet të ndjekin udhëzim të pavarur ku rishikimi dhe identifikimi i risqeve të mundshme kryhet nga një punonjës i AT-së së bashku me ekipin e projektit kryesor. Duke qenë se AT-ja ka të bëjë me shërbime intelektuale (ekspertizë teknike, ngritje kapacitetesh, trajnim, studime, mentorim, etj.), dhe janë të vlefshme vetëm për të përforcuar performancën dhe/ose ndikimet pozitive të një projekti veprimi financiar, ato kryesisht do të identifikohen si me risk të ulët. Projektet e AT-së mund edhe të mbështesin zbatimin e masave të PVMS-së ose ngritjen e SMMS-së.

Raportimi vjetor i programit të AT-së të zbatimit të projektit kryhet nga zotëruesi i projektit dhe konsulenti/ët e zgjedhur për misionin dhe miratohet nga punonjësi i AT-së së Proparco-s dhe menaxheri i projektit. Gjithashtu, monitorimi i jashtëm i programit të AT-së, i kryer nga një konsulent i pavarur, mund të kontraktohet për një sërë projektesh të zgjedhura si pjesë e masave ekzistuese monitoruese përfshirë në kushtet financuese të Proparco-s të projektit ose të IF.

2.5 Qasja e GIZ-it ndaj MRMS

Në programin *PEEN Cool*, GIZ-i do të jetë përgjegjës për veprimtaritë e asistencës teknike nëpërmjet lehtësimit të politikës.

Qasja e GIZ-it ndaj Menaxhimit të Riskut Mjedisor dhe Social bazohet në "Sistemin e Menaxhimit Gjinor dhe i Masave Mbrojtëse". Sistemi i menaxhimit konsiderohet standard minimal detyrues për të gjitha fushat e biznesit të GIZ-it dhe palëve kontraktuese. Kjo i mundëson GIZ-it të ofrojë këshilla teknike specifike për projektet dhe të shmangë, ose së paku të zvogëlojë, risqet e mundshme në zbatim duke promovuar potencialin.

Objektivat

Sistemi i Menaxhimit Gjinor dhe i Masave Mbrojtëse ka objektivat e mëposhtme:

1. Të identifikojë risqet e ndikimeve të paqëllimshme dhe risqeve të jashtme për të gjitha garancitë si edhe potencialin për barazi gjinore në fazë të hershme, dhe të adresojë këto nëpërmjet masave të shënjestruara në planin e projektit.
2. Të monitorojë risqet e identifikuara gjatë gjithë ciklit të projektit. Bazuar në këtë, hapat e duhura mund të merren menjëherë dhe të nisin masa korrigjuese kurdo që shihet e domosdoshme.

3. Të përmirësojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të projekteve të GIZ-it.
4. Të bashkojë dhe standardizojë proceset dhe kërkesat ekzistuese të GIZ-it dhe palëve të kontraktuara në një sistem të vetëm menaxhimi.

Mbulimi i Sistemit të Menaxhimit S&G

Sistemi i Menaxhimit S&G mbulon fushat e:

- Mjedisit: Mjedisi është në mbrojtje për shkak se cilësia, ekzistenca dhe shërbimet e burimeve natyrore formojnë bazat e zhvillimit të qëndrueshëm. Objektiva zhvillimi të tilla si siguria ushqimore, uji i pijshëm dhe shëndeti nuk mund të arrihen pa patur një mjedis të padëmtuar.

- Klima: Klima është në mbrojtje sepse ndikimet e ndryshimit të klimës mund të kufizojnë potencialin zhvillimor ose edhe mund të kthejnë mbrapsht përparimin që është bërë tashmë. Lehtësimi i zhvillimit pavarësisht ndryshimit të klimës kërkon reduktim ambicioz të emetimeve dhe masa përshtatjeje për ndryshimin e klimës.

- Ndjeshmëri ndaj konfliktit dhe kontekstit: Ndjeshmëria ndaj konfliktit dhe kontekstit synon të minimizojë ose parandalojë ndikime negative të mundshme të paqëllimshme në kontekste delikate ose në ato që karakterizohen nga konflikti dhe dhuna. Rreth dy të tretat e vendeve partnere të GIZ-it janë të prekura nga konflikti, dobësia, dhuna ose kriza akute.

- Te drejtat e njeriut: Të drejtat e njeriut janë në mbrojtje sepse masat e zhvillimit nuk duhet të kenë ndikime negative ose nuk duhet t'i përkeqësojnë ato në realizimin e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut u garantojnë të gjithë njerëzve jetë të vetë-përcaktuar gjatë të cilës ata mund të shijojnë lirinë, barazinë dhe dinjitetin, pavarësisht seksit, moshës, përkatësisë etnike, fesë, paaftësisë, orientimit seksual, identitetit gjinor ose çfarëdo statusi tjetër social.

- Gjinia: Barazia gjinore është kusht thelbësor për arritjen e rezultateve të qëndrueshme pozitive. Në lidhje me gjininë, GIZ-i kryen analizën e riskut dhe vlerëson mundësinë për promovimin e barazisë gjinore në projekte me të gjitha palët e kontraktuara. Kjo do të thotë se, në mënyrë që të nxisë tërësisht barazinë gjinore dhe integrimin e vazhdueshëm të përmasës gjinore, vlerësimet marrin parasysh jo vetëm risqet dhe ndikimet e paqëllimshme negative, por edhe mundësinë për promovimin e çështjeve gjinore dhe kapërcimin e diskriminimit dhe disavantazheve me bazë gjinore.

Të gjitha projektet vlerësohen në këto fusha për të identifikuar risqe të jashtme të mundshme që mund të vijnë nga konteksti i projektit ose mjedisi dhe ndonjë ndikim negativ të paqëllimshëm që mund të ketë projekti te njerëzit ose te burimet e tjera. Kjo lejon që t'i përcaktohet një kategori risku çdo projekti.

Përdorimi në faza të ndryshme të kontraktimit

GIZ-i përdor Sistemin e Menaxhimit Gjinor dhe të Masave Mbrojtëse në çdo fazë të menaxhimit të autorizimit – në përgatitjen fillestare, përgatitjen e ofertës, zbatimin e projektit dhe përfundimin e projektit. Në varësi të kërkesave të palës që kontraktohet, vlerësimi përfshin procedurë me një ose disa hapa; vlerësimet e mundësisë kryhen gjithashtu sipas kërkesave. Në gjetjet e vlerësimit, projektet lidhen me një prej katër kategorive të riskut për Masat Mbrojtëse, me qëllim të përcaktohen si duhet përgjegjësitë.

Sistemi i Menaxhimit Gjinor dhe Masave Mbrojtëse vlen gjithashtu për kontraktimet e Shërbimeve Ndërkombëtare (ShN), partneritetet me sektorin privat dhe të gjithë klientët e sektorit publik gjerman si edhe masat e ndërmarra nga vetë GIZ-i. Pragu i vlerës është 1 milion Euro, ose 200,000 Euro për partneritete me sektorin privat.

Menaxhimi

GIZ-i ka ngritur zyrën e Menaxhimit Gjinor dhe Masave Mbrojtëse, e cila ka për detyrë të vlerësojë të gjithë projektet e reja dhe vijuese sipas kritereve te Sistemit të Menaxhimit Gjinor dhe Masave Mbrojtëse dhe të japë këshilla për zbatimin. Zyra ka të drejtë të ndërhyjë dhe të vendosë veton në kategorizimin e riskut të projektit. Menaxherët e projektit janë përgjegjës për vënien në zbatim të sistemit dhe kjo monitorohet nga menaxherët e linjës.

III. Skema e Menaxhimit të Riskut MS për Programin

Në këtë Program, Projekti do të kuptohet si:

- **Projekt i financuar Drejtpërdrejt**: huat, pjesëmarrje me aksione ose grante për të financuar dhe mbështetur investime për efiçencë energjie në sektorin e ndërtimit ose atë industrial. Entet zbatuese u korrespondojnë enteve publike, organizatave të shoqërisë civile ose kompanive private.

Përfshin:

- Grante për projekte të AFD-së të financuara drejtpërdrejt;
- Hua për projekte të AFD-së të financuara drejtpërdrejt ;
- Asistencë Teknike për projekte të AFD-së të financuara drejtpërdrejt;
- Grante për projekte të Proparco-s të financuara drejtpërdrejt;
- Hua për projekte të Proparco-s të financuara drejtpërdrejt;
- Pjesëmarrje me aksione për projekte të Proparco-s të financuara drejtpërdrejt;
- Asistencë Teknike për projekte të Proparco-s të financuara drejtpërdrejt.

- **Projekt i ndërmjetësuar**: partneritet mes AFD-së dhe Proparco-s dhe një Ndërmjetësi Financiar, që do të thotë lehtësi financiare ose fond privat aksionesh. Lehtësia financiare do të ndahet më tej në disa hua të dhëna nga EZ-ja drejt kompanive vendore. Këto hua do të njihen si 'Nënprojekte'. Projekti i ndërmjetësuar mund të përfshijë gjithashtu një fond aksionesh me aksionet ekzistuese të Proparco-s dhe investimi i të cilave ndërmerr një projekt që përfshin efiçencën e energjisë në ndërtim ose industri. Fondi i aksioneve private do të ndahet më tej në disa pjesëmarrje me aksione nga EZ-ja për kompanitë vendore. Këto pjesëmarrje me aksione do të njihen gjithashtu si 'Nënprojekte'.

Përfshin:

- Grante për projekte dhe nënprojekte të AFD-së të ndërmjetësuara
- Hua për projekte të ndërmjetësuara të AFD-së me ndërmjetësues financiar
- Asistencë teknike për projekte të AFD-së të ndërmjetësuara
- Grante për projekte të Proparco-s të ndërmjetësuara
- Hua për projekte të Proparco-s të ndërmjetësuar me ndërmjetësues financiar
- Pjesëmarrje me aksione për projekte të Proparco-s të financuara me ndërmjetësi
- Asistencë teknike për projekte të ndërmjetësuara të Proparco-s

- **Projekte "politikash"**, do të thotë asistencë teknike e dhënë brenda *PEEN Cool* nën komponentin 2 të programit (lehtësim politike) zbatuar nga GIZ-i.

Përfshin :

- Grante për zbatim të asistencës teknike

Grupi AFD përmbledh AFD-në dhe Proparco-n. MRMS-ja e paraqitur në këtë seksion do të kuptohet si MRMS e Grupit AFD.

3.1. MRMS në nivel Projektesh për projekte të financuara Drejtpërdrejt

Tabela 1 MRMS Cikli i Projektit për projekt të financuar drejtpërdrejt

Hapi në Ciklin e Projektit	Veprimet MRMS	Roli dhe përgjegjësitë
Identifikimi	Kontrolli i projektit nëpërmjet Listës së Përjashtimit të GRUPIT AFD	Zyrat vendore të GRUPIT AFD
	Kategorizimi MS (A, B+, B, C) Kryhet PVMS gjatë vlerësimit të projektit	Eksperti MS i GRUPIT AFD (Niveli i Zyrave qendrore)
Udhëzimi (Realizueshmëria dhe Vlerësimi)	Vlerësimi MS përshtatet me natyrën dhe gamën e projektit, dhe bëhet në proporcion me nivelet e risqeve MS	Eksperti MS i GRUPIT AFD, konsulenti MS, konsulenti për studimin e realizueshmërisë
	Hartimi i planit të zotimit MS (PZMS)	Eksperti MS i GRUPIT AFD
Zotimi	Finalizimi i planit të zotimit MS dhe integrimi në marrëveshjen e financimit	Eksperti MS i GRUPIT AFD dhe Menaxheri i Projektit
Mbikëqyrja	Monitorimi i zbatimit të masave mjedisore dhe sociale bazuar në PZMS dhe në raportin e monitorimit Mjedisor dhe Social	Eksperti MS i GRUPIT AFD dhe Menaxheri i Projektit, Konsulenti MS
Vlerësimi	Vlerësimi MS pas punimeve (kurdo që është e përshtatshme)	GRUPI AFD ose konsulentët e jashtëm

3.1.1 Identifikimi

Lista e përjashtimit

Kur identifikohet një projekt me një EZ, kontrolli i parë, që bëhet në nivelin e zyrës vendore të GRUPIT AFD, është ai i Listës së Përjashtimit[6]. Nëse veprimtaritë e një projekti janë sipas Listës së Përjashtimit të GRUPIT AFD, projekti do të përjashtohet.

Kategorizimi fillestar

Gjatë fazës së identifikimit të një Projekti, GRUPI AFD kryen një analizë paraprake mjedisore dhe sociale të Projektit në bazë të informacionit të mbledhur nga autoritetet kontraktuese dhe konsultimin me administruesit dhe komunitetet vendore të përfshira.

Hapi i parë çon në përcaktimin e sfidave kryesore mjedisore dhe sociale të shkaktuara nga zbatimi i projektit dhe në bërjen e identifikimit fillestar të risqeve të mundshme.

Klasifikimi në katër kategori të risqeve të mundshme mjedisore dhe sociale bëhet në bazë të informacionit të disponueshëm: Risqe të Larta (Kategoria A), Riqe të Konsiderueshme (Kategoria B +), Risqe të Mesme (Kategoria B) dhe Risqe të Ulëta (Kategoria C).

Ky klasifikim përcakton natyrën dhe shtrirjen e vazhdimësisë së vlerësimit mjedisor dhe social që do të kryhet. Pas analizës dhe propozimit nga agjencia, ai konfirmohet nga Sektori i Mbështetjes Mjedisore dhe Sociale i GRUPIT AFD.

Klasifikimi mjedisor dhe social i një projekti mund të ndryshojë gjatë rrugës së projektit, në varësi të vetë projektit por gjithashtu edhe në bazë të informacionit të disponueshëm.

[6] Shih Shtojcën 1

Tabela 2 Kategorizimi i riskut MS-Projekt i drejtpërdrejtë

Risqe të Larta - A	Risqe të Konsiderueshme - B+	Risqe të Mesme - B	Risqe të Ulëta - C
Projekti klasifikohet në kategorinë A [Risqe të Larta] kur mund të shkaktojë ndikime të larta negative mjedisore ose sociale. Këto mund të shkojnë përtej fushës së ndikimit të infrastrukturës ose pikave ose mund të shkojnë përtej periudhës së ndërtimit dhe veprimtarisë. Kur kategorizohet projekti, ndikimet nuk mund të identifikohen ose vlerësohen lehtësisht, prandaj kërkojnë proces formal, me pjesëmarrje dhe të pavarur për vlerësimin e këtyre ndikimeve.	Projekti klasifikohet në kategorinë B + [Risqe të Konsiderueshme] kur mund të shkaktojë ndikime të konsiderueshme negative mjedisore ose sociale. Këto mund të shkojnë përtej fushës së ndikimit të infrastrukturës ose pikave ose mund të shkojnë përtej periudhës së ndërtimit dhe veprimtarisë. Ndryshe nga projektet e kategorisë A, ndikimet negative mund të identifikohen dhe të zvogëlohen me masat e duhura dhe të njohura, ose të zbatuara nga Autoriteti Kontraktues në projekte të tjera të ngjashme. Kërkesat për vlerësim të pavarur mjedisor dhe social mund të variojnë në varësi të projektit dhe përcaktohen nga GRUPI AFD rast pas rasti.	Projekti klasifikohet në kategorinë B [Risqe të Mesme] kur mund të shkaktojë ndikime negative mjedisore ose sociale të cilat kanë mundësi të ndryshohen ose të kufizohen në një zonë të caktuar ndjeshmëria e së cilës është më e ulët ose të kufizohen në periudhën e ndërtimit. Ndikimet negative të projektit mund të identifikohen lehtësisht dhe mund të zvogëlohen nëpërmjet masave të duhura. Këto masa përcaktohen lehtësisht duke kryer vlerësim të kufizuar mjedisor dhe social gjatë vlerësimit të Projektit.	Projekti klasifikohet në kategorinë C [Risqe të Ulëta] kur është e mundur që ndikimet e mundshme negative mjedisore ose sociale të jenë të pakta, ose të mos ekzistojnë fare, dhe periudha e veprimtarisë nuk kërkon mbrojtje, kompensim ose vijim specifik. Projektet e Kategorisë C, në parim, nuk kërkojnë vlerësim shtesë mjedisor ose social pasi të jetë kategorizuar Projekti.

Bazuar në informacionin e disponueshëm në kohën e Komisionit Identifikues, eksperti MS i GRUPIT AFD përcakton detyrat e procesin e vlerësimit MS që duhet të kryhen gjatë fazën së vlerësimit të Projektit. Këto detyra, si edhe Kategoria e Riskut MS, theksohen në Formularin MS, dokument i brendshëm që përdoret për vijimin e PVMS-së për Projektin.

Tabela 3 Lista me treguesit e risqeve dhe ndikimeve MS për sektorë, të pranueshëm për Programin

Sektori	Shembuj projektesh	Risqe/ndikime mjedisore	Risqe/ndikime sociale
Banesa sociale dhe përmirësime banesash	Ndërtim objekte banesash në fushë për banesa në Rinovim banesash ekzistuese (p.sh. efiçencë energjie në projekte banesash)	Ndryshime në rrjedhjet e ujërave sipërfaqësore Ndikime në cilësinë e ujit Lëshimi i ndotësve Nxjerrje e materialeve mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme Ndikime në konsumin e burimeve (energji dhe ujë) Kontribut në ndryshimin e klimës (emetimet e GES-ve) Ndikime në biodiversitet dhe zona natyrore Ndikime në trashëgimi kulturore	Të gjitha risqet të lidhura me kushtet e punës dhe punonjësve Rritja e ndotjes akustike Ndikimet në infrastruktura dhe rrjete ekzistuese Ekspozim i shtuar ndaj rrezikut shëndetësor dhe të sigurisë Risqe të lidhura me projektet dhe qeverisjen vendore, angazhimin e palëve, komuniteteve vendore Sëmundje mjedisore (p.sh. ekspozimi ndaj plumbit, asbestit) Presion mbi pronësinë e tokës dhe rritje e kostos së tokës ose kostos së qirasë), pranim social Zhvendosjet e pavullnetshme Ndryshime në zakone sociale dhe organizim social
Shëndeti	Ndërtim ose zgjerim i qendrës shëndetësore ose spitalit Rinovim i qendrës shëndetësore ose zgjerim		
Arsimi	Ndërtim shkollash, universitetesh, klasash në zona rurale, komplekse shkencore, etj. Rinovim i qendrës së trajnimeve Zgjerim universiteti		
Ndërtesa publike	Masa për efiçencë energjie në ndërtesa publike, në qendër administrative		
Industria	Përmirësim i konsumit të energjisë ose konsumit të ujit në procese industriale (agrobiznes, fabrikë çimentoje, etj.)		
Transporti	Projekt për efiçencë energjie në fushë të gjelbër ose zonë urbane (tokë jo e gjelbër) stacion treni, stacion autobusi		

Sektor tjetër ndërtimi	Efiçencë energjie në treg, qendër tregtare, zyra, mbështetje inovacioni për ekosistemin e ndërtesave të gjelbra		

3.1.2. Udhëzimi

GRUPI AFD kryen proces vlerësimi të kujdesshëm mjedisor dhe social në të gjitha projektet e propozuara për financim. Ky mundëson vlerësimin nëse projekti ka gjasa të zhvillohet dhe zbatohet në përputhje me objektivat e perfomancës mjedisore dhe sociale të GRUPIT AFD. Vlerësimi MS përshtatet me natyrën dhe gamën e projektit, dhe është në proporcion me nivelin e risqeve MS.

Tabela 4 PVMS i pritshëm për kategorinë e riskut

	Risqe të Larta – A	Risqe të Konsiderueshme - B+	Risqe të Mesme – B	Risqe të Ulëta - C
Kuadri normativ	Rregulloret kombëtare dhe ato ndërkombëtare të zbatueshme në vend (përfshirë konventat e ILO-s) dhe politikat e Mbrojtjes dhe udhëzimet e përgjithshme Mjedisore, të Shëndetit dhe Sigurisë të Bankës Botërore		Rregulloret kombëtare dhe ato ndërkombëtare të zbatueshme në vend (përfshirë konventat e ILO-s) (+ kërkesat e veçanta të GRUPIT AFD, nëse është e vlefshme)	Rregulloret kombëtare dhe ato ndërkombëtare të zbatueshme në vend
Procesi i Vlerësimit MS	- VNMS, PMMS ose KMMS - PVZh ose kuadër politike për Zhvendosjen - PLMS		- RKMS dhe PMMS - PZMS	- Asnjë

3.1.3. Zotimi

Faza e zotimit ka të bëjë me klauzolat MS që vendosen në Marrëveshjen Financiare e cila firmoset mes GRUPIT AFD dhe EZ-së.

Për projekte me risqe të klasifikuara si i Lartë, i Konsiderueshëm ose i Mesëm, GRUPI AFD kërkon që zotëruesi i projektit të formalizojë zotimet mjedisore dhe sociale të projektit në një dokument të quajtur Plani i Zotimit Mjedisor dhe Social (PZMS)[7].

PZMS-ja hartohet për të konsoliduar më precizitet, në një dokument të vetëm dhe në formë tabelare, masat dhe veprimet materiale që janë të domosdoshme në mënyrë që projekti të jetë në përputhje me standardet e performancës mjedisore dhe sociale të zbatuara nga GRUPI AFD në një periudhë kohore të caktuar dhe në mënyrë të pëlqyeshme për GRUPIN AFD. PZMS përshkruan gjithashtu burimet e financimit për zbatimin e masave ose veprimtarive.

PZMS hartohet në formë drafti nga konsulenti përgjegjës për përgatitjen e VNMS-së. Ai finalizohet nga GRUPI AFD dhe zotëruesi i projektit për të pasqyruar procesin e vlerësimit të kryer nga AFD-ja dhe rezultatet e konsultimeve me palët e interesit.

[7] Shih Shtojcën 11

PZMS-ja finalizohet përpara se GRUPI AFD të vendosë të japë fondin dhe diskutohet gjatë takimit të Komisionit Kreditues. PZMS-ja është pjesë e dokumentacionit për projekte me Risk të Lartë, të Konsiderueshëm dhe të Mesëm dhe vendoset si shtojcë në Marrëveshjen e Financimit. Në mbështetje të dispozitave të PZMS-së, marrëveshja e financimit jep hollësitë e kushteve MS pararendëse për disbursimin, nëse ka, të cilat duhet të plotësohen përpara se të bëhet disbursimi nga GRUPI AFD.

Tabela 5 Klauzolat MS brenda marrëveshjes financiare

Klauzola MS	Përshkrimi	Me zgjedhje (Po/Jo)
Përgjegjësia Mjedisore dhe Sociale	***Zbatimi i masave mjedisore dhe sociale*** *Me qëllim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, Palët bien dakord se është e domosdoshme të promovojnë përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe të punës të njohura në rang ndërkombëtar, përfshirë konventat themelore to Organizatës Ndërkombëtare të Punës ("ILO") dhe ligjet edhe rregulloret mjedisore ndërkombëtare të zbatueshme në juridiksionin ku bën pjesë Huamarrësi.* *Për këtë qëllim dhe sa i përket veprimtarive të tij të biznesit, Huamarrësi do të veprojë [dhe do të sigurohet që çdo subjekt i varur nga ai] në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e ligjeve mjedisore dhe të punës, sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme të vendit ku po zbatohet Projekti. Huamarrësi do të [dhe do të sigurojë që të gjitha subjektet e varura nga ai] kërkojë gjithashtu që [Institucionet homologe financiare do të kërkojnë] Klientët përfitues të veprojnë në përputhshmëri me këto standarde në kryerjen e biznesit të tyre.*	**Jo** Vlen për të gjitha Projektet.
Zbatimi i PMMS ose KMMS	**Zgjedhja 1:** *Që të jetë në përputhshmëri me standardet mjedisore dhe të punës të përcaktuara më sipër, EZ-ja do të sigurojë zbatim të PMMS ose KMMS të projektit (KSMS). EZ-ja do të sigurojë se kontraktuesit e tij përmbushin kërkesat dhe zbatojnë masat zbutëse siç planifikohet në PMMS dhe KMMS.*	**Po** Në bazë të vlerësimit MS të kryer nga eksperti MS i GRUPIT AFD.
Menaxhimi i ankesave MS	*(a) Huamarrësi (i) konfirmon se ka marrë një kopje të Procedurave të Menaxhimit të Ankesave MS dhe pranon kushtet e saj, ne veçanti sa i përket veprimeve që mund të ndërmerren nga Huadhënësi në rast se një palë e tretë paraqet një ankesë, dhe (ii) njeh se Procedurat e Menaxhimit të Ankesave MS kanë, ashtu si mes Huamarrësit dhe Huadhënësit, të njëjtin efekt detyrues kontraktues si kjo*	**Po** Kjo klauzolë ka rekomandim të lartë por nuk është me detyrim, në çdo rast, mbetet i zbatueshëm mekanizmi i ankesave MS të GRUPIT AFD.

	Marrëveshje. *(b) Huamarrësi shprehimisht autorizon Huadhënësin t'u vërë në dispozicion Ekspertëve (siç përcaktohet në Procedurat e Menaxhimit të Ankesave MS) dhe palëve të përfshira në auditimin e përputhshmërisë dhe/ose në procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dokumentet e Projektit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të domosdoshme për përpunimin e Ankesave mjedisore dhe sociale (siç përcaktohen në Procedurat e Menaxhimit të Ankesave MS), përfshirë, pa kufizim, ato që listohen në Shtojcën 11).*	
Fasha 1A – Përkufizimet		**Po** Kjo fashë përfshin përkufizimet lidhur me menaxhimin e riskut MS nëse është e domosdoshme; për shembull nëse kërkohet PVMS ai përkufizohet këtu.
Fasha 2 – Përshkrimi i Projektit	Përshkruan përmbajtjen e Projektit si për shembull objektivat, përbërësit kryesorë, kriteret e pranueshmërisë, etj.	**Po** Nëse është e domosdoshme, veprimtaritë lidhur me MS mund të përfshihen në këtë fashë si për shembull veprimtaritë e asistencës teknike MS, lista e dokumentacionit MS që duhet siguruar, etj.
Fasha 3 – Lista e përjashtimit	Shiko Shtojcën 1 – Lista e Përjashtimit e GRUPIT AFD	**Jo** E zbatueshme për të gjitha Projektet.
Fasha 4 – Kushtet pararendëse	Përshkruan kushtet pararendëse që duhen përmbushur në faza të ndryshme të Projektit (firma, dhënia e pjesës së parë të fondit)	**Po** Sipas Projektit, kushtet pararendëse MS mund të përfshihen në këtë fashë
Fasha 10 – PZMS	Shiko Shtojcën 11 _ Modeli i Zotimit Mjedisor dhe Social	**Po** E detyrueshme për projekt të klasifikuar si A, B+ dhe B por jo për C.
Fasha 11 –	[të plotësohet në varësi të Projektit] - Raporti i Studimit MS	**Po**

Listë joshteruese e dokumenteve MS të cilat Huamarrësi lejon të ndahen në lidhje me procedurat e menaxhimit të ankesave MS	- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) - Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) - Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) - Plani i Veprimit për Zhvendosjen (PVZh) - Kuadri i Politikës për Zhvendosjen (KPZh) - Plani i Zotimit Mjedisor dhe Social (PZMS) - *Vlerësimi i kufizuar mjedisor dhe social* - Plani i veprimit i kufizuar mjedisor dhe social - Kapitull nga studimi i zbatueshmërisë mjedisore dhe sociale - Kapituj nga raportet e monitorimit mjedisor dhe social - Raporte monitorimi për zbatimin e PVMS	I zbatueshëm sipas përshkrimit më sipër nëse bëhet fjalë për klauzolën e menaxhimit të ankesave MS.

3.1.4. Mbikëqyrja

Gjatë zbatimit të projektit, zotëruesi i projektit i raporton GRUPIT AFD mbi zbatimin e masave mjedisore dhe sociale të planifikuara në përputhje me dokumentet e projektit, për statusin e këtyre masave zvogëluese dhe për rezultatet e arritura. PZMS përdoret si matricë monitorimi.

Për ta bërë këtë, zotëruesi i projektit mund të thërrasë një ekspert/grup ekspertësh të pavarur të cilët do të jenë përgjegjës për të verifikuar nëse zotëruesi i projektit u është përmbajtur zotimeve, nëse bëhet vërtet monitorimi i zbatimit të masave mjedisore dhe sociale të projektit, dhe nëse përshtaten masat e planifikuara në rast se ato nuk janë të efektshme.

GRUPI AFD rishikon gjetjet e raportit të monitorimit në lidhje me zotimet e zotëruesit të projektit. Për Risk të Lartë ose të Konsiderueshëm, zotëruesi i projektit i bën GRUPIT AFD raportime rregullisht për zbatimin e përkushtimeve bazuar në masat vijuese sipas përkufizimit në PKMS[8]. Për projekte me risqe të klasifikuara si të Mesme, mbikëqyrja e përbërësve mjedisore dhe socialë kryhet si pjesë e misioneve mbikëqyrëse të projektit.

Në përputhje me standardet e performancës mjedisore dhe sociale të zbatuara nga GRUPI AFD në lidhje me zotimet e palëve të interesit dhe nxjerrjen e informacionit, zotëruesi i projektit dokumenton dhe u përgjigjet kërkesave të cilitdo aktor për informacion në lidhje me aspektet mjedisore dhe sociale të projektit.

3.1.5. Vlerësimi mbas

Vlerësimet pas përfundimit kryhen nga GRUPI AFD dhe përfshijnë partnerë vendorë. Për projekte me Risqe të Larta, kryhet një vlerësim i veçantë. pas punimeve Objektivat e këtyre vlerësimeve janë të masin efektshmërinë e masave të rekomanduara në PZMS, të vlerësojnë qëndrueshmërinë e masave të propozuara dhe të përfitojnë nga komentet e marra. Për projekte me Risk të Konsiderueshëm dhe të Mesëm, vlerësimi i aspekteve MS integrohet në vlerësimin e përgjithshëm të projektit pas punimeve dhe ky përqendrohet në mënyrën se si janë kontrolluar risqet mjedisore dhe sociale.

[8] Shih Shtojcën 12-Udhëzime për raportin e monitorimit Mjedisor dhe Social

3.2 MRMS në nivelin e Projekteve për projektet me ndërmjetësim

Tabela 6 MRMS në nivelin e Projektit për projektet me ndërmjetësim

Hapi në Ciklin e Projektit	Veprimet e MRMS-së	Roli dhe përgjegjësitë
Identifikimi	Kontrolli i Projektit dhe EZ-së kundrejt Listës së Përjashtimit të GRUPIT AFD	Zyrat vendore të GRUPIT AFD
	Kategorizimi MS (NF-A, NF-B ose NF-C) PVMS kryhet gjatë vlerësimit të projektit	Eksperti MS i GRUPIT AFD (niveli i zyrave qendrore)
Udhëzimi (Realizueshmëria dhe Vlerësimi)	Analiza e SMMS nëpërmjet pyetësorit MS, rishikimi i dokumentacionit MS, dhe mundësisht të adresohen seancat e shkëmbimit me Integrimin e aspekteve MS të EZ-së në studimin e realizueshmërisë (nëse vlen)	Eksperti MS i GRUPIT AFD, me mbështetjen e Menaxherit të Projektit dhe Zyrave Vendore
	Analiza e aspekteve të veçanta MS sektoriale dhe/ose specifike sipas vendit (nëse vlen)	Konsulenti i studimit të realizueshmërisë
	Analiza e boshllëqeve përkundrejt kërkesave FKGj-GRUPIT AFD dhe përkufizimit të PVMS-së sipas rastit Hartimi i klauzolave MS	Eksperti MS i GRUPIT AFD
Zotimi	Finalizimi i klauzolave MS dhe integrimi i tyre në marrëveshjen e lehtësimit të kreditimit	Eksperti i GRUPIT AFD dhe Menaxheri i Projektit
Mbikëqyrja	Nëse është e domosdoshme: monitorimi i asistencës teknike përfshirë në MRMS nëpërmjet përkufizimit të programit të AT-së, takimeve, etj.	Eksperti i GRUPIT AFD dhe Menaxheri i Projektit
	Rishikimi i zbatimit operacional të SMMS nëpërmjet vizitave në terren të nënprojekteve, nëse është e domosdoshme rishikim i një mostre të nënprojekteve, etj.	Eksperti i GRUPIT AFD, Menaxheri i Projektit dhe mundësisht konsulentë të jashtëm
Vlerësimi	Vlerësimi MS pas punimeve (kurdo që është e vlefshme)	GRUPI AFD ose konsulentë të jashtëm

3.2.1. Identifikimi

Lista e përjashtimit

Kur ndërmerret një partneritet me një EZ, kontrolli i parë, që bëhet nga niveli i zyrës vendore të GRUPIT AFD, është ai i **Listës së Përjashtimit**[9]. Nëse një EZ financon veprimtari që janë në Listën e Përjashtimit të GRUPIT AFD, EZ-ja nuk do të zgjidhet si partner për t'u bërë pjesë e Programit.

Kategorizimi fillestar

Nëse EZ-ja nuk financon veprimtari që janë në Listën e Përjashtimit të GRUPIT AFD, mund të jetë i pranueshëm për Program. Më pas i dërgohet EZ-së **Pyetësori MS**

Nëse informacioni është i disponueshëm përpara Komisionit Identifikues të GRUPIT AFD, Eksperti MS i GRUPIT AFD analizon portofolin për nivelin e riskut MS (shih Tabelën 4 më poshtë) dhe përcakton kategorinë e riskut MS të Projektit, bazuar në portofolin e EZ-së:

- « NF-A »: Portofol me Risqe të Larta MS;
- « NF-B »: Portofol me Risqe të Mesme MS;
- « NF-C »: Portofol me Risqe të Ulëta MS.

Gama e konsideruar për renditjen MS të projektit është i gjithë portofoli i EZ-së, pavarësisht natyrës së financimit të dhënë nëpërmjet Programit.

Tabela 7 Kategorizimi i riskut MS të NF-së

Portofol me Risk të Lartë (NF-A)	**Portofol me risk të Mesëm (NF-B)**	**Portofol me Risk të Ulët (NF-C)**
Institucione financiare me më shumë se 20% të portofolit të përgjithshëm kushtuar projekteve të kategorisë A (dhe B+). Në rast ndërmjetësimi të dyfishtë, EZ që kanë së paku një klient NF-A.	Institucione financiare me veprimtari biznesi ose projekte që kanë ndikime MS të padëshirueshme të kufizuara dhe me një pjesë të kufizuar të projekteve që përfshijnë risqe MS të konsiderueshme deri në të larta (më pak se 20% e portofolit të përgjithshëm kushtuar projekteve të kategorisë A dhe B+). Në rast ndërmjetësie të dyfishtë, NF-të që kanë së paku një klient NF-B dhe asnjë klient NF-A.	Institucione financiare me veprimtari ose projekte që përfshijnë pak risqe MS (institucione financiare të specializuara në sipërmarrje të specializuara për shitje me pakicë ose mikro (>80% e portofolit të përgjithshëm)).
Gjatë fazës së identifikimit, nëse klasifikimi si NF-A ose NF-B nuk është i sigurt, projekti kategorizohet automatikisht si NF-A. Kategorizimi do të konfirmohet më pas, me kryerjen e analizës së pyetësorit të vlerësimit MS të EZ-së.		

Bazuar në informacionin e disponueshëm në kohën e Komisionit të Identifikimit, eksperti MS i GRUPIT AFD përcakton detyrat e procesit të vlerësimit MS që duhet të kryhen gjatë fazës së vlerësimit të projektit. Këto detyra, si edhe Kategoria e Riskut MS, theksohen në Formularin MS, një dokument i brendshëm që përdoret për vijueshmërinë e PVMS-së së Projektit.

3.2.2. Udhëzimi

Gama

[9] Shih Shtojcën 1

Me mbështetjen e zyrës vendore të GRUPIT AFD, eksperti MS i GRUPIT AFD në zyrat qendrore vazhdon më tej me vlerësimin fillestar MS duke marrë parasysh aspektet e mëposhtme:

- Risqet MS ndaj portofolit të EZ-së: sektorët, volumi i financimit, mjetet e financimit, etj.;
- Kapaciteti i EZ-së për të menaxhuar risqet MS lidhur me veprimtaritë e financës, dhe në veçanti:
  - Qasja ndaj menaxhimit të risqeve operacionele MS dhe zbatimit të procedurave që lidhet me ato të EZ-së;
  - Dokumentacioni MS i projekteve të financuara nga EZ, p.sh. vlerësimi i ndikimit MS, lista e firmave konsulente të autorizuara zakonisht nga EZ-ja, raportet e monitorimit MS, etj.;
  - Burimet njerëzore dhe financiare vënë në dispozicion nga EZ-ja për menaxhimin MS.
- Vendi/et në të cilat EZ-ja është aktive (rregulloret dhe kushtet e veçanta të aplikimit);
- Standardet MS të cilave u referohet EZ-ja;
- Sektori dhe lloji i nënprojekteve që do të financohen nga Projekti.

GRUPI AFD mbështet EZ-të në menaxhimin mjedisor dhe social, gjë që synon jo vetëm të shmangë, reduktojë ose mënjanojë ndikimet MS të projekteve të financuara, por edhe të përmirësojë praktikat e përgjithshme të EZ-së, së brendshmi dhe së jashtmi.
Rezultatet e vlerësimit dhe kërkesat e zbatueshme përcaktojnë ngritjen dhe forcimin, nga ana e EZ-së, të një Sistemi Menaxhimi MS (SMMS). SMMS-ja zhvillohet dhe përmirësohet nëpërmjet zbatimit të një Plani Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS).

Tabela 8 Proces vlerësimi MS për nivelin e riskut

Portofol me Risk të Larë (NF-A)	**Portofol me Risk të Mesëm (NF-B)**	**Portofol me Risk të Ulët (I-C)**
• Rishikim i pyetësorit të vlerësimit të plotësuar nga EZ: o Aprovimi i kategorizimit, o Analiza e përputhshmërisë me legjislacionin, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë dhe ligjin e punësimit.		
• Analizë e thelluar e risqeve ekzistuese dhe/ose të pritshme që lidhen me portofolin e EZ-së dhe të kapacitetit të EZ-së për të menaxhuar risqet MS. • Analiza e boshllëqeve ndërmjet qasjes së EZ-së ndaj kërkesave të MRMS-së dhe GRUPIT AFD, si dhe identifikimi i nevojave për përmirësim në lidhje me menaxhimin e riskut MS me qëllim zhvillimin e një plani veprimi MS nëse është e nevojshme.		

Sipas nivelit të riskut MS të portofolit të EZ-së, SMMS-ja duhet të mbulojë kërkesat e detajuara në Tabelën 9.

Tabela 9 Kërkesat e pritshme sipas nivelit të risqeve MS

Portofol me Risk të Lartë (NF-A)	**Portofol me Risk të Mesëm (NF-B)**	**Portofol me Risk të Ulët (NF-C)**
• Ekzistenca e një liste përjashtimi që përfshin të paktën pikat 2 deri në 14 të listës së përjashtimit të GRUPIT AFD dhe të zbatueshme për të gjithë portofolin e EZ-së. • Pajtueshmëria e E-së me standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me të gjitha ligjet dhe rregulloret vendore për mjedisin, ligjin e punësimit, shëndetin dhe sigurinë dhe		

ligjin e punësimit.		
• Ekzistenca e një politike MS që përmbush kërkesat e GRUPIT AFD dhe që miratohet nga menaxhimi i EZ-së. • Ekzistenca e një menaxheri të trajnuar dhe kompetent për MS dhe përfshirja e efektshme e këtij personi në procesin e vlerësimit të kredisë. • Përfshirja e klauzolave MS në marrëveshjet e financimit ndërmjet EZ-së dhe klientëve të saj. • Përdorimi i standardeve MS të IFC-së MS në transaksionet e investimeve të financuara nga Programi dhe në projektet e EZ-së që përfshijnë risqe të larta MS.		
• Ekzistenca dhe zbatimi i një procedure menaxhimi të riskut operativ MS të miratuar nga GRUPI AFD dhe bazuar në kategorizimin e portofolit sipas niveleve të riskut MS (sipas 3.1.1).	• Ekzistenca dhe zbatimi i një procedure menaxhimi të riskut operativ MS të miratuar nga GRUPI AFD dhe bazuar në kategorizimin e portofolit sipas niveleve të riskut MS që zbatohet të paktën për investimet e financuara nga Programi dhe për projekte me risk të lartë të EZ-së.	

3.2.3. Zotimi

Faza e zotimit merret me klauzolat MS që do të përfshihen në Marrëveshjen e Lehtësimit të Kredisë që do të nënshkruhet midis GRUPIT AFD dhe EZ-së. Tabela 7 paraqet me hollësi elementet që pritet të përfshihen në Marrëveshjen e Lehtësimit të Kredisë.

Kurdo që është e mundur, zotimet MS diskutohen me EZ-në përpara vendimit të Bordit të GRUPIT AFD, e përfshihen më pas në Faqen e Kushteve për të lehtësuar procesin e negociatave. Nëse EZ-ja duhet të forcojë qasjen e MRMS-së, atëherë një Plan Veprimi MS (PVMS) përcaktohet në bazë të modelit në Shtojcën 2 - Model i Planit të Veprimit MS për ndërmjetësuesit financiarë të financuar nga GRUPI AFD. EZ-ja zotohet të zbatojë PVMS-në gjatë zbatimit të Projektit në mënyrë që të përditësojë SMMS-në në përputhje me kërkesat e GRUPIT AFD nën kushtet e MRMS-së. Nëse është e nevojshme, përfshihen në PVMS piketa të veçanta (p.sh. *"rekrutimi i një konsulenti MS para marrjes së pjesës së parë të fondit"*). PVMS-ja mund të zbatohet gjithashtu me mbështetjen e një programi të asistencës teknike, dhe për këtë arsye aktivitetet e lidhura me MS-në duhet të përfshihen në kushtet e referencës së AT-së (shih 3.3). Nëse gjykohet e nevojshme, Eksperti MS i GRUPIT AFD mund të marrë pjesë në negociata në mënyrë që të sigurojë përfshirjen e duhur të klauzolave MS në Marrëveshjen e Lehtësimit të Kredisë.

Tabela 10 Lista e zotimeve MS në Marrëveshjen e Lehtësimit të Kredisë

Klauzola MS	Përshkrimi	Me zgjedhje (Po/Jo)
Përgjegjësia mjedisore dhe sociale	***Zbatimi i masave mjedisore dhe sociale*** *Për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, Palët bien dakord që është e nevojshme të promovohet pajtueshmëria me standardet mjedisore dhe të punës të njohura në nivel ndërkombëtar, përfshirë konventat themelore të*	**Jo** E zbatueshme për të gjitha projektet.

	Organizatës Ndërkombëtare të Punës ("ILO") dhe ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare të mjedisit të zbatueshme në juridiksionin e themelit të Huamarrësit. *Për këtë qëllim dhe në lidhje me veprimtaritë e tij të biznesit, Huamarrësi do [dhe do të sigurojë që secila nga subjektet e vrarura prej tij] të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjet e punës, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendin ku po zbatohet Projekti. Huamarrësi do [dhe do të sigurojë që secila nga subjektet e vrarura prej tij] të kërkojë gjithashtu që [Institucionet Financiare homologe të kërkojnë që] Klientët Përfitues të jenë në përputhje me standardet e sipërpërmendura gjatë kryerjes së biznesit.*	
Zbatimi i SMMS-së dhe PVMS-së nëse do të jetë e nevojshme	**Varianti 1:** *Për të qenë në përputhje me standardet mjedisore dhe të punës të përcaktuara më lart, Huamarrësi do [dhe do të sigurojë që secila nga filialet e tij] të zbatojë sistemin e menaxhimit social dhe mjedisor të vetë:* • duke u siguruar që projektet e tij nuk janë të përfshira në listën e përjashtimi për veprimtaritë e Huamarrësit; • duke zbatuar procesin e menaxhimit të riskut mjedisor dhe social për secilin projekt të Huamarrësit; • duke dorëzuar te Huadhënësi, në çdo përvjetor të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, një raport vjetor në lidhje me sistemin e menaxhimit të riskut mjedisor dhe social, të kënaqshëm për AFD-në. **Varianti 2:** *Huamarrësi duhet të (nëse i përshtatet):* *brenda [dy (2) viteve] nga data e nënshkrimit, zhvillojë dhe vendosë një sistem të menaxhimit të riskut mjedisor dhe shoqëror, në përputhje me parimet e përfshira në PVMS;* *ose brenda [tetëmbëdhjetë (18) muajve] nga data e nënshkrimit, përmirësojë sistemin e menaxhimit të risqeve mjedisore dhe sociale, në përputhje me parimet e përfshira në PVMS;* *Në çdo përvjetor të Datës së Nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i dorëzojë Huadhënësit një raport vjetor në lidhje me statusin e sistemit të tij të menaxhimit të riskut mjedisor dhe social dhe një kalendar të hapave të parashikuara.*	**Po** Në bazë të vlerësimit MS të kryer nga Eksperti MS i GRUPIT AFD, do të zgjidhet një variant ose tjetri, bazuar në kapacitetin operacional të EZ-së për të menaxhuar risqet MS në portofolin e tij.
Menaxhimi i	*(a) Huamarrësi (i) konfirmon se ka marrë një kopje*	**Po**

ankesave MS	*të Procedurave të Menaxhimit të Ankesave MS dhe ka pranuar kushtet e tyre, veçanërisht në lidhje me veprimet që mund të ndërmerren nga Huadhënësi në rast se një palë e tretë paraqet një ankesë, dhe (ii) pranon që Procedurat e Menaxhimit të Ankesave MS kanë, ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit, të njëjtin efekt detyrues kontraktual si kjo Marrëveshje.* *(b) Huamarrësi autorizon shprehimisht Huadhënësin që të ndajë me Ekspertët (siç përcaktohet në Procedurat e Menaxhimit të Ankesave MS) dhe palët e përfshira në auditimin e pajtueshmërisë dhe/ose procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dokumentet e Projektit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të nevojshme për përpunimin e ankesave mjedisore dhe sociale (siç përcaktohet në Procedurat e Menaxhimit të Ankesave MS), përfshirë, pa kufizim, ato të renditura në Shtojcën 11).*	Kjo klauzolë rekomandohet shumë, por nuk është e detyrueshme. Në çdo rast, mekanizmi i ankesave MS i GRUPIT AFD mbetet i zbatueshëm.
Fasha 1A – Përkufizimet		**Po** Kjo fashë përfshin përkufizime në lidhje me menaxhimin e riskut MS nëse është e nevojshme, për shembull nëse kërkohet një PVMS, ai përcaktohet këtu.
Fasha 2 – Përshkrimi i Projektit	Përshkruan përmbajtjen e Projektit si objektivat, përbërësit kryesorë, kriteret e pranueshmërisë, etj.	**Po** Nëse është e nevojshme, aktivitetet e lidhura me MS mund të përfshihen në këtë fashë, siç janë aktivitetet e ndihmës teknike MS, lista e dokumentacionit MS që do të merret, etj.
Fasha 3 – Lista e Përjashtimeve	Shih Shtojcën 1 - Lista e Përjashtimit e GRUPIT AFD Shtojca 1 - Lista e Përjashtimit e GRUPIT AFD	**Jo** E zbatueshme për të gjitha projektet.
Fasha 4 – Kushtet pararendëse	Përshkruan Kushtet Pararendëse që duhen përmbushur gjatë fazave të ndryshme të projektit (firmosja, dhënia e pjesës së parë të fondit)	**Po** Sipas Projektit, kushtet pararendëse MS duhen përfshirë në këtë fashë
Fasha 10 – PVMS	Shih Shtojcën 2 – Model i Planit të Veprimit MS për ndërmjetësuesit financiarë të financuar nga GRUPI AFD	**Po** Aplikohet sipas 2 opsioneve të përshkruara më sipër.
Fasha 11 –	[për tu plotësuar në varësi të Projektit] - Raporti i Studimit MS	**Po**
Lista jo shteruese e	- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social	Vlen, siç përshkruhet më

dokumenteve MS të cilat Huamarrësi lejon të paraqiten në lidhje me procedurat e menaxhimit të ankesave MS	(VNMS) - Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) - Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) - Plani i veprimit për zhvendosjen (PVZh) - Kuadri i Politikave për zhvendosjen (KPZh) - Plani i Zotimit Mjedisor dhe Social (PZMS) - *Vlerësim i kufizuar mjedisor dhe social* - Plani i kufizuar veprimi mjedisor dhe social - Kapitulli nga studimi i realizueshmërisë mjedisore dhe sociale - Kapitujt nga raportet e monitorimit mjedisor dhe social - Raportet e monitorimit të zbatimit të PVMS	sipër, nëse bëhet fjalë për klauzolën e menaxhimit të ankesave MS.

3.2.4. Mbikëqyrja

Gjatë gjithë fazës së zbatimit, dhe në veçanti gjatë periudhës së dhënies së fondit, të gjitha aspektet MS do të monitorohen rregullisht sipas Tabelës 11 paraqitur më poshtë. Zyra vendore e GRUPIT AFD dhe menaxheri i projektit i GRUPIT AFD do të jenë përgjegjës për mbledhjen e dokumentacionit MS nga EZ-ja, veçanërisht Raportet MS. Dokumentacioni do të rishikohet nga eksperti MS i GRUPIT AFD. Nëse është e nevojshme, do të ketë kontrolle vijuese dhe misione monitoruese që përfshijnë ekspertët MS, ose detyra të caktuara ngarkuar konsulentëve të jashtëm për tema MS.

Tabela 11 Plani i Monitorimit MS sipas Kategorive të Riskut

Portofol me Risk të Lartë (NF-A)	**Portofol me Risk të Mesëm (NF-B)**	**Portofol me Risk të Ulët (NF-C)**
- Verifikimi i pajtueshmërisë së EZ-së me angazhimet kontraktuale në lidhje me çështjet MS. - Prodhimi i një raporti vjetor të monitorimit MS nga EZ-ja që përmbush kërkesat e GRUPIT AFD, përfshirë incidentet që kanë ndodhur gjatë vitit dhe masat korrigjuese që janë zbatuar. - Rishikim i raportit vjetor të monitorimit MS. - Vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit MS, nëse është e vlefshme. - Nëse është e nevojshme, përcaktimi i masave parandaluese dhe korrigjuese që do të zbatohen. - Nëse është e nevojshme, monitorimi i çështjeve MS gjatë misioneve mbikëqyrëse.		

Çdo vit pritet një raport MS i cili duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:
- Ndarja e portofolit të EZ-së sipas kategorive te risqeve MS;
- Datat dhe përmbajtja e përditësimeve të mundshme të politikave dhe procedurave MS;
- Përshkrimi i organizimit dhe përgjegjësive MS;

- Ndërgjegjësimi/Plani i Trajnimit dhe/ose raportimi;
- Lista e projekteve me risqe të larta MS;
- Lista e studimeve MS të kryera;
- Lista e projekteve të refuzuara për arsye MS;
- Lista e auditimeve MS dhe vizitave në terren të kryera;
- Lista e incidenteve të rëndësishme MS;
- Përshkrimi i masave parandaluese dhe korrigjuese MS të planifikuara dhe/ose të zbatuara.

Në rast se është rënë dakord për një PVMS midis GRUPIT AFD dhe EZ-së, raportet e progresit që japin detaje mbi zbatimin e PVMS-së duhet t'i dërgohen të paktën në bazë vjetore GRUPIT AFD nga EZ-ja. Asistenca teknike pritet të ketë një rol të konsiderueshëm në këtë drejtim.

3.2.5. Vlerësimi Mbas

Kryerja e vlerësimit pas punimeve për projektet e financuara nga GRUPI AFD nuk është sistematike. Kurdo që është e nevojshme, vlerësimi i aspekteve MS dhe se si ato janë marrë parasysh dhe menaxhuar do të përfshihen në vlerësimin pas punimeve. Vlerësime të tilla kryhen nga ekspertë të jashtëm nën mbikëqyrjen e zyrave vendore të GRUPIT AFD, ekipit vlerësues të GRUPIT AFD dhe, nëse është e nevojshme, ekspertëve MS të GRUPIT AFD.

3.3. MRMS në nivelin e Nënprojekteve

Në përputhje me qasjen e Grupit AFD ndaj MRMS-së për ndërmjetësuesit financiarë, EZ-të do të jenë përgjegjëse për kryerjen e menaxhimit të riskut MS për nënprojektet sipas SMMS-ve të miratuara nga GRUPI AFD.

Kjo nënkupton integrimin e plotë të MRMS-së në ciklin e kreditimit të EZ-së.

Tabela e mëposhtme jep me hollësi hapat kryesorë të procesit të menaxhimit të riskut MS për nënprojektet që do të financohen në bazë të Programit. EZ është përgjegjës për ndjekjen e këtij procesi.

Table 12 Procesi i vlerësimit të kujdesshëm MS

Fazat e Ciklit të Projektit	Veprimet për MRMS	Rolet dhe Përgjegjësitë
Identifikimi	Kontrolli i nënprojektit kundrejt listës së përjashtimit të GRUPIT AFD-GCF	Oficeri Investimit i EZ-së
	Përcaktimi i kategorisë së riskut MS (A/B/C)	Eksperti MS i EZ-së (ose Oficeri i Investimit)
Udhëzimi (Realizueshmëria dhe Vlerësimi)	A: Identifikimi i PVMS-së më të suksesshme që do të kryhet (VNMS, SESA…), përgatitja e TR për studimet MS dhe rekrutimi i konsulentëve të jashtëm B: Integrimi i aspekteve MS në studimet e realizueshmërisë ose rekrutimi i konsulentit të VNMS-së; verifikimi i pajtueshmërisë me rregulloret kombëtare (lejet, etj.) C: Verifikimi i pajtueshmërisë me rregulloret kombëtare (lejet, etj.)	Eksperti MS i EZ-së + Ekipi I Investimeve

	A dhe B: Kryerja e studimeve të nevojshme (VNMS, etj.)	Konsulentë të jashtëm
	Rishikimi dhe miratimi përfundimtar i studimeve të kryera	Eksperti MS i EZ-së
Zotimi	Përgatitja e klauzolave MS për t'u integruar në MFK	Eksperti MS i EZ-së dhe Ekipi i Investimeve
Mbikëqyrja	Vizita në terren, rishikim i raporteve të monitorimit të PMMS-së	Eksperti MS I EZ

3.3.1. Masat mbrojtëse të zbatueshme

Siç përshkruhet më poshtë, masat mbrojtëse të zbatueshme MS për nënprojekte janë (i) legjislacioni kombëtar për të gjitha projektet, dhe (ii) Standardet e Performancës së IFC-së për projektet me rrezik të lartë.

3.3.2. Kriteret për Vlerësimin e Riskut

Për të përcaktuar një kategori risku, çdo Nënprojekt duhet të vlerësohet nga EZ-ja përmes kritereve të mëposhtme:
- Përhapja dhe përmasa e ndikimeve negative;
- Ndjeshmëria e zonës përkatëse;
- Përkohshmëria;
- Qeverisja dhe kapaciteti i zotëruesit të projektit për të menaxhuar projektin;
- Ndikimet e mbledhura/kumulative në zona të ndryshme gjeografike;
- Pasojat e një aksidenti të madh.

3.3.3. PVMS e Pritshme sipas Kategorive të Riskut

Për çdo nënprojekt, EZ-ja duhet t'i referohet tabelës së mëposhtme:

Tabela 13 MS procesi i vlerësimit

Niveli/Kategoria e Riskut MS	***Risk i Lartë***	***Risk i Mesëm***	***Risk i Ulët***
Kuadri Rregullator MS	**Rregulloret Kombëtare dhe Ndërkombëtare** të zbatueshme në vendin në fjalë (përfshirë konventat e ILO-s) dhe **standardet e performancës së IFC-së**	**Rregulloret Kombëtare dhe Ndërkombëtare** të zbatueshme në vendin në fjalë (përfshirë konventat e ILO-s)	**Rregulloret Kombëtare dhe Ndërkombëtare** të zbatueshme në vendin në fjalë (përfshirë konventat e ILO-s)

PVMS i kërkuar	**Vlerësimi i Ndikimit MS (VNMS)** Kryhet njëkohësisht me studimet teknike dhe nga ekspertë të pavarur. =>Nevojitet dokumentacioni MS (për t'u miratuar nga eksperti MS i EZ-së): - **VNMS dhe PMES** [OSE Korniza e Menaxhimit MS - **KMMS** – kuadrimi i VNMS/PMMS të ardhshëm]; - [Në rast të zhvendosjes së pavullnetshme të popullsisë] **Plani i veprimit për zhvendosje - PVZh** [OSE Korniza e politikave të zhvendosjes - KPZh - kuadrimi i PVZh-së së ardhshme]; - [+ mundësisht] studime të tjera të veçanta MS (p.sh. IPP, IPPF).	**Studim proporcional MS** (mundësisht i integruar në studimin e realizueshmërisë) => Nevojitet dokumentacioni MS (për tu vërtetuar nga eksperti MS i EZ-së): **- Studimi proporcional MS dhe kapitulli PLMS OSE MS në studimin e realizueshmërisë** (+ çdo dokument tjetër i veçantë shtesë MS).	Kontrolli fillestar i riskut MS.

EZ-ja është përgjegjëse për vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit MS lidhur me nënprojektet e financuara nga Programi.

3.3.4. Lista me treguesit e rreziqeve dhe ndikimeve MS për secilin sektor të pranueshëm në Program

Tabela 14 Lista me treguesit e risqeve dhe ndikimeve MS për sektorët e pranueshëm në Programin (NF)

Sektori	Shembuj Projektesh	Risqe/Ndikime Mjedisore	Risqe/Ndikime Sociale
Banesat sociale dhe përmirësimi i strehimit	Ndërtimi në fusha të gjelbra i objekteve për banesa Rinovimi i banesave ekzistuese (p.sh. efiçenca e energjisë në projektet e strehimit)	Ndryshimet në rrjedhjet e ujërave sipërfaqësore Ndikimet në cilësinë e ujit Çlirimi i ndotësve Prodhimi i mbetjeve	Të gjitha rreziqet që lidhen me kushtet e punës Rritja e ndotjes akustike Ndikimet në infrastrukturat dhe

Shëndetësia	Ndërtimi ose zgjerimi i qendrës shëndetësore ose spitalit Rinovimi i qendrës shëndetësore ose zgjerimi	material të dëmshëm dhe jo të dëmshëm Ndikimet në konsumin e burimeve (energji dhe ujë) Kontributi në ndryshimin e klimës (emetimet e GES) Ndikimet në biodiversitetin dhe zonat natyrore Ndikimet në trashëgiminë kulturore	rrjetet ekzistuese Ekspozimi i shtuar dhe ekspozimi ndaj rrezikut të shëndetit dhe sigurisë Rreziqet në lidhje me projektet dhe qeverisjen vendore, angazhimin e palëve të interesit, komunitetet vendore Sëmundje mjedisore (p.sh. ekspozimi ndaj plumbit, azbestit) Presioni mbi zotërimin e tokës dhe rritja e kostos së tokës ose kostos së qirasë), pranimi social Zhvendosjet e pavullnetshme Ndryshimet në zakonet shoqërore dhe organizimin social
Arsimi	Ndërtimi i shkollave, universiteteve, klasave në zonat rurale, kompleksève shkencore, etj. Rinovimi i qendrës së trajnimit Zgjerimi i universitetit		
Ndërtimi Publik	Masat e efiçencës së energjisë në ndërtesat publike, në qendrën administrative		
Industria	Përmirësimi i konsumit të energjisë ose konsumit të ujit në proceset industriale (agrobiznesi, fabrika e çimentos, etj.)		
Transporti	Fusha e gjelbër e ndërtimit e projektit tokë jo e gjelbër (greenfield, brownfield) e efiçencës së energjisë në stacionin e trenit, stacionin e autobusit		
Sektor të tjerë të ndërtimit	Efikasiteti i energjisë në treg, qendër tregtare, zyra, etj.		
Sektori Financiar	Fondi i kapitalit që ka investuar në hotele dhe disa prej tyre kanë nevojë për rinovime Banka vendore që dëshiron të ofrojë hua për investime në banesa me eficencë energjetike		

3.4. Çështje MS të veçanta

Çështjet MS të detajuara MS më poshtë do të vlerësohen në përputhje me Standardet e Performancës lidhur me IFC-në, dhe duke zbatuar të njëjtën hierarki zbutëse, si për shembull shmangien, dhe në rast se shmangia është e pamundur, zvogëlimin e ndikimeve të papëlqyeshme te njerëzit dhe mjedisi duke minimizuar dhe/ose kompensuar rreziqet negative MS .

Siç përshkruhet më sipër në qasjen MRMS, sa herë që një Projekt ose një Nënprojekt klasifikohet si projekt me risk të lartë, duhet të zbatohen Standardet e Performancës së IFC-së dhe Shënimet Interpretuese dhe Udhëzuese përkatëse. EZ-të janë përgjegjëse zbatimin e këtyre standardeve në Nënprojektet dhe GRUPI AFD siguron, përmes kujdesit të duhur MS për Projektet, që EZ-të të zbatojnë kërkesa të tilla dhe të kenë kapacitetin për ta bërë këtë.

3.4.1. Zhvendosja e Pavullnetshme

Zhvendosja e pavullnetshme nënkupton si zhvendosjen fizike (zhvendosja ose humbja e strehës) ashtu edhe zhvendosjes ekonomike (humbja e pasurive ose disponueshmëria e aseteve që çon në humbjen e burimeve të të ardhurave ose mjeteve të tjera të jetesës) si rezultat i blerjes së tokës në lidhje me projektin dhe/ose kufizimet në përdorimin e tokës.

Në kuadrin e Programit, të gjitha Projektet dhe Nënprojektet duhet të hartohen në mënyrë që të shmanget zhvendosja e pavullnetshme duke marrë parasysh të gjitha alternativat në fazën e hartimit të projektit. Kur shmangia nuk është e mundur, do të ndiqen objektivat e mëposhtme, në përputhje me SP5 të IFC-së:

- Të minimizohet zhvendosja dhe ndikimet e papëlqyeshme sociale dhe ekonomike nga blerja e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës duke (i) siguruar kompensim për humbjen e aseteve me koston e zëvendësimit dhe (ii) duke siguruar që aktivitetet e zhvendosjes të zbatohen me dhënien e duhur të informacionit, konsultimin dhe pjesëmarrjen e informuar të të prekurve;
- Të shmangen dëbimet e detyruara;
- Të përmirësohet ose rivendoset jetesa dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur;
- Të përmirësohen kushtet e jetesës për personat e zhvendosur fizikisht përmes sigurimit të strehimit të përshtatshëm me sigurinë e zotërimit në vendet e zhvendosjes.

Për këtë qëllim, procesi i identifikimit të rrezikut MS duhet të identifikojë nëse SP5 janë të zbatueshme, d.m.th. nëse investimi përmbush një nga llojet e transaksioneve të lidhura me tokën të renditura në Nenin 5 të SP5. Bazuar në këtë vlerësim fillestar, mund të kërkohet një Plan i Veprimit për Zhvendosje (PVZh) ose një Plan i Rivendosjes së Mjeteve të Jetesës (PRMJ) i cili duhet të zbatohet duke ndjekur kërkesat e SP5.

Kushtet e Referencës Treguese për një Plan Veprimi për Zhvendosjen dhe një Plan të Rivendosjes së Jetesës si edhe një Kornizë të Politikës së Zhvendosjes janë në dispozicion në Shtojcë.

3.4.2. Popujt Autoktonë

GRUPI AFD pranon se Popujt Autoktonë, si grupe shoqërore me identitete që dallojnë nga grupet kryesore në shoqëritë kombëtare, shpesh janë ndër segmentet më të margjinalizuara dhe më të prekshme. Në të njëjtën kohë, Projektet dhe Nënprojektet mund të paraqesin mundësi që Popujt Autoktonë të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga veprimtaritë e lidhura me projektin.

Në përputhje me Politikën e FKGj-së për Popujt Autoktonë, Programi do të sigurojë që Popujt Autoktonë (i) të mos pësojnë dëm ose efekte anësore nga hartimi dhe zbatimi i veprimtarive të lidhura me programin, dhe (ii) të përfitojnë nga veprimtaritë e programit në mënyrë të përshtatshme kulturore.

Në mënyrë që të kontribuojnë në këto objektiva, nga EZ-të kërkohet të mbështesin pjesëmarrjen e plotë dhe të efektshme të Popujve Autoktonë në Nënprojektet që ata financojnë, në përputhje me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Popujve Autoktonë dhe Standardin e Performancës 7 të IFC-së, përfshirë veçanërisht të drejtën për pëlqim të lirë, paraprak dhe të informuar.

Ndikimet e projekteve dhe nënprojekteve në Popujt Autoktonë duhet të identifikohen gjatë procesit të identifikimit të rrezikut MS dhe, kur priten ndikime të rëndësishme, një Plan i Popujve Autoktonë (PPA) duhet të hartohet duke ndjekur kërkesat e SP7 të IFC-së.
KPPA dhe një përshkrim tregues i PPA-së janë dhënë në Shtojcë.

3.4.3. Ruajtja e biodiversitetit dhe kontrolli i ndotjes

Në përputhje me objektivat e Programit, të gjitha Projektet dhe Nënprojektet duhet të hartohen dhe të zbatohen në një mënyrë që siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve kulturore, duke ruajtur përfitimet e shërbimeve të ekosistemit dhe duke promovuar përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të gjalla.
Procesi i identifikimit të rrezikut MS duhet të identifikojë ndikimet e mundshme negative të veprimtarive të Programit në biodiversitetin dhe burimet natyrore dhe, kur është e mundur, duhet të merren masat e duhura për të shmangur ndikime të tilla negative. Kur shmangia nuk është e mundur, menaxhimi i rrezikut duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e SP6 të IFC-së.
Për më tepër, aktivitetet e Programit do të hartohen dhe zbatohen në mënyrë që të promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve, duke përfshirë veçanërisht energjinë dhe ujin, dhe për të zvogëluar emetimet e GES-eve. Për këtë qëllim, Projektet dhe Nënprojektet pritet të zhvillohen dhe zbatohen në përputhje me SP3 të IFC-së për Efiçencën e Burimeve dhe Parandalimin e Ndotjes.

3.4.4. Marrëdhëniet e punës dhe shëndeti e siguria e komunitetit

Përputhshmëria me të gjitha rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të punës të zbatueshme në vend, përfshirë konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), si edhe kërkesat themelore në drejtim të menaxhimit të BNJ dhe përgjegjësisë shoqërore të korporatave dhe kushteve të punës dhe punonjësve vlerësohen nga GRUPI AFD gjatë Vlerësimit MS.
Gjithashtu, nga EZ-ja kërkohet që të sigurojë kushte pune dhe punonjësish të përshtatshme dhe shëndetin dhe sigurinë e komunitetit në Nënprojekte, në përputhje me Udhëzimet e SP2, SP4 dhe MShS të IFC-së.
Këto kërkesa vlejnë për klientët e EZ-së, si edhe kontraktorët e projektit.

3.4.5. Trashëgimia Kulturore

Trashëgimia Kulturore, përfshirë burimet kulturore të prekshme dhe të paprekshme, duhet të mbrohet nga ndikimet e papëlqyeshme të veprimtarive të lidhura me Programin dhe ruajtja e saj duhet të mbështetet, në përputhje me SP8 të IFC-së për Trashëgiminë Kulturore dhe SP7 për Popujt Autoktonë (në veçanti lidhur me Trashëgiminë Kulturore Kritike).
EZ-ja duhet të sigurojë që, në rast se një Nënprojekt mund të ndikojë në Trashëgiminë Kulturore siç përcaktohet nga SP8, mbrojtja e duhur dhe ndarja e barabartë e përfitimeve nga përdorimi i trashëgimisë kulturore do të sigurohet gjatë hartimit dhe ekzekutimit të projektit. Procesi i identifikimit të riskut MS përcakton nëse projekti ka ndikim në trashëgiminë kulturore dhe nëse duhet të zbatohen kërkesat e SPS.

IV. Ndarja e informacionit, angazhimi i palëve të interesit dhe zgjidhja e ankesave

4.1. Angazhimi i palëve të interesit dhe ndarja e informacionit

Angazhimi i komunitetit dhe palëve të interesit është përbërës kryesor i Kornizës MS të Programit. Palët e interesit përkufizohen si grupe ose individë që preken drejtpërdrejt dhe/ose jo drejtpërdrejt nga një projekt, të cilët kanë ose mund të kenë interes në të, ose mund të ndikojnë tek ai në mënyrë pozitive ose negative. Si të tillë, palët e interesit mund të jenë komunitetet lokale, individët, përfaqësuesit e tyre, organet qeveritare, organizatat e shoqërisë civile, etj. Qasja për angazhimin e palëve të interesit për Programin bazohet në SP1 të IFC-se dhe në Manualin e IFC-së për Angazhimin e Palëve të Interesit[10].

4.1.1. Qasja e AFD-së për Angazhimin e Palëve të Interesit dhe Ndarjen e Informacionit

Në përputhje me politikën e saj të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK)[11], AFD-ja operon në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, duke kërkuar që informacioni i duhur, lidhur me çështjet MS, të vihet në dispozicion të komuniteteve të prekura dhe potencialisht të prekura në nivelin e projekteve, si dhe palëve të jashtme të interesit të AFD-së në përgjithësi. Për këtë qëllim, AFD-ja çdo vit boton një raport PSK në përputhje me Nismën Globale të Raportimit (GRI4), ISO26000, Kompaktin Global dhe legjislacionin Francez në lidhje me kërkesat e transparencës MS të organizatave. Për më tepër, informacioni mbi projektet e financuara nga AFD-ja publikohet në portalin e internetit të AFD-së "OpenData"[12], në faqen e internetit të "Nismës Ndërkombëtare të Transparencës së Ndihmës"[13], dhe në platformën e të dhënave Publike Franceze[14]. Në mënyrë që të sigurohet efiçenca, efektshmëria dhe qëndrueshmëria e projekteve, AFD-ja përfshin dhe zhvillon partneritet dhe/ose konsultim me shoqërinë civile në të gjitha fazat e ciklit të jetës së projektit, përfshirë hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e projektit. Pikëpamjet dhe shqetësimet e autoriteteve vendore, komuniteteve të prekura dhe organizatave vendore të shoqërisë civile mbi ndikimet e mundshme të aktiviteteve të financuara, veçanërisht në rast të çështjeve të rëndësishme MS, janë thelbësore. Për këtë qëllim, AFD-ja siguron përmes angazhimeve kontraktuale dhe asistencës teknike që zotëruesi i projektit të konsultohet dhe të angazhojë të gjitha palët e interesit të projektit dhe komunitetet vendore në veçanti. Interesat dhe shqetësimet e palëve të interesit merren gjithashtu parasysh në vlerësimin e projektit.

4.1.2. Qasja Proparco për Angazhimin e Palëve të Interesit dhe Ndarjen e Informacionit

Proparco financon projekte ekzistuese ose projekte të reja në përputhje me qasjen MRMS të detajuar në seksionin 2.4 më lart. Të gjitha projektet me risqe MS të konsiderueshme deri në të larta duhet të jenë në përputhje me standardet e performancës së IFC-së, duke kërkuar që të gjitha projektet të angazhohen me palët e interesit në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Si pjesë

[10] https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/topics_ext_content/ifc_external_corporate_site/sustainability-at-ifc/publications/publications_handbook_stakeholderengagement__wci__1319577185063
[11] https://www.afd.fr/fr/notre-responsabilite-societale
[12] https://opendata.afd.fr/page/accueil/
[13] https://iatiregistry.org/publisher/afd
[14] http://www.data.gouv.fr/fr/

e SP1 të IFC-së, projekti do të duhet të identifikojë të gjitha palët e interesit dhe të hartojë një strategji të angazhimit të palëve të interesit, të përshtatur sipas specifikave të projekteve gjatë jetës së tij. Një qasje e tillë synon krijimin e një hapësire dialogu për t'u ofruar të gjitha palëve të interesit kuptueshmëri të mirë të projektit dhe ndikimeve të tij të mundshme dhe për të vlerësuar interesat dhe shqetësimet e palëve të interesit të lidhura me projektin. Përputhshmëria me SP1 të IFC-së vlerësohet gjatë procesit të vlerësimit të Proparco-s dhe monitorohet gjatë jetës së projektit Proparco, sipas kushteve të detajuara në seksionin 2.4.

4.1.3. Qasja për Programin

Konsultimet me palët e interesit kryhen nga agjencitë vendore dhe në bazë të projekteve. Ato do të përshkruhen në dokumentet e vendit të përgatitura nga agjencitë.

Në kuadrin e Programit dhe në përputhje me qasjen FKGj për angazhimin e palëve të interesit, AFD-ja kërkon që EZ-të të sigurojnë angazhimin e efektshëm të komuniteteve, popullatave në nevojë, grupeve dhe individëve, popujve autoktonë, komuniteteve vendore dhe grupeve të tjerë të margjinalizuara të njerëzve dhe individëve që preken/ose janë potencialisht të prekshëm nga veprimtaritë e Programit. Informacioni në lidhje me çështjet MS mbi veprimtaritë e financuara në kuadrin e Programit bëhet i disponueshëm në përputhje me politikën FKGj të ndarjes së informacionit dhe do të ndahet në faqen e internetit të AFD-së. Kjo përfshin Kornizën aktuale MS, e cila është e disponueshme në gjuhët e vendeve partnere.

Në nivelin e Projektit dhe Nënprojektit, palët e interesit që duhet të angazhohen duhet të identifikohen gjatë procesit të vlerësimit të projektit, në përputhje me nivelin e interesit dhe ndikimin në projekt. Ky identifikim pritet të analizohet përmes studimeve të realizueshmërisë dhe/ose VNMS-së. Për më tepër, në rast se nevojitet një VNMS, duhet të kryhet analiza e palëve të interesit dhe duhet të identifikohen qartë aspektet e projekteve dhe/ose lehtësitë që mund të sjellin ndikim të papëlqyeshëm MS për komunitetet vendore dhe individët dhe palët e tjera të interesit. Kur është e nevojshme, duhet të zhvillohet dhe zbatohet një Plan Angazhimi i Palëve të Interesit (PAPI) i shkallëzuar për rreziqet dhe ndikimet e projektit, dhe i përshtatur për nevojat e komuniteteve të prekura. Një përshkrim tregues i PAPI-t gjendet në Shtojcë.

Sipas aktiviteteve të financuara përmes EZ-ve, EZ-të duhet të sigurojnë përputhshmërinë e investimeve të tyre me Standardet e Performancës së IFC-së dhe t'u sigurojnë komuniteteve të prekura dhe palëve të tjera të interesit, kur është e zbatueshme, mundësi marrjeje të informacionit përkatës për: (i) qëllimin, natyrën dhe shkallën e projektit , (ii) kohëzgjatjen e veprimtarive të propozuara të projektit, (iii) çdo rrezik dhe ndikim të mundshëm në komunitete të tilla dhe masat përkatëse zbutëse, (iv) procesin e parashikuar të angazhimit të palëve të interesit, dhe (v) mekanizmin e ankesave. EZ-të janë përgjegjëse për të siguruar Konsultimin dhe Pjesëmarrjen e Informuar për Nënprojektet që do të financohen në bazë të Programit, aty ku është e zbatueshme. Në rastin e veçantë të Projekteve me ndikime të papëlqyeshme për popujt autoktonë, do të kërkohet marrja e pëlqimit të lirë, paraprak dhe të informuar, në përputhje me Standardet e Performancës së IFC-së, dhe veçanërisht SP7.

4.2. Mekanizmat e zgjidhjes së ankesave MS

Mekanizmi i ankesave MS është një mekanizëm rekursi jashtë gjykatës që lejon çdo person ose grup personash të prekur nga ndikimet MS të një projekti të paraqesë një ankesë. Qëllimi i mekanizmave të tillë, sipas Politikës së FKGj (7.3) është të sigurojë hapësirë për ankesa dhe zgjidhje, dhe të lehtësojë zgjidhjen e ankesave për ndikimet MS në veprimtari.

Qasja e Programit për ankesat dhe zgjidhjet MS mbështetet në procedurat e ankesave MS të AFD-së dhe FKGj-së, qasjen e EZ-së ndaj ankesave MS dhe mekanizmat e mundshme të ankesave – kur ato ekzistojnë - dhe mekanizmat e ankesave të ngritura në kuadrin e nënprojekteve. Si rezultat, rekursi në Mekanizmin e Pavarur të Ankimimit të FKGj[15] dhe në Mekanizmin e Ankesave MS të AFD-së[16] mundësohet për të gjitha nivelet e Programit.

4.2.1. Mekanizmi i Ankesave MS i AFD-së dhe Proparco-s

Mekanizmi i Ankesave MS të AFD-së rrit transparencën e AFD-së mbi aktivitetet e saj dhe bëhet pjesë e një dialogu të thelluar midis partnerëve të saj nga shoqëria civile, parlamentarët, agjencitë e vlerësimit jo-financiar dhe Komisioni Kombëtar Konsultativ për të Drejtat e Njeriut (CNCDH). Mekanizmi synon të sigurojë se ekziston një trajtim i pavarur i Ankesave të dërguara në AFD, nga një ose disa persona fizikë ose juridikë, në lidhje me ndikimet mjedisore ose sociale të një projekti të kryer në vendet e huaja, financimi i të cilit është alokuar nga AFD, duke përjashtuar projektet e iniciuara nga OJQ-të.

Mekanizmi ka dy metoda për trajtimin e ankesave:

- Funksioni i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, i cili synon të rivendosë dialog midis Autorit të Ankesës ose Përfaqësuesit të tij dhe EZ-së në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për problemin(et) që çuan në ankesë;
- Funksioni i auditimit të përputhshmërisë, i cili synon të përcaktojë nëse AFD-ja ka qenë në përputhje me Procedurën e Menaxhimit të Rrezikut Mjedisor dhe Social në lidhje me një projekt të financuar nga AFD-ja, i cili ka qenë subjekt i një marrëveshjeje të nënshkruar.

Rregullat e Procedurave të Mekanizmit janë shpalosur në faqen e internetit të AFD-së[17] dhe përcaktojnë kushtet për Regjistrim dhe Pranueshmëri, si dhe metodën me të cilën Mekanizmi merret me Ankesën, d.m.th. auditimin e përputhshmërisë, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose një kombinim të të dyjave. Ai gjithashtu specifikon pika të tjera në lidhje me mënyrën e funksionimit të Mekanizmit, të tilla si koha e trajtimit, marrja e informacionit, ose trajnimi dhe ndërgjegjësimi për stafin e AFD-së. Funksionet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe auditimit të përputhshmërisë nuk parashikojnë kompensim nga AFD-ja.

Një ose disa persona fizikë ose juridikë të prekur nga një projekt i financuar nga AFD, dhe Ankesa e të cilit/ëve lidhet me aspektet MS të projektit, mund të paraqesin Ankesën MS në Sekretariatin e Mekanizmit. Nëse gjykohet e pranueshme nga Paneli i Ekspertëve të Pavarur, Ankesa vlerësohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose kontrollin e përputhshmërisë.

Një qasje e ngjashme u miratua nga Proparco-ja në janar të vitit 2019 kur Proparco-ja vendosi një mekanizëm të pavarur të ankesave. Një mekanizëm i tillë është iniciativë e përbashkët me DEG -

[15] http://www.greenclimate.fund/independent-redress-mechanism

[16] AFD: https://www.afd.fr/fr/dispositif-de-gestion-des-reclamations-environnementales-et-sociales
Proparco: https://www.proparco.fr/fr/icm

[17] https://www.afd.fr/fr/dispositif-de-gestion-des-reclamations-environnementales-et-sociales

Deutsche Investitions und Entëicklungsgesellschaft dhe FMO - *Holland Development Company Finance*.
Mekanizmi i Pavarur i Ankesave përbëhet nga një Panel i Pavarur Ekspertësh, përfshirë tre persona me ekspertizë mjedisore, sociale, ligjore dhe financiare. Ky panel, i pavarur nga Proparco-ja, do të vlerësojë të drejtën e ankesës dhe do të përcaktojë metodën e duhur për trajtimin e ankesës sipas procesit të AFD-së të përshkruar më sipër.
Të gjitha informacionet në lidhje me mekanizmin e ankesave Proparco shfaqen në faqen e internetit të Proparco.

4.2.3. Mekanizmat e ankesave të GIZ-it në nivelin e Entit Zbatues

Si kompani federale jo-fitimprurëse, GIZ-i ka detyrim të veçantë të merret me fondet (publike) që i janë besuar dhe t'i trajtojë ato me efektshmëri dhe përgjegjshmëri, të japë llogari të plotë dhe t'ia paraqesë punën e saj me transparencë publikut.
Në mënyrë që të ruajë këtë standard, të identifikojë defekte në sistem si edhe shpërdorime nga individët dhe, si rrjedhojë të shmangë dëmin si brenda ashtu edhe jashtë kompanisë, GIZ-i ka vënë në funksion një mekanizëm ankesash.
Ky mekanizëm lejon marrjen e raportimeve të shkeljeve të verifikueshme dhe të dyshuara në "portalin e bilbilfryrjes". Portal i bilbilfryrjes shërben si kanal komunikimi për raporte që kanë të bëjnë me shkelje serioze të kodit të sjelljes në GIZ, rregullave të brendshme ose ligjeve të kompanisë. Të gjitha raportimet vlerësohen me kujdes dhe menaxhohen me konfidencialitet. GIZ-i siguron që të mos ketë pasoja negative për asnjë bilbilfryrës i cili dorëzon një raportim të justifikuar.

4.2.3. Mekanizmat e ankesave në nivel Projekti dhe Nënprojektesh

Në nivelin e Projektit dhe Nënprojektit, mekanizmat e ankesave duhet të hartohen për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve ose konflikteve sipas rastit, në lidhje me rreziqet MS dhe ndikimet e projektit. Nevoja ose rëndësia e hartimit të mekanizmave të tillë do të vlerësohet gjatë fazës së vlerësimit të projektit dhe vlerësimit MS. Mekanizmat e ankesave duhet të përshtaten në nivelin e rreziqeve dhe ndikimeve MS të projektit, me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve ose konflikteve përmes një procesi konsultativ të kuptueshëm dhe transparent në përputhje me projektin dhe/ose kontekstin vendor. Mekanizmi do të jetë i lirë dhe nuk do të pengojë mundësinë e përdorimit të mjeteve juridike ose administrative. Zotëruesit e projekteve duhet të komunikojnë për ekzistencën e mekanizmave të tillë dhe të informojnë palët e interesit të projektit në përputhje me rrethanat. Mekanizmat e ankesave në nivelin e Projektit dhe Nënprojektit janë hartuar së pari në mënyrë që të lejojnë zgjidhjen miqësore të një mosmarrëveshjeje ose ankese. Nëse kjo nuk është e mundur, ankesa duhet të zgjidhet përmes një procesi zyrtar ligjor.
Në nivelin e Projektit dhe Nënprojektit, mekanizmat e ankesave mund të mbulojnë një sërë aspektesh të projektit, përfshirë aspekte të përgjithshme të tilla si planifikimi, ndërtimi dhe funksionimi, procesi i kujdesit të duhur MS dhe ndikimi i tyre, dhe çështje të veçanta të tilla si proceset e zhvendosjes dhe kompensimi i lidhur me to.
Siç përcaktohet nga Standardet e Performancës së IFC-së që duhet të zbatohen të paktën në Projektin dhe Nënprojektin me rrezik të lartë të financuar nga Programi, mekanizmat specifike të ankesave MS duhet të vendosen në nivelin e Nënprojektit kur është e nevojshme, si më poshtë:

- Për tërë kohëzgjatjen e projektit, me qasjen e përshkruar më sipër, për të lehtësuar tregimin e hershëm të, dhe rikompensimin e shpejtë për ata që besojnë se janë dëmtuar nga një projekt ose veprimtaritë përkatëse të tij (SP1);

- Për projektet ku SP2 është i zbatueshëm, mekanizmi i ankesave për punëtorët për të ngritur shqetësime në vendin e punës, e vlefshme për punëtorët me kohë të plotë, punëtorë të kontraktuar dhe/ose punëtorë të kompanive furnizuese;
- Për projektet ku SP4 është i zbatueshëm, mekanizmi i ankesave për komunitetet e prekura për të shprehur shqetësime në lidhje me rregullat e sigurisë dhe veprimet e personelit të sigurisë;
- Për projektet ku SP5 është i zbatueshëm, mekanizmi i ankesave duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur në fazën e zhvillimit të projektit, në mënyrë që të lejojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me kompensimin dhe/ose zhvendosjen e pashmangshme.

V. MRMS në nivelin e Asistencës Teknike

5.1. Përmbajtja e Programeve të Asistencës Teknike MS

Ndër aktivitetet e tjera, dhe kur është e nevojshme, asistenca teknike do të jetë përgjegjëse për:

a) Mbështetjen e PVMS në projektin e financuar drejtpërdrejt

Sipas kërkesave dhe proceseve të përshkruara në këtë manual, vlerësimi i rrezikut MS do të kryhet në nënprojekte dhe do të përcaktohen dhe zbatohen masat e duhura zbutëse. Për këtë arsye, asistenca teknike mund të jetë e orientuar drejt kujdesit të duhur MS për projektet: të sigurojë zbatimin e PMMS ose KMMS të projektit, të respektojë kushtet siç përcaktohet në PZMS, të koordinojë veprimtaritë mjedisore dhe sociale, të sigurojë monitorimin dhe raportimin e veprimtarive, etj.

b) Mbështetjen e zhvillimit ose forcimit të SMMS-ve të EZ-së për projektin e ndërmjetësuar

Në përputhje me PVMS të diskutuar dhe miratuar midis AFD-së dhe EZ-së, AT-ja do të ndihmojë EZ-në për të ndërtuar kapacitete në menaxhimin e riskut MS, përmes zhvillimit të forcimit të sistemit të tij të menaxhimit MS. Për këtë qëllim, mund të zhvillohen nga AT-ja veprimtaritë e mëposhtme:

- Përcaktimi i planeve të hollësishme të veprimit për krijimin dhe zbatimin e SMMS,
- Kryerja e seancave të ndërgjegjësimit për të angazhuar punonjësit e EZ-së dhe menaxhimin e lartë në MRMS,
- Hartimi dhe/ose përditësimi i procedurave dhe mjeteve, dhe udhëzimeve sektoriale nëse është e rëndësishme,
- Trajnimi i stafit të EZ-së për menaxhimin e riskut MS dhe procedurat dhe mjetet e reja,
- Mbështetje për raportimin MS.

5.2. Procesi i rekrutimit të AT-së

Mbajtur nga një firmë këshilluese ose një konsorcium i firmave këshilluese, ekipet e Asistencës Teknike duhet të rekrutohen duke ndjekur procedurat dhe kërkesat e prokurimit të AFD [18][19].

Mbështetja për MRMS-në është zakonisht përbërës i Programeve të AT-së, dhe përfshihet në termat e referencës së prokurimit. Këto terma reference përfshijnë veprimtari të tilla si ato të përmendura më lart dhe janë përshtatur për nevojat, në veçanti, për kapacitetin ekzistues të EZ-së për të menaxhuar rreziqet MS në portofolin e vet.

[18] https://www.afd.fr/sites/afd/files/2017-09/directives-passation-marches-etats-etrangers-english-version.pdf
[19] https://www.afd.fr/en/responding-bid-invitation

Ekspertët MS zakonisht janë inxhinierë shkencash mjedisore dhe/ose sociale me ekspertizë të fortë në menaxhimin e risqeve MS dhe njohuri të shkëlqyera të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira MS, mundësisht masave mbrojtëse të IFC-së. Ata nuk kanë nevojë të kenë ekspertizë të fortë financiare por thjesht të jenë të aftë të kuptojnë ciklin e kreditimit të EZ-së dhe si mund të jetë në përputhje me proceset e PVMS, si dhe të kenë kapacitet dhe vullnet të fortë për punë në ekip.

5.3. MRMS në nivelin e "projektit të politikës"

Për shkak të qasjes së lehtësimit të ndërmarrë në *PEEB Cool*, veprimtaritë e projektit brenda komponentit të lehtësimit të politikave do të përcaktohen për secilin vend individualisht pas fillimit të programit. Në mënyrë që të përputhen me Masat Mbrojtëse dhe Procedurat Gjinore të GIZ-it, këto "projekte politikash" në nivel vendi do t'i nënshtrohen më tej listës së kontrollit S+G përpara zbatimit. Pragu i vlerës së një projekti që do t'i nënshtrohet listës së kontrollit S+G është 1 milion EURO, që do të thotë se vëllimi i përgjithshëm i asistencës teknike të zbatuar nga GIZ-i në një vend përkatës e tejkalon atë shumë.
Në këtë rast, një listë kontrolli S+G do të përdoret për të kontrolluar çdo pasojë të mundshme negative ose të paqëllimshme dhe për të kryer vlerësime të thelluara nëse është e nevojshme.

Tabela më poshtë ilustron hapat që do të ndiqen për projekte që i nënshtrohen kontrollit shtesë të S+G në nivelin e projektit GIZ

Fazat e Ciklit të Projektit	**Veprimet për MRMS**	**Rolet dhe Përgjegjësitë**
Identifikimi	Kontrolli i projektit kundrejt listës së kontrollit S+G të GIZ-it	Zyrtari i politikave brenda ekipit të zbatimit të politikave
	Verifikimi i besueshmërisë së listës së kontrollit S+G	Personeli i S+G në Zyrat Qendrore të GIZ-it
	Nëse është e nevojshme, vlerësim i thelluar për disa masa mbrojtëse	Zyrtari i politikave brenda ekipit të zbatimit të politikave / Konsulent i specializuar
	Verifikimi i besueshmërisë së listës së kontrollit S+G	Personeli i S+G në Zyrat Qendrore të GIZ-it
	Aprovimi i Kategorisë së Riskut	Personeli i S+G në Zyrat Qendrore të GIZ-it
Zbatimi	Vetëm në rast projektesh me risk të lartë	

Meqenëse projektet e zbatuara kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet intelektuale (mbështetja për vendet partnere në zhvillimin e udhërrëfyesit kombëtar për zbatimin e KPK-ve në sektorin e ndërtesave, këshilla për zhvillimin e politikave publike në sektorin e ndërtimit, masat e ngritjes së kapaciteteve), pritet që këto projekte të klasifikohen në kategorisë së riskut C (risk i ulët).

Sidoqoftë, shqyrtimi do të shërbejë për të vlerësuar mungesën e risqeve të konsiderueshme, për të rritur ndërgjegjësimin e kolegëve në lidhje me masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale dhe për të identifikuar mundësitë për të rritur në të vërtetë masat mbrojtëse në fjalë përmes veprimtarive të projektit.

Shtojcat

Shtojca 1 – Lista e Përjashtimit e AFD-së
Shtojca 2 – Model i Planit të Veprimit MS për ndërmjetësit financiarë të financuar nga AFD-ja
Shtojca 3 – Modeli tregues për një Raport Vjetor Monitorimi MS për PNF
Shtojca 4 – Skica treguese e Vlerësimit të Ndikimit MS (VNMS)
Shtojca 5 – Skica treguese e Planit të Menaxhimit MS (PMMS)
Shtojca 6 – Kuadri i Politikave për Zhvendosjen
Shtojca 7 – Kushtet e Referencës së Studimit dhe Kushtet e Referencës për një Plan Veprimi për Zhvendosje (PVZh) ose Plani i Rivendosjes së Mjeteve të Jetesës (PRMJ)
Shtojca 8 – Kuadri i Planifikimit për Popujt Autoktonë (KPPA)
Shtojca 9 – Skica treguese për Planin e Popujve Autoktonë (PPA)
Shtojca 10 – Skica treguese e Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit
Shtojca 11- Modeli i Planit të Zotimit Mjedisor dhe Social
Shtojca 12_ Udhëzime për raportin e monitorimit mjedisor dhe social

Shtojca 1 – Lista e Përjashtimit e AFD-së

1. Prodhimi ose tregtimi i ndonjë produkti ose veprimtarie që konsiderohet i paligjshëm sipas ligjeve ose rregulloreve franceze dhe ato të vendit pritës ose konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Prodhimi ose veprimtaritë që përfshijnë punë të detyruara[20] ose punën e të miturve[21].
3. Tregtia e kafshëve të egra ose produkteve të botës së egër të përcaktuara sipas CITES [22].
4. Peshkimi në rrjetë në mjedis detar duke përdorur rrjeta më të gjata se 2.5 km.
5. Çdo veprimtari që përfshin ose kërkon shkatërrimin [23] e Habitatit Kritik[24] dhe çdo projekt pyjor nën të cilin nuk kryhet plan zhvillimi të qëndrueshëm dhe menaxhimi.
6. Prodhimi, përdorimi ose tregtimi i materialeve të rrezikshme siç janë fijet e azbestit dhe produktet që përmbajnë PCB [25].
7. Prodhimi, përdorimi ose tregtimi i produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve, kimikateve, substancave që shkatërrojnë ozonin [26] dhe substancave të tjera të rrezikshme që i nënshtrohen ndërprerjeve ose ndalimeve ndërkombëtare.

---

[20] *Punë e detyruar nënkupton të gjithë punën ose shërbimin, që nuk kryhet vullnetarisht, që merret nga një individ nën kërcënimin e forcës ose ndëshkimit siç përcaktohet nga konventat e ILO-s*

[21] *Personat mund të punësohen vetëm nëse janë të paktën 14 vjeç, siç përcaktohet në Konventat Themelore të të Drejtave të Njeriut të ILO-s (Konventa e Moshës minimale C138, neni 2), përveç nëse legjislacioni vendor specifikon vijimin e detyrueshëm të shkollës ose moshën minimale për të punuar. Në raste të tilla do të zbatohet mosha më e lartë*

[22] *CITES: Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër. (Uashington, l 993).*

[23] *Shkatërrimi nënkupton (1) eliminimin ose zvogëlimin e rëndë të integritetit të një habitati të shkaktuar nga një ndryshim i madh, afatgjatë në përdorimin e tokës ose ujit; ose (2) modifikimi i një habitati në mënyrë të tillë që aftësia e habitatit për të ruajtur rolin e tij (shih shënimin në fund të faqes) humbet.*

[24] *Habitati kritik është një nëngrup i habitatit natyror dhe atij të modifikuar që meriton vëmendje të veçantë. Habitati kritik përfshin zona me vlerë të lartë të biodiversitetit që përmbushin kriteret e klasifikimit të Unionit Botëror të Ruajtjes (IUCN), përfshirë habitatin e kërkuar për mbijetesën e specieve të rrezikuara ose të rrezikuara siç përcaktohet nga Lista e Kuqe e IUCN e specieve të kërcënuara ose siç përcaktohet në çdo legjislacion vendi; zonat që kanë rëndësi të veçantë për speciet endemike ose me rreze të kufizuar; vendet që janë kritike për mbijetesën e specieve migratore; zonat që mbështesin përqendrime të rëndësishme globale ose një numër individësh të specieve kongregacionale; zona me mbledhje unike të specieve ose që shoqërohen me procese kyçe evolucionare ose ofrojnë shërbime kryesore të ekosistemit; dhe zonat që kanë biodiversitet me rëndësi të konsiderueshme shoqërore, ekonomike ose kulturore për komunitetet vendore. Pyjet primare ose pyjet me vlerë të lartë të ruajtjes do të konsiderohen habitate kritike.*

[25] *PCB: Bifenile poliklorike - një grup kimikatesh tepër toksike. PCB-të ka të ngjarë të gjenden në transformatorët elektrikë të mbushur me vaj, kondensatorët dhe pajisjet e ndërmarrjes që datojnë nga 1950-1985.*

[26] *Substancat Zhdukëse të Ozonit (ODS): Përbërjet kimike të cilat reagojnë me dhe e shterojnë ozonin stratosferik, duke rezultuar në 'vrimat e ozonit' të reklamuara gjerësisht. Protokolli i Montrealit rendit ODS dhe reduktimin e synuar të tyre dhe datat e ndërprerjes.*

8. Tregtia ndërkufitare e mbetjeve dhe produkteve të mbetjeve përveç rasteve kur është në përputhje me Konventën e Bazelit dhe rregulloret themelore.
9. Prodhim ose tregti[27] me:

- Armë dhe/ose municione;
- Tabako;
- Pije alkoolike të forta për përdorim nga njerëzit.

10. Lojërat e fatit, kazinotë dhe çdo ndërmarrje të barasvlershme me to [28].
11. Çdo biznes në lidhje me pornografinë ose prostitucionin.
12. Çdo aktivitet që përfshin ndryshime, dëmtime ose heqje të konsiderueshme të ndonjë Trashëgimie Kulturore Kritike [29].
13. Prodhimi dhe shpërndarja e mesazheve raciste, antidemokratike ose me synimin për të diskriminuar një pjesë të popullatës.
14. Shfrytëzimi i minierave të diamantit dhe komercializimi i diamanteve, kur vendi pritës nuk i është përmbajtur Procesit të Kimberlit.
15. Çdo sektor ose shërbim që i nënshtrohet embargos së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe/ose Franceze pa asnjë prag.

---

[27] *Aktivitetet e përjashtuara kur përfaqësojnë më shumë se 10% të bilancit të gjendjes ose vëllimit të financuar dhe për institucionet financiare më shumë se 10% të vëllimit të financimit të portofolit*

[28] *Çdo financim i drejtpërdrejtë i këtyre projekteve ose aktiviteteve duke përfshirë ato (hotel së bashku me një kazino për shembull). Planet e zhvillimit urban, të cilat më vonë mund të përfshijnë projekte të tilla, nuk kanë lidhje*

[29] *Konsiderohet si «Trashëgimi Kritike Kulturore» çdo pjesë e trashëgimisë kulturore e njohur nga komuniteti ndërkombëtar ose kombëtar për interesin e saj historik, shoqëror ose kulturor.*

Shtojca 2 – Model i Planit të Veprimit MS për ndërmjetësit financiarë të financuar nga AFD-ja

Shënim: Dokumenti aktual është një model ilustrues për t'u përshtatur në përputhje me procedurat, mjetet dhe/ose kapacitetet ekzistuese të EZ-së.

Veprimet	Derivatet	Përgjegjësia	Koha
1. Zbatimi i Sistemit Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS)			
Miratimi me shkrim i Kryetarit / Bordit për hartimin e SMMS	Letra e Kryetarit	Kryetari dhe/ose Bordi	3 muaj mbas firmosjes
Emërimi i një Kontrolluesi MS përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e SMMS siç parashikohet në planin e veprimit	Aprovim nga kryetari/Bordi	Kryetari dhe/ose Bordi	3 muaj mbas firmosjes
Krijimi i një komisioni monitorimi përgjegjës për ngritjen e SMMS	Emri i anëtarëve dhe miratimi nga hierarkia	Kryetari dhe/ose Bordi	3 muaj mbas firmosjes
Rekrutimi i një konsulenti me ekspertizë	Kopje e kontratës dhe CV e Ekspertit	Kontrolluesi MS + Komisioni Mbikëqyrës	Me pagesën e parë
Informim mbi sensibilizimin e veprimit PSK (RSE) / ISR (RSI) për individët e shënjestruar	Certifikatë Trajnimi	Kontrolluesi MS	Maksimumi dy muaj mbas pagesës së parë
2. Zbatimi i politikës MS dhe miratimi i saj			
Zyrtarizimi i politikës MS	Draft i Politikës MS	Kontrolluesi MS + komisioni i monitorimit + konsulent ekspert	2 muaj mbas pagesës së parë
[Zhvillimi/Hartimi] i një liste përjashtimi	Lista e përjashtimit	Kontrolluesi MS + komisioni i monitorimit + konsulent ekspert	5 muaj mbas pagesës së parë
Aprovimi i Politikës MS nga Bordi	Aprovimi i Politikës MS	Pagesë e Kryetarit Bordit	6 muaj mbas pagesës së parë

3. Përkufizimi dhe zbatimi i procedurës dhe mjeteve MS në përputhje me standardet kombëtare			
Hartimi i procedurave dhe mjeteve MS (mjet i klasifikimit të projekteve MS, mjet i vlerësimit të risqeve MS, udhëzues	Sigurimi i mjeteve	Kontrolluesi MS + komisioni i monitorimit + konsulent ekspert	12 muaj mbas pagesës së parë

sektorial MS (nëse është e nevojshme), modele klauzolash MS për t'u përfshirë në marrëveshjet e lehtësimit, …			
Përditësimi i politikave dhe procedurave të huas përfshirë aspektet MS	Përditësimi i procedurave	Kontrolluesi MS + komisioni i monitorimit + konsulent ekspert	15 muaj mbas pagesës së parë
Miratimi i procedurave të MS nga Bordi i bankës	Aprovimi i Procedurave dhe Mjeteve	Kryetari / Bordi	18 muaj mbas pagesës së parë
4. Trajnim i Brendshëm			
Përkufizimi dhe realizimi i një programi trajnimi për MS për punonjësit e përfshirë në hapjen e SMMS	Programi i Trajnimit	Kontrolluesi MS + Ekipet e përshtatshme	15 muaj mbas pagesës së parë
5. Zbatimi i procedurave MS dhe përcaktimi i miratimit të Konsulentit			
Zbatimi i politikave dhe procedurave MS për projektet e financuara.	Kontrolluesi MS + Ekipet e përshtatshme		18 muaj mbas pagesës së parë
Detyra e konsulentit për rishikimin e zbatimit të SMMS	Kontrolluesi MS + komisioni i monitorimit + konsulent ekspert		22 muaj mbas pagesës së parë
Përkufizimi i veprimeve shtesë sipas rastit (modifikimi i mjeteve / procedurave, trajnimi…)	Raporti i caktimit të konsulentit	Kontrolluesi MS + komisioni i monitorimit + konsulent ekspert	22 muaj mbas pagesës së parë
6. Monitorimi			
Dorëzimi tek AFD-ja i një Raporti Vjetor mbi Monitorimin MS	Raporti Vjetor	Kontrolluesi MS	Përvjetori i datës së firmosjes

Shtojca 3 – Modeli tregues për një raport vjetor të monitorimit MS për projektet me ndërmjetësim

Ky model është ilustrues. AFD-ja kërkon që EZ-të me projektet e ndërmjetësuara të paraqesin një Raport Vjetor Monitorimit MS që mbulon të paktën pikat e renditura në paragrafin 3.2.4.

Informacion mbi raportin Raporti për Vitin (muaj/vit – muaj/vit)

Emri i Institucionit :

Raporti i plotësuar nga (emri) :

Numër Telefoni :

E-mail :

Adresa :

Rishikim Portofoli

A ka financuar institucioni juaj projekte në fushat e specifikuara në Listën e Përjashtimit të AFD-së?

☐ Po ☐ Jo

Nëse po, jeni të lutur të përcaktoni fushat: ……..

……..

Jeni të lutur të jepni një përmbledhje të shkurtër të portofolit tuaj

Llojet e Klientëve	**Kredi të prapambetura**	**Numri i kredive**	**Përqindja e vlerës së prapambetur**	**Vlera mesatare e kredisë**	**Jashtë Bilancit**
Individë					
Biznese të vogla dhe të mesme dhe të vetë-punësuarit					
Ndërmarrjet (lutemi jepni detaje mbi llojin e ndërmarrjes)					
Bankat					
Fondet e Investimit					
Autoritetet vendore					
Të tjera (Shteti,….)					
Totali në datën ……					

Menaxhimi Mjedisor dhe Social

Ju lutemi specifikoni emrat dhe pozicionet e individëve zyrtarisht përgjegjës për menaxhimin e çështjeve mjedisore dhe/ose sociale. Individi i emëruar në nivel operacional mund të jetë konsulent i jashtëm.

Emri / Pozicioni	Tel / fax	E-mail
Menaxher i Lartë (anëtar bordi)		
Menaxher Mjedisor		

Menaxher Social		
Të tjerë persona të përfshirë në çështje MS		

A kanë ndjekur këta persona një kurs trajnimi mbi menaxhimin mjedisor dhe social?
☐ Po ☐ Jo ☐ E pasigurt
Nëse po, emri i ofruesit (për shembull IFC, konsulent privat): ……
Data e Trajnimit: ……
A ka ndonjë person tjetër nga organizata juaj që të ketë marrë pjesë në një kurs trajnimi mbi menaxhimin mjedisor dhe social?
☐ Po ☐ Jo ☐ E pasigurt
Nëse po, emri i ofruesit (për shembull IFC, konsulent privat): ……
Data e Trajnimit: ……

Procedurat e vlerësimit dhe mbikëqyrjes së politikës mjedisore dhe sociale
Politika Mjedisore dhe Sociale
A ka institucioni juaj një politikë mjedisore dhe sociale formale?
☐ Po ☐ Jo
Nëse po, ju lutem bashkëngjisni një kopje të kësaj politike.
A ka institucioni juaj procedura formale për:
Vlerësimin Mjedisor dhe Social?
☐ Po ☐ Jo (Nëse po, ju lutem bashkëngjisni një kopje të procedurave të vlerësimit në këtë raport.)
Mbikëqyrja Mjedisore dhe Sociale?
☐ Po ☐ Jo (Nëse po, ju lutem bashkëngjisni një kopje të procedurave të vlerësimit.)
Cilat janë kriteret për Menaxhimin Mjedisor dhe Social?

☐ Politikat dhe udhëzimet e IFC-së dhe Bankës Botërore	☐ ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare të mjedisit, shëndetit, sigurisë dhe punës
☐ Konventat e ILO-s dhe OKB-së	☐ Të tjera: ju lutem specifikojini ……..

A i detyroni klientët tuaj me anë të një kontratë të respektojnë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare të mjedisit, shëndetit, sigurisë dhe punës?
☐ Po ☐ Jo
A i detyroni, me anë të një kontrate, klientët tuaj që kanë projekte të kategorizuara me risk të lartë, t'i përmbahen ligjeve dhe rregullave kombëtare të mjedisit, shëndetit, sigurisë dhe ato të punës së bashku me direktivat e Bankës Botërore/IFC-së?
☐ Po ☐ Jo

Procedurat e vlerësimit mjedisor dhe social
Përdorni tabelën më poshtë për të specifikuar se si vlerësohen çështjet mjedisore dhe sociale.

☐ Dokumentimi i Procedurave Mjedisore e Sociale	☐ Përdorimi i Këshilltarëve/Asistentëve Specialistë
☐ Përdorimi i pyetësorëve dhe listave të kontrollit	☐ Kategorizimi i risqeve të projekteve dhe i procedurave të përshtatshme
☐ Vlerësimi Informal (për shembull marrja në pyetje e klientëve)	☐ Ne nuk i vlerësojmë procedurat mjedisore dhe sociale
☐ Vizita ne terren	☐ Të tjera:

A keni autorizuar – ose i keni kërkuar klientit të autorizojë një:

☐ Raport mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social	☐ Auditime Mjedisore dhe/ose Sociale

Nëse po, ju lutem specifikoni numrin dhe llojin e projektit: …….
A keni negociuar dhe rënë dakord për planet e veprimit mjedisor dhe/ose social me klientët tuaj?
☐ Po ☐ Jo
Nëse po, ju lutem specifikoni numrin dhe llojin e projektit
A keni refuzuar ndonjë investim të mundshëm për arsye mjedisore dhe/ose sociale gjatë periudhës raportuese?
☐ Po ☐ Jo
Nese po, ju lutem specifikoni numrin dhe llojin e projektit

Mbikëqyrja Mjedisore dhe Sociale
Sa shpesh kryeni vizita mbikëqyrjeje te klientët?
Çdo muaj/Çdo dy muaj/Çdo tre muaj/Dy herë në vit/Çdo vit/Tjetër (ju lutem specifikoni)

A diskutoni për çështje mjedisore dhe sociale gjate takimeve mbikëqyrëse?
☐ Gjithmonë ☐ Ndonjëherë ☐ Asnjëherë
Nëse një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS) është rënë dakord me klientin, a përfshin procesi i mbikëqyrjes një vlerësim të progresit gjatë planit?
☐ Po ☐ Jo ☐ E pasigurt
A raportojnë klientët tuaj rregullisht mbi performancën e tyre mjedisore dhe sociale?
☐ Po ☐ Jo ☐ E pasigurt
Nëse po, ju lutem specifikoni numrin dhe llojin e projektit, mënyrën e raportimit
A është lidhur ndonjë projekt me çështjet vijuese?

☐ Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare të mjedisit, shëndetit dhe sigurisë ose të punës	☐ Fatkeqësi ose dëmtime serioze
☐ Mosrespektimi i politikave dhe udhëzimeve të Bankës Botërore/IFC-së (projekte me risqe të larta)	☐ Greva (me ose pa dhunë) ose mosmarrëveshje të tjera të punës
☐ Mosrespektimi i marrëveshjeve të tjera ligjore	☐ Veprime Juridike

☐ Mosrespektimi i një plani të veprimit të rëna dakord mjedisor dhe/ose social	☐ Gjobat, penalitetet ose tarifat e rritura të lejes
☐ Ankesat nga agjencitë rregullatore, grupet e interesit ose komunitetet lokale	☐ Vëmendje negative nga ana e mediave ose organizatave joqeveritare
☐ Zbatimet e teknologjive, proceseve ose procedurave të reja, nga klientët, të cilat kanë përmirësuar performancën e lidhur me mjedisin, shëndetin, sigurinë ose punën (për shembull ulja e emetimeve, politikat sociale)	☐ Raporte pozitive nga media ose organizata joqeveritare në lidhje me projektet e klientëve

Nëse i jeni përgjigjur po pyetjeve të mësipërme, ju lutemi specifikoni numrin dhe llojin e projekteve: ……

Vlerësimi MS i projekteve të financuara

Përshkrimi i shkurtër i investimit (natyra e projektit, kostoja e nën-projektit, madhësia fizike [zona e vendit, prodhimi në vit, etj], ekzistenca e ndonjë transferimi të pronës, ose operacionet në vazhdim, planet për zgjerimin e operacioneve ose ndërtimet e reja, ndikimi i vlerësuar në prodhim).

Informacioni paraprak mjedisor dhe social (lista e dokumenteve mjedisore dhe sociale të disponueshme në kohën e shqyrtimit).

- Çështjet kryesore mjedisore dhe sociale të Projektit:

- Kategoria e riskut mjedisor dhe social:

- Ekstrakt i seksionit përkatës të miratimit të administratës për Projektin:

- Nëse është e nevojshme, përfundimi kryesor i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe masat e propozuara të zbutjes (tregoni masat që duhen marrë për të adresuar çështjet mjedisore të ngritura nga Përfituesi/investimi i Klientit, se si ato mund të përfshihen në modelin e Investimit dhe çdo kontratë të mundshme):

- Rezultatet e pjesëmarrjes së komunitetit

- Opinioni i Bankës për Projektin: rezultati i vlerësimit mjedisor dhe social të Bankës, kërkesat mjedisore dhe sociale, klauzolat mjedisore dhe sociale …

- Hapat e tjerë (Studime të tjera ….): ……

Shtojca 4 – Skica treguese e Vlerësimit të Ndikimit MS (VNMS)

1. Përmbledhja Ekzekutive

- Në mënyrë të përmbledhur diskuton gjetjet domethënëse dhe veprimet e rekomanduara.

2. Kuadri ligjor dhe institucional

- Analizon kornizën ligjore dhe institucionale për projektin, brenda të cilit bëhet vlerësimi mjedisor dhe social, sipas Standardit të Performancës 1 të IFC-së.
- Krahason kornizën ekzistuese mjedisore dhe sociale të Huamarrësit dhe SP dhe identifikon boshllëqet midis tyre.
- Identifikon dhe vlerëson kërkesat mjedisore dhe sociale të çdo bashkëfinancuesi.

3. Përshkrimi i Projektit

- Përshkruan në mënyrë të përmbledhur projektin e propozuar dhe kontekstin e tij gjeografik, mjedisor, shoqëror dhe kohor, përfshirë çdo investim jashtë vendit që mund të kërkohet (p.sh. tubacione të dedikuara, rrugë hyrëse, furnizim me energji elektrike, furnizim me ujë, banesa dhe materiale të para dhe ambiente për ruajtjen e produkteve), si dhe furnizuesit kryesorë të projektit.
- Përmes shqyrtimit të detajeve të projektit, tregon nevojën për ndonjë plan për të përmbushur kërkesat e Standardeve të Performancës nga 1 deri në 8.
- Përfshin një hartë me hollësi të mjaftueshme, që tregon vendin e projektit dhe zonat që mund të preken nga ndikimet e drejtpërdrejta, jo të drejtpërdrejta dhe të mbledhura/kumulative të projektit.

4. Të dhënat fillestare

- Vendos në detaje të dhënat bazë që janë të rëndësishme për vendimet në lidhje me vendndodhjen e projektit, modelin, funksionimin ose masat zbutëse. Duhet të përfshijë diskutim të saktësisë, besueshmërisë dhe burimeve të të dhënave, si edhe informacionin në lidhje me datat që lidhen me identifikimin, planifikimin dhe zbatimin e projektit.
- Identifikon dhe vlerëson shkallën dhe cilësinë e të dhënave të disponueshme, boshllëqet kryesore të të dhënave dhe pasiguritë që lidhen me parashikimet;
- Bazuar në informacionin aktual, vlerëson fushën që do të studiohet dhe përshkruan kushtet përkatëse fizike, biologjike dhe socio-ekonomike, përfshirë çdo ndryshim të parashikuar para fillimit të projektit.
- Merr parasysh veprimtaritë e zhvillimit aktuale dhe të propozuara brenda zonës së projektit, por jo të lidhura drejtpërdrejt me projektin.

5. Risqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale

- Merr parasysh të gjitha risqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të shkaktuara nga projekti.

6. Masat zbutëse

- Identifikon masat zbutëse dhe ndikimet e konsiderueshme negative që nuk mund të zbuten dhe, për aq sa është e mundur, vlerëson pranueshmërinë e këtyre ndikimeve negative që shkaktohen.
- Identifikon masat e diferencuara në mënyrë që ndikimet e papëlqyeshme të mos bien në mënyrë disproporcionale mbi personat në nevojë ose të prekshëm.

- Vlerëson realizueshmërinë e zbutjes së ndikimeve mjedisore dhe sociale; kapitali dhe kostot e përsëritura të masave të propozuara zbutëse, dhe përshtatshmërinë e tyre në kushte vendore; kërkesat institucionale, trajnuese dhe monitoruese për masat e propozuara të zbutjes.
- Specifikon çështje që nuk kërkojnë vëmendje të mëtejshme, duke siguruar bazën për këtë përcaktim.

7. Analiza e Zgjidhjeve Alternative

- Krahason në mënyrë sistematike alternativat e mundshme për vendin e propozuar të projektit, teknologjinë, dizajnin dhe funksionimin - duke përfshirë situatën "pa projekt" - në lidhje me ndikimet e tyre të mundshme mjedisore dhe sociale;
- Vlerëson realizueshmërinë e alternativave për zbutjen e ndikimeve mjedisore dhe sociale; kapitali dhe kostot e përsëritura të masave alternative të zbutjes, dhe përshtatshmëria e tyre në kushtet lokale; kërkesat institucionale, trajnuese dhe monitoruese për masat alternative të zbutjes.
- Për secilën prej alternativave, përcakton ndikimet mjedisore dhe sociale dhe jep vlerat ekonomike atje ku është e mundur.

8. Masat e Projektimit

- Përcakton bazën për zgjedhjen e formatit të veçantë të projektit të propozuar dhe specifikon MShSMM-të e zbatueshme ose nëse ESHG-të përcaktohen si jo të zbatueshme, justifikon nivelet e rekomanduara të emetimit dhe qasjet për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes që janë në përputhje me GIIP.

9. Masat dhe veprimet kryesore për Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS)

- Përmbledh masat dhe veprimet kryesore dhe kornizën kohore të nevojshme për projektin për të përmbushur kërkesat e SP. Kjo do të përdoret për hartimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS).

10. Shtojcat

(i) Lista e individëve ose organizatave që përgatitën ose kontribuuan në vlerësimin mjedisor dhe shoqëror.
(ii) Referencat - përcaktimi i materialeve të shkruara, të botuara dhe të pabotuara, që janë përdorur.
(iii) Regjistrimi i takimeve, konsultimeve dhe sondazheve me palët e interesit, përfshirë ato me persona të prekur dhe palë të tjera të interesuara. Regjistrimi specifikon mjetet e angazhimit të palëve të interesit që u përdorur për të mbledhur pikëpamjet e njerëzve të prekur dhe palëve të tjera të interesuara.
(iv) Tabelat që paraqesin të dhënat përkatëse referuar ose përmbledhur në tekstin kryesor.
(v) Lista e raporteve ose planeve shoqëruese.

Shtojca 5 – Skica treguese e Planit të Menaxhimit MS (PMMS)

1. Përshkrimi i masave zbutëse

PMMS-ja:

a) Përshkruan ndikimet negative të projektit siç përshkruhet në vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social (VNMS), si për fazën e punimeve ashtu edhe për fazën e funksionimit dhe tregon (i) objektivin e prekur nga ndikimi, (ii) rëndësinë relative të ndikimit, (iii) probabilitetin e ndodhjes dhe (iv) kohëzgjatjen e tij (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë).

b) Përshkruan, me të gjitha detajet e nevojshme teknike, çdo masë lehtësuese, duke treguar llojin e ndikimit ose ndotjen që korrigjon, periudhën në fjalë, organizmin ose njerëzit përgjegjës për zbatimin e tij dhe kushtet për të cilat është e nevojshme (përgjithmonë ose në raste të papritura për shembull), me, nëse është e nevojshme, informacione teknike të hollësishme (planet, përshkrimi i materialit, regjistrimi i popullsisë), dhe normat e mundshme për t'u vëzhguar.

c) Vlerëson fushën dhe kostot e masave, si dhe nevojat institucionale dhe të trajnimit për zbatimin e këtyre masave. Nëse është e nevojshme, identifikon mekanizmat e kompensimit për njerëzit e prekur nga efektet të cilat nuk mund të zbuten.

2. Zbatimi i monitorimit mjedisor dhe social

Objektivi i monitorimit mjedisor dhe social është (i) të verifikojë se angazhimet mjedisore dhe sociale të ndërmarra nga zotëruesi i projektit janë përmbushur, (ii) të japë informacion mbi çështjet kryesore mjedisore dhe sociale të projektit, mbi të gjitha mbi ndikimet dhe (iii) të analizojë efektshmërinë e masave zbutëse të zbatuara.

Ky informacion bën të mundur vlerësimin e suksesit të masave zbutëse brenda mbikëqyrjes së projektit dhe marrjen, nëse është e nevojshme, e masave korrigjuese.

PMMS-ja përcakton objektivat e monitorimit dhe metodat e sakta të monitorimit, në lidhje me efektet e vlerësuara në raportin e VNMS-së dhe masat zbutëse të përshkruara në PMMS.

Kjo pjesë përfshin:

a) një përshkrim të saktë, me detaje teknike, të llojeve të vijueshmërisë, treguesve, masave mbikëqyrëse,

përfshirë, aty ku është e zbatueshme, parametrat për të matur, metodat që duhen, vendet për të marrë mostra, shpeshtësinë e masave, kohëzgjatjen, kufirin e zbulimit (kur është e zbatueshme), dhe përcaktimin e pragjeve që tregojnë nevojën e masave korrigjuese,

b) një përshkrim i metodave për të zbatuar monitorimin: procedurat e mbikëqyrjes, hartimi i raporteve të monitorimit (monitorimi i rregullt, format e aksidenteve), organizimi i kërkuar.

Objektivi është (i) të zbulojë shpejt kushtet që kërkojnë masa specifike zbutëse dhe (ii) të japë informacion mbi progresin e bërë dhe rezultatet brenda kuadrit të këtyre masave.

3. Mbyllja e punës në terren / ndalimi i projektit

Kur një projekt ka jetë të kufizuar ose kur puna në terren mbyllet, PMMS-ja parashikon masat e kërkuara për mbylljen e terrenit, në fund të jetës së projektit.

Ajo përshkruan:

- kushtet teknike dhe operacionale të këtij ndalimi / mbylljeje,
- kushtet e mundshme të rehabilitimit të vendit (guroret, minierat për shembull), pastrimin e ndotjes, çmontimit e pajisjeve, ndërtesat….
- Kushtet e kërkuara për ri-integrimin profesional të punonjësve.

4. Procedura organizative

PMMS-ja jep një përshkrim të hollësishëm të dispozitave institucionale të cilat janë të nevojshme për zbatimin e masave zbutëse dhe monitoruese, gjatë punimeve ose pas përfundimit të projektit. Ai jep informacion të saktë se kush (organizmat ose njerëzit) do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtyre masave në lidhje me, për shembull, funksionimin, mbikëqyrjen, kontrollimin e vënies në zbatim, vijimin e zbatimit, masat korrigjuese, financimin, hartimin e raporteve dhe trajnimin e stafit.

Kur është e zbatueshme, PMMS-ja mbulon temat e mëposhtme: a) asistencë teknike: b) prokurim dhe c) metoda organizative të zbatuara nga klienti.

Propozimet për forcimin e organizatës dhe kapaciteteve mund të bëhen në PMMS. Mund të nxitet zbatimi i një ekspertize të jashtme për të garantuar kontroll të përshtatshëm të zbatimit të PMMS-së.

5. Kalendari për performancën dhe vlerësimin e kostos

Për secilën nga tri temat (zvogëlimi i ndotjes, monitorimi i mjedisit dhe procedurat organizative), PMMS-ja siguron:

a) kalendar për performancën e masave zbutëse, duke treguar caktimin e tyre dhe koordinimin e tyre me planet e ekzekutimit të projektit;

b) vlerësim të investimeve dhe kostove të funksionimit,

c) origjinën e fondeve të nevojshme për zbatimin e PMMS-së.

Shtojca 6 – Kuadri i Politikës së Zhvendosjes

1. Hyrje

Ky Kuadër i Politikës së Zhvendosjes (KPZh) jep udhëzime për kontrollin e zhvendosjes, vlerësimin, rregullimet institucionale dhe proceset në lidhje me blerjen e tokës dhe zhvendosjen e pavullnetshme që duhet të përmbushet nga EZ-të, subjektet partnere të EZ-ve dhe zhvilluesit dhe përfituesit e nënprojekteve, përfshirë konsulentët, stafin e projektit dhe nënprojektit si dhe palët e lidhura. FKGj-ja dhe AFD-ja, si ent i akredituar, pranojnë që blerja e tokës dhe kufizimet e përdorimit të tokës për shkak të projekteve dhe nënprojekteve mund të kenë ndikime të papëlqyeshme tek përdoruesit e tokës dhe komunitetet.

Masat mbrojtëse të përkohshme të FKGj-së, veçanërisht Standardi i Performancës 5 i IFC-së përcakton standardet për adresimin dhe zbutjen e risqeve që vijnë nga zhvendosja e pavullnetshme, përfshirë çdo rast të marrjen e pavullnetshme të tokës. "Zhvendosja e pavullnetshme" siç përdoret në këtë dokument do të nënkuptojë zhvendosjen fizike (zhvendosja ose humbja e strehës) dhe zhvendosjen ekonomike, përfshirë humbjen e pasurive ose kufizimin e sigurimit të pasurive që çojnë në humbje të të ardhurave, kur ndikohen drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga veprimtaritë e projektit. Zhvendosja e pavullnetshme bëhet kur personat ose komunitetet nuk kanë të drejtë të refuzojnë ose të kundërshtojnë blerjen e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës që rezultojnë në zhvendosje fizike ose ekonomike. Kjo ndodh në rastet e (i) shpronësimit të ligjshëm, ose kufizimeve të përkohshme ose të përhershme të përdorimit të tokës, dhe (ii) marrëveshjeve të negociuara në të cilat blerësi mund të përdorë shpronësimin ose të vendosë kufizime ligjore mbi përdorimin e tokës nëse kanë dështuar negociatat me shitësin.

Meqenëse shumica e përfituesve dhe EZ-ve janë organizata të sektorit privat, kërkesat për tokë pritet të merren përmes një transaksioni në treg nën një proces të vullnetshëm mes blerësit dhe shitësit. Një blerje e tillë kërkon një nivel të duhur të procesit të vlerësimit me kujdes nga AFD-ja dhe EZ-ja për të siguruar proces të vullnetshëm si nga shitësi edhe nga blerësi.

Blerja e pavullnetshme e tokës mund të jetë e mundshme pasi nënprojektet mund të kërkojnë blerjen e tokës përfshirë tokën nën pronën publike ose tokën e përdorur nga komunitetet përmes rregullimeve të të drejtave të përdoruesit. Ndërsa Programi do të përpiqet të shmangë zhvendosjen e pavullnetshme, mund të ketë raste, kur kërkohet tokë e përcaktuar. Nëse do të identifikohet që një tokë e përcaktuar është e nevojshme për nënprojektet ose variantet për tokën janë të kufizuara për shkak të kufizimeve dhe një zgjidhje me negocim nuk është e suksesshme, do të zbatohen kërkesat e blerjes së pavullnetshme të tokës sipas kësaj Kornize të Politikës së Zhvendosjes (KPZh). Zhvendosja e pavullnetshme gjithashtu do të shmanget si përparësi, por mund të ketë raste, të tilla si në zonat e mbrojtura dhe pyjet, ku qasja e njerëzve është e kufizuar ose jetesa e tyre preket. Në këto raste, kërkesat e KPZh do të zbatohen gjithashtu. KPZh-ja specifikon përgatitjen e Planit të Veprimit për Zhvendosje (PVZh) për blerjen e tokës ose zhvendosjen e pavullnetshme. Zhvendosja e pavullnetshme përfshin blerjen e tokës të zbatuar nën parimin e shpronësimit për interesa publike që mund të përfshijë zhvendosjen fizike dhe ekonomike. Në të gjitha rastet e tjera të ndonjë ndikimi të papëlqyeshëm ekonomik, social ose mjedisor nga veprimtaritë e projektit përveç marrjes së tokës, ndikime të tilla do të shmangen, minimizohen, zbuten ose kompensohen përmes procesit të vlerësimit social si pjesë e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social. Zhvilluesit e nënprojekteve dhe EZ-të do t'i referohen parimeve dhe kërkesave të këtij kuadri si dhe atyre të standardit mbrojtës të AFD-së dhe FKGj-së për blerjen e tokës dhe zhvendosjen e pavullnetshme.

Qasja me shitës dhe blerës të vullnetshëm ose marrëveshja e përbashkët mund të zbatohen për tokën në pronësi private sipas sistemit të vendit. Mbi atë prag dhe / ose kur statusi i tokës nuk është

në pronësi private, blerja e tokës zbatohet sipas parimit të shpronësimit për interesa publike. Kjo qasje mund të përfshijë zhvendosjen fizike dhe ekonomike. Të njëjtat procedura standarde siç diskutohen në KPZh do të integrohen në TR, udhëzimet dhe rezultatet e tjera të GREM pas fazës së eksplorimit, për t'u zbatuar në çdo fazë pas-projektit. Objektivat e përgjithshme të masave mbrojtëse për zhvendosjen e pavullnetshme janë si më poshtë:

(a) zhvendosja e pavullnetshme duhet të shmanget kur është e mundur, ose të minimizohet, duke eksploruar të gjitha planet alternative të zbatueshme të projekteve;

(b) aty ku nuk është e mundur të shmanget zhvendosja, veprimtaritë e zhvendosjes duhet të hartohen dhe ekzekutohen si pjesë e një programi të zhvillimit të qëndrueshëm, p.sh. duke siguruar burime të mjaftueshme për të mundësuar personat e zhvendosur nga projekti të përfitojnë prejt tij. Personat e zhvendosur nga projekti duhet të konsultohen në mënyrë domethënëse dhe t'u jepet mundësia të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e programeve të zhvendosjes; dhe

(c) personat e zhvendosur duhet të marrin ndihmë në përpjekjet e tyre për të përmirësuar jetesën dhe standardet e tyre të jetesës, ose të paktën për t'i rikthyer ato, në terma realë, në nivelet e para-zhvendosjes, ose në nivelet mbizotëruese para fillimit të projektit, cilido nivel që është më i lartë.

Para zbatimit të blerjes së tokës dhe veprimtarive të zhvendosjes, EZ-të, partnerët ndërmjetës dhe zhvilluesit e nënprojekteve do të sigurojnë qasjet dhe metodologjinë e mëposhtme të vlerësimit social:

(a) Shmangin zhvendosjen e pavullnetshme dhe, nëse është e pashmangshme, minimizojnë ndikimet e mundshme;

(b) Vlerësojnë ndikimet e mundshme sociale dhe ekonomike të marrjes së tokës në mënyrë të pavullnetshme dhe zhvendosjes së PPP dhe jetesën e tyre;

(c) Identifikojnë personat e prekur dhe të drejtat përkatëse të tyre;

(d) Përcaktojnë procesin e qartë të konsultimit me Personat e Prekur nga Projekti dhe pjesëmarrjen e tyre në përgatitjen dhe planifikimin e marrjes së tokës në mënyrë të pavullnetshme dhe zhvendosje, nëse ndodh, si dhe shpërndarjen e informacionit te Njerëzit e Prekur nga Projekti;

(e) Kompensojnë për pasuritë e humbura me koston e plotë të zëvendësimit;

(f) Kompensojnë përdoruesit informalë/të paligjshëm të tokës për pasuritë e humbura dhe të sigurojnë ndihmë për zhvendosjen, nëse është e nevojshme;

(g) Kompensojnë dhe sigurojnë përdorim ligjor për tokën e shpronësuar para fillimit të ndërtimit;

(h) Ofrojnë informacion dhe përgatitin programe të posaçme asistence për grupet në nevojë, përfshirë personat pa ndonjë pronë të paluajtshme; dhe

(i) Ofrojnë dhe përgatitin plane për zgjidhjen e ankesave dhe monitorimin në përputhje me KPZh.

2. Ligjet dhe politikat e vendit në lidhje me blerjen e tokës

AFD-ja dhe EZ-të do të vlerësojnë ligjet dhe politikat e vendit në lidhje me blerjen e tokës. Një krahasim dhe vlerësim i boshllëqeve midis ligjeve dhe politikave të vendit dhe standardeve të mbrojtjes së FKGj-së dhe AFD-së në lidhje me blerjen e tokës dhe zhvendosjen e pavullnetshme do të identifikojë çdo boshllëk në politika dhe kërkesa, si edhe masat e plotësimit të boshllëqeve që do të zbatohen në nënprojekte. Krahasimi gjithashtu identifikon masat dhe qasjet më të rrepta që mund të miratohen nga nën-projektet.

Krahasimi midis ligjeve dhe politikave të vendit dhe standardeve të masave mbrojtëse në lidhje me blerjen e tokës do të marrë në konsideratë ndër të tjera kërkesat që duhet të përmbushen në blerjen dhe zhvendosjen, të drejtën për kompensim, vlerësimin, trajtimin e njerëzve të zhvendosur pa zotërim zyrtar të tokës ose pronave, kërkesat për konsultimin e palëve të interesit dhe zgjidhjen e ankesave.

Meqenëse EZ-të potenciale dhe zhvilluesit e projekteve janë kryesisht sektori privat, procesi i blerjes së tokës do të jetë në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare si edhe parimet dhe kërkesat e standardeve të përkohshme MMMS(ESS) të FKGj-së (Standardi i Performancës 5 i IFC-së), siç përshkruhet në këtë KPZh, për të zbutur ndikimet e papëlqyeshme sociale dhe ekonomike për shkak të blerjes së tokës dhe transaksioni duhet të zhvillojë me mirëbesim negociatat nëse procesi i blerjes së tokës ose qiradhënies bëhet përmes blerjes vullnetare.

3. Informacioni i kërkuar për blerjen e pavullnetshme

Si pjesë e zhvillimit të nënprojekteve, zhvilluesit e nënprojekteve dhe EZ-të do të ofrojnë informacion mbi kërkesat e tokës, përfshirë pronësinë ekzistuese të tokës dhe përdorimin e tokës. AFD-ja dhe EZ-ja do të rishikojnë informacionin dhe do të përcaktojnë variantet dhe mjetet korrigjuese nëse ka ndonjë rrethanë që mund të pengojë përputhjen me standardet MMMS. Vlerësimi ose kujdesi i duhur nga AFD-ja dhe EZ-të do të përfshijë informacionin dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

(a) vlerësimi i ndikimeve të përkohshme dhe të përhershme të blerjes së tokës ose shpronësimit, dhe kategoritë e personave/familjeve të prekura, numri i tokave/parcelave të prekura, përqindja e tokës/parcelave të prekura në çdo pronësi toke, përdorimi i tokës para dhe pas blerjes, përdorimi paraprak i tokës dhe numri i pronarëve;

(b) dokumentimi i situatave socio-ekonomike të familjeve të prekura për të kuptuar ndikimet e papëlqyeshme në jetesën e personave të zhvendosur dhe për të siguruar masa rikthimi për të kompensuar humbjet e të ardhurave;

(c) standardet e vlerësimit dhe kompensimit të zbatuara për humbjen e përkohshme dhe të përhershme të tokës, humbjen e të korrave, humbjen e pemëve prodhuese, humbjen e vendbanimit dhe bizneseve pas kërkesës për koston e plotë të zëvendësimit;

(d) parashikimi për tokën zëvendësuese dhe përshkrimi i zonave të zhvendosjes, nëse është e vlefshme, dhe

(e) sigurimi i angazhimit të palëve të interesit, zgjidhja e ankesave dhe monitorimi.

Matrica për identifikimin e instrumentit të zbatueshëm për blerjen e tokës dhe zhvendosjen është si vijon:	Instrumenti
Blerja e vullnetshme e tokës përmes procesit me shitës blerës të vullnetshëm, ose marrëveshje e transaksioneve në treg.	Nuk kërkohet asnjë instrument Dokumentohen lista e pronarëve të tokave, madhësia e tokës, procesverbalet e konsultimeve, marrëveshjet e shitjeve dhe faturat.
Asetet preken nga një nënprojekt, por nuk kanë të bëjnë me blerjen e tokës ose zhvendosjen.	Përcaktuar në vlerësimet mjedisore dhe sociale dhe i përfshirë në PMMS-në e nënprojektit
Kur blerja e pavullnetshme e tokës për një nënprojekt prek më pak se 200 njerëz, më pak se 10% e aseteve prodhuese të familjeve preken dhe/ose nuk përfshin zhvendosje fizike.	Një Plan i Shkurtuar i Veprimit për Zhvendosjen (PVZh) dhe/ose Plani i Rivendosjes së Mjeteve të Jetesës (PRMJ)
Kur blerja e pavullnetshme e tokës për një nënprojekt prek më shumë se 200 njerëz, prek më shumë se 10% të veprimtarive prodhuese të familjeve dhe/ose përfshin zhvendosje fizike.	Një Plan gjithëpërfshirës PVZh dhe/ose PRMJ

Për nënprojektet që kërkojnë zhvendosje të pavullnetshme të palëve të treta nga toka publike, zhvilluesit e nënprojekteve hartojnë PVZh dhe/ose PRMJ, dhe ua paraqesin EZ-së dhe AFD-së për aprovim para zbatimit të blerjes së tokës dhe zhvendosjes. PVZh-ja do të përfshijë përshkrim të

hollësishëm të planifikimit dhe zbatimit të zhvendosjes. Shtrirja dhe niveli i detajeve të PVZh-së do të ndryshojnë nga madhësia dhe ndërlikimet e çështjeve të blerjes së tokës dhe kompensimit. Shtojca 6 e këtij dokumenti paraqet një skicë treguese të PVZh-së ose PRMJ. PVZh-të do të ndahen dhe zbatohen nga zhvilluesit e nënprojekteve.

4. Zgjidhja e Tokës me Negocim / Transaksioni i Vullnetshëm

Blerja e tokës me negocim, ose transaksioni i vullnetshëm, do të jetë metoda e preferuar për blerjen e tokës. Vendndodhjet e nënprojekteve dhe infrastruktura mbështetëse do të bazohen në disa negociata në lidhje me cilën vendndodhje zgjidhet bazuar në vullnetin e pronarëve të tokave për të shitur ose dhënë me qira tokë. EZ-të dhe institucionet partnere do të zbatojnë parimet për blerjen e tokës me negocim / transaksionin të vullnetshëm që përfshin:

(a) Konsultime domethënëse me njerëzit e prekur nga projekti, përfshirë ata pa të drejtë ligjore për tokë dhe asete;

(b) Ofertë me çmim të drejtë për tokën dhe pasuritë e tjera me koston e zëvendësimit. Zbritja e tatimit mbi të ardhurat për transaksionin e tokës do të komunikohet hapur te njerëzit e prekur nga projekti dhe do të bihet dakord me ta;

(c) Transparenca në negociata pa presion dhe detyrim me njerëzit e prekur nga projekti për të zvogëluar rreziqet e mosbalancës së informacionit dhe fuqisë negociuese të palëve. Një palë e jashtme e pavarur do të angazhohet për të dokumentuar dhe vërtetuar procesin e negociatave dhe zgjidhjeve. Verifikimi (për shembull, deklaratat e noterizuara ose dëshmitarët) e natyrës së vullnetshme të dhurimeve të tokës duhet të merret nga secili person që shet tokë ose e jep me qira atë.

Për blerjen e tokës duke përdorur qasjen e shitësit të vullnetshëm dhe të blerësit të vullnetshëm, zhvilluesit e nënprojekteve do të dokumentojnë përgatitjen dhe zbatimin e blerjes së tokës që do të përfshijë së paku: listën e pronarëve të tokave të prekura dhe madhësinë e tokës së përfituar, procedurën për përcaktimin e vlerës së pasurisë, procesverbalet e konsultimit dhe negociimit dhe shumën/nivelin e kompensimit të ofruar pronarëve të tokave të prekur.

5. Kriteret e pranimit për personat e prekur dhe afatet e fundit

Për qëllim të këtij kuadri, kualifikimi për një person të prekur nga projekti përshkruhet më poshtë.

(a) çdo person ose familje e prekur negativisht nga blerja e aseteve ose ndryshimi i përdorimit të tokës për shkak të veprimtarive të kërkimit;

(b) çdo person i prekshëm dhe i prekur përfshirë gratë, të varfrit, artizanët, komunitetet fisnore, personat që kanë zënë tokën,

(c) personat me të drejta *uzufrukti* (përdorim dhe shfrytëzim pa të drejta pronësie), grupe në varfëri të cilët jetojnë falë tokës që do të merret nga projekti; dhe

(d) çdo person tjetër që mund të provojë dhe vërtetojë të drejtën e tij/saj si person i prekur nga zhvillimi i nënprojektit nga EZ-ja dhe AFD-ja.

Afati i fundit për pranueshmëri për kompensim dhe/ose ndihmë për zhvendosje është dita e fundit e regjistrimit/inventarit të pasurive. Njerëzit / komunitetet e prekura do të informohen për afatet e fundit përmes agjencive përgjegjëse, kryeplakut dhe drejtuesve të komunitetit.

6. E drejta

Masat mbrojtëse MS të FKGj-së kërkojnë që kompensimi të paguhet me vlerën e zëvendësimit shtuar ndihmës kalimtare. Toka zëvendësohet me tokë me vlerë dhe komoditete të barabarta. Asetet e jetesës zëvendësohen me asete me vlerë të barabartë. Ndarja e përfitimeve sigurohet përmes mekanizmave shtesë të mbështetjes kur është e mundur. Njerëzit e prekur nga projekti do të kenë të drejtë të vlerësojnë kompensimin, rehabilitimin dhe mbështetjen e zhvendosjes siç përshkruhet në matricën e të drejtës si më poshtë:

Lloji i humbjes	**Kategoria e personit të prekur nga projekti**	**Të drejtat e kompensimit**
Humbja e përhershme e tokës bujqësore	Pronar: Personi / grupi me titull ligjor / regjistrim të pronësisë së tokës (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale sipas ligjeve dhe politikave të vendit)	Kostoja e plotë e zëvendësimit dhe shpenzimet e zhvendosjes.
	Qiraxhi	Kompensimi në të holla mbi asetet e tokës dhe shpenzimet zhvendosjes. Zbatohen marrëveshjet e pronarit/qiramarrësit
	Zaptues/përdorues informalë ose jozyrtarë të tokës	Kompensim në të holla mbi asetet e tokës dhe shpenzimet e zhvendosjes
Humbja e përhershme e tokës së banimit	Pronar: Personi / grupi me titull ligjor/regjistrim të pronësisë së tokës (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale sipas ligjeve dhe politikave të vendit)	Kostoja e plotë e zëvendësimit dhe shpenzimet e zhvendosjes
	Qiraxhi	Shpenzimet e zhvendosjes
	Zaptues/përdorues informalë ose jozyrtarë të tokës	Shpenzimet e zhvendosjes
Humbja e përhershme komerciale e tokës	Pronar: Personi / grupi me titull ligjor / regjistrim të pronësisë së tokës (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale sipas ligjeve dhe politikave të vendit)	Kostoja e plotë e zëvendësimit dhe shpenzimet e zhvendosjes dhe kompensimi për humbjen e përkohshme të të ardhurave
	Qiraxhi Zaptues/përdorues informalë ose jozyrtarë të tokës	Shpenzimet për zhvendosje, kompensimi për humbjen e përkohshme të të ardhurave
Humbja e përkohshme e tokës	Pronar: Personi / grupi me titull ligjor / regjistrim të pronësisë së tokës (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale sipas ligjeve dhe politikave të vendit)	Kompensimi në të holla për qira, ose rehabilitimi i parcelës të barasvlershme me 1/10 e vlerës së tokës në treg.
	Qiraxhi Zaptues/përdorues informalë ose jozyrtarë të tokës	Kompensim në të holla paguar njëherësh të barasvlershme me 1/10 e vlerës së tokës në treg të ndarë ndërmjet përdoruesve të tokës sipas proporcioneve.

Humbja e ndërtesave të banimit	Pronar: Personi / grupi me titull ligjor / regjistrim të pronësisë së tokës (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale sipas ligjeve dhe politikave të vendit)	Kompensim parash për një ndërtesë banimi me vlerë zëvendësimi bazuar në çmimin e tregut, pa kostot e amortizimit/transaksionit dhe materialet e shpëtuara plus shpenzimet e zhvendosjes. Ndikimet e pjesshme do të sjellin kompensimin e pjesës së prekur të ndërtesës plus riparime për t'u kthyer në të paktën standardin e para-projektit.
	Qiramarrësit/përdoruesit në ndërtesat e banimit të cilët identifikohen gjatë regjistrimit.	Shpenzimet e zhvendosjes dhe ndikimit të rëndë si më poshtë.
Humbje ndërtesash/pasurish tregtare dhe jo-rezidenciale	Pronar i ndërtesave / pasurive tregtare ose jo-rezidenciale të regjistruar ose i cili është identifikuar në regjistrim	Kompensimi i parave për ndërtesat jo-rezidenciale dhe pasuritë e tjera fikse në vlerën e zëvendësimit bazuar në çmimin e tregut pa kostot e amortizimit/transaksionit dhe materialet e shpëtuara plus shpenzimet e zhvendosjes Ndikimet e pjesshme do të sjellin kompensimin e pjesës së prekur të ndërtesës plus riparimet.

	Qiramarrësit/përdoruesit në ndërtesa/pasurit tregtare ose jo-rezidenciale të cilët identifikohen në regjistrim	Shpenzimet e zhvendosjes dhe ndikimit të rëndë si më poshtë.
Humbje e të korrave	Pronar i të korrave	Njoftim paraprak për të korrik produktin e fundit. Kompensim në të holla në sasinë e barasvlershme me vlerën e tregut për të korrat e humbura plus koston e zëvendësimit të farës bazuar në vlerësimin e Departamentit të Bujqësisë.
Humbje e pemëve	Pronar i pemëve	Njoftim paraprak për të korrur produktet e pemëve. Rikuperim materiali pa kosto. Kompensimi i parave në vlerë të barasvlershme me vlerën e tregut për pemën e humbur

		plus koston e zëvendësimit të farës bazuar në vlerësimin e Departamentit të Bujqësisë duke marrë parasysh llojin, moshën dhe vlerën prodhuese.
Humbje e të ardhurave	Të gjithë njerëzit e prekur nga projekti, të gjitha të ardhurat (punësimi, biznesi)	Për ndikim të përhershëm, kompensim në para. Për ndikim të përkohshëm, kompensimi në të holla i të ardhurave ose pagës neto për numrin e muajve të ndalimit të biznesit ose punësimit. Vlerësimi të bazohet në prova në letër ose dëshmi me gojë dhe konfirmim. Do të jepet së paku paga minimale e dekretuar nga qeveria.
Humbje e strukturave të komunitetit ose e infrastrukturës publike (përfshirë strukturat fetare dhe ato të shërbimit publik)	Publiku përmes udhëheqjes së autoritetit përkatës	Rindërtimi i strukturës së humbur në konsultim me komunitetin. Ato do të zëvendësohen ose rehabilitohen plotësisht për të përmbushur funksionet e tyre para-projektit duke marrë parasysh çdo nevojë të re të njohur që mund të rrisë përdorimin ose nivelet e shërbimit.
Shpenzimet për ndikime të rënda. Ndihma për rehabilitimin e PPP me më shumë se 10 përqind e pronarëve të tokës të prekur ose që duhet të zhvendosen	Të gjithë PPP të prekur rëndë përfshirë banuesit informalë dhe qiramarrësit e zhvendosur	Për ndikime të rënda në tokë, një pagesë shtesë e barasvlershme me vlerën e tregut të tokës për një vit. Për ata që zhvendosen një pagesë rehabilitimi.

Shpenzime për zhvendosje (kostot e transportit dhe ndryshimit)	Të gjithë personat e prekur nga projekti	Dhënia e fondeve për të mbuluar shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e jetesës deri në një kohë të përcaktuar me ligj ose siç është rënë dakord.
Ndihma për njerëzit veçanërisht të prekshëm	Veçanërisht të prekshëm' përfshijnë familjet me kryefamiljar një prind të vetëm, grua ose e ve; që përfshijnë një grua shtatzënë ose një grua me fëmijë të sapo lindur; dhe që kanë një anëtar të familjes që ka një paaftësi, sëmundje afatgjatë ose që ka sfida të	Pagesë e barasvlershme me 6 muaj të pagës mesatare vjetore dhe përparësi punësimi për një anëtar të familjes në punë të lidhura me projektin.

	lëvizjes.	
	Ndikimet e paparashikuara	Do të dokumentohen dhe zbuten ose kompensohen në PVZh, bazuar në parimet në këtë KPZ.

7. Verifikimi

Programi do të monitorojë dhe verifikojë të gjitha blerjet e tokës për përthushmëri me KMS dhe KPZh dhe përafrim me standardet e masave mbrojtëse të AFD-së dhe FKgj-së, përmes proceseve të veta ose përmes një agjencie të pavarur. Ky proces do të auditojë dokumentacionin dhe do të intervistojë pronarët e tokave dhe përdoruesit e prekur të tokës / burimeve për të verifikuar si procesin ashtu edhe rezultatet. Çdo mospërputhje dhe mospërputhshmëri do të sillet në vëmendjen e AFD-së dhe do të regjistrohet si ankesë në MA për t'i gjetur më pas zgjidhjen përmes këtij procesi.

Shtojca 7 – Kushtet e Referencës dhe TR për Plan Veprimi për Zhvendosje (PVZh) ose Plan të Rikthimit të Mjeteve të Jetesës (PRMJ)

Tabela treguese e përmbajtjes për një studim TR

1. Sfondi dhe hyrja

2. Objektivat e studimit:

a) të përcaktojë nëse kërkohet një Plan Veprimi për Zhvendosje (PVZh) ose një Plan për Rivendosjen e Mjeteve të Jetesës (PRMJ);

b) të studiohet zhvendosja fizike dhe ekonomike e projektit;

c) të vlerësohen alternativat e projektit për të minimizuar ndikimet;

d) të përcaktohet strategjia për blerjen e tokës dhe zhvendosjen, përfshirë ndarjen e roleve dhe përgjegjësive midis klientit, konsulentëve të jashtëm dhe qeverisë; dhe

e) të përgatiten Kushtet e Referencës për një PVZh/PRMJ.

3. Diapazoni i Punës:

a) Detyra 1: shqyrtimi i nevojave të tokës për projektin dhe vlerësimi i alternativave të projektit;

b) Detyra 2: profilizimi i njerëzve të prekur dhe shqyrtimi i disponueshmërisë së tokës / burimeve zëvendësuese;

c) Detyra 3: identifikimi dhe vlerësimi i vendeve të zhvendosjes;

d) Detyra 4: vlerësimi i alternativave të hartimit;

e) Detyra 5: përcaktimi i kuadrit ligjor;

f) Detyra 6: hartimi i procedurës së ankesave të komunitetit; dhe

g) Detyra 7: përafrimi me qeverinë për mënyrat e blerjes së tokës dhe qasjet dhe strategjitë për zhvendosjen.

4. Programi dhe buxheti

5. Produktet e dorëzueshme.

TR për PVZh/PRMJ

1 Sfondi dhe hyrja

Kjo pjesë do të paraqesë një përmbledhje të përgjithshme të projektit të propozuar për sa i përket zhvilluesit të projektit, përbërësve të projektit dhe ndikimeve të tokës, bazuar në gjetjet e Raportit të Studimit.

2 Objektivat e PVZH/PRMJ

Klienti për të konfirmuar standardet e zbatueshme që do të miratohen nga blerja e tokës dhe ushtrimi i zhvendosjes, zakonisht kjo është rregullorja kombëtare dhe kërkesat e huadhënësve. Objektivat e PVZh / PRMJ përfshijnë:

- të shmangë, dhe kur shmangia nuk është e mundur, minimizojë zhvendosjen duke eksploruar plane alternative të projekteve.
- të shmangë dëbimin e detyruar.
- të parashikojë dhe shmangë, ose kur shmangia nuk është e mundur, minimizojë ndikimet e papëlqyeshme sociale dhe ekonomike nga blerja e tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës duke (i) siguruar

kompensim për humbjen e aseteve me koston e zëvendësimit; dhe (ii) duke siguruar që aktivitetet e zhvendosjes të zbatohen duke ndarë informacionin e duhur, dhënë konsultim dhe ofruar pjesëmarrje të informuar të të prekurve.

- të përmirësojë, ose rivendosë, jetesën dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur.

3 Kërkesat e përgjithshme të kontraktuesit

3.1 Aftësitë dhe Përbërja

Kontraktuesi i PVZh-së do të sigurojë një ekip me aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat për të arritur një plan veprimi të zhvendosjes që plotëson kërkesat e përshkruara më poshtë. Ekipi do të përfshijë ekspertë me ekspertizë të demonstruar në fushat e mëposhtme: zhvendosje, specialist socio-ekonomie, planifikues i përdorimit të tokës, konsultim publik.

3.2 Korniza kohore

Kjo pjesë do të përshkruajë kërkesat e kornizës kohore për përgatitjen e PVZh/PRMJ.

4 Fushat dhe detyrat

4.1 Menaxher Projekti

Konsulent për të emëruar një Menaxher Projekti me përvojë të gjerë në përgatitjen e PVZh/PRMJ që plotëson kërkesat e vendit pritës dhe standardet e zbatueshme ndërkombëtare. Menaxheri i Projektit do të jetë përgjegjës për zbatimin e përditshëm të punës sipas PVZh/PRMJ përfshirë përditësimet e rregullta të Klientit dhe dorëzimin në kohë të produkteve përfundimtare.

4.2 Përshkrimi i Kuadrit Rregullator

• Identifikimi i kërkesave ligjore kombëtare, rajonale të blerjes së tokës dhe zhvendosjes, procedurat e lejimit dhe të drejtat e kompensimit.

• Identifikimi i kërkesave ndërkombëtare për financim;

• Identifikimi dhe plotësimi i boshllëqeve midis dy pikave të sipërpërmendura dhe të deklarojë strategjitë e blerjes së tokës dhe zhvendosjes.

4.3 Ndikimet e Projektit

• Identifikimi i llojeve të përdorimit të tokës në projekt (përfshirë kufizimin e hyrjes në tokë), të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, të përhershme dhe të përkohshme.

• Përgatitja "tabela ndikimi" që japin me hollësi secilën kategori të tokës, pasurive dhe personave të prekur.

• Dokumentimi i procesit dhe rezultateve të minimizimit të zhvendosjes së projektit.

4.4 Identifikimi i njerëzve dhe komunitetit të prekur

Identifikon njerëzit dhe komunitetin e prekur nga projekti përmes sondazheve në terren:

- Regjistrim për të numëruar të gjithë njerëzit e prekur dhe regjistrimin e tyre sipas vendndodhjes;
- Inventar i pasurive të humbura dhe të prekura në familje, ndërmarrje dhe komunitet;
- Sondazhe dhe studime socio-ekonomike të të gjithë personave të prekur (përfshirë këtu migrantët dhe komunitetet pritëse);
- Analizë e sondazheve dhe studimeve për të vendosur parametrat e kompensimit, për të hartuar iniciativat e duhura për rivendosjen e të ardhurave dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të identifikuar treguesit bazë të monitorimit; dhe
- Konsultim me popullatat e prekura në lidhje me zbutjen e efekteve dhe mundësitë e zhvillimit.

4.5 Angazhimi i Palëve të Interesit dhe ekspozimi publik

Identifikimi i aktorëve kryesorë të interesit dhe zhvillimi i strategjive të veçanta për angazhimin gjatë gjithë procesit të PVZh/PRMJ. Shënim: përfshihen komunitetet pritëse nëse zhvendosja fizike kërkon një vend të zhvendosjes. Klienti do të bëjë listën e kërkesave për ndarjen e informacionit në këtë pjesë.

4.6 Kriteret e Kualifikimit dhe Kompensimi

Konsulenti do të:
• vendosë kritere për përcaktimin e kualifikimin për zhvendosjen për familjet e prekura. Kriteret e pranueshmërisë duhet të jenë të favorshme për gratë dhe grupet e tjera të cenueshme, përfshirë ato pa titull ligjor të pasurive. Kriteret e pranueshmërisë do t'u bëhen me dije komuniteteve të prekura dhe palëve të tjera të interesit të Projektit si pjesë e Detyrës 5 më lart. Reagimet nga procesi i ndarjes së informacionit do të përdoren gjatë shpërndarjes së kompensimit dhe / ose rivendosjes së mjeteve të jetesës.
• përgatisë një matricë të të drejtave duke renditur të gjitha ndikimet e mundshme që identifikojnë:
- Të gjitha kategoritë e personave të prekur;
- Të gjitha llojet e humbjeve të ndara sipas çdo kategorie; dhe
- Të gjitha llojet e kompensimeve dhe asistencës sipas çdo kategorie.

• përgatisë standardet për kompensimin dhe rivendosjen e mjeteve të jetesës. Përgatitja e një formule për përcaktimin e vlerave zëvendësuese për pasuritë e humbura, përfshirë tokën. Përcaktimi i varianteve për zëvendësime të pranueshme kulturore për shërbimet e humbura, vendet kulturore, pasurinë e përbashkët ose qasjen në burime për jetesë, të ardhura ose aktivitete kulturore.
• përgatisë variantet për zhvendosjen dhe rivendosjen e të ardhurave të cilat bazohen në parametrat ekzistues socialë, ekonomik dhe kulturorë si për personat e zhvendosur ashtu edhe për komunitetet pritëse. Sigurimi i kostove të zhvendosjes, të ardhurat e humbura dhe mbështetjen e të ardhurave gjatë ndryshimit. Kur është e përshtatshme, përgatitja e planeve të zhvendosjes përfshirë përzgjedhjen dhe përgatitjen e vendeve të zhvendosjes. Marrja e masave për pronësinë e tokës, zotërimin dhe transferimin, dhe qasjen në burime.
• Aty ku të ardhurat duhet të rikthehen, konsulenti duhet të kryejë vlerësimin e nevojave, krijimin e punësimit dhe disbursimin e kredisë. Aty ku njerëzit e prekur do të ndryshojnë profesionin e tyre, duhet të sigurojë trajnim dhe mekanizma të mbështetjes profesionale. Të rishikojë ndikimin e mundshëm mjedisor të procesit të zhvendosjes dhe ndërtojë plane për të zbutur efektet e papëlqyeshme mjedisore.
• sigurojë masa të veçanta për grupet e cenueshme.

4.7 Mekanizmi i Ankesave
Zhvillimi i një mekanizmi për ankesa dhe mosmarrëveshje si pjesë e PVZh/PRMJ. Procesi do të përshkruajë qartë se si personat e prekur do të kërkojnë dëmshpërblim për ankesat në lidhje me ndonjë aspekt të PVZh/PRMJ. Procesi duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë grave dhe anëtarëve të grupeve të cenueshme për t'u siguruar që ato të kenë qasje të barabartë në procedurat e zgjidhjes së ankesave.
4.8 Marrëveshja e Zbatimit
Përgatitja e një kornizë kohore dhe kalendarit të zbatimit për blerjen e tokës dhe zhvendosjen së bashku me afatin e rënë dakord të zbatimit për përbërësit e projektit, duke treguar se si do të informohen njerëzit e prekur.
4.9 Monitorimi dhe Vlerësimi
Përgatitja e një plani monitorimi dhe vlerësimi, duke identifikuar përgjegjësitë, kornizën kohore dhe disa tregues kryesorë. Këtu do të përfshihet monitorimi i vazhdueshëm nga agjencitë kryesore ndjekur nga një vlerësim i pavarur. Specifikimi i kornizës kohore për monitorimin dhe raportimin.
4.10 Buxheti
Përgatitja një buxhet tregues. Identifikimi i treguesve të blerjes së tokës dhe kostot e zhvendosjes. Përgatitja e alokimit të buxhetit dhe koha. Specifikimi i burimeve të financimit dhe procesit të

miratimit. Përgatitja e një vlerësimi vjetor të buxhetit për zhvendosje sipas kategorisë kryesore të shpenzimeve

5 Produktet e dorëzueshme

Paraqitja e kërkesave dhe afatit kohor për të gjitha produktet.

Shtojca 8 – Kuadri i Planifikimit për Popujt Autoktonë

1. Objektivat dhe Parimet Baze

Ky kuadër i planifikimit për popujt autoktonë (KPPA) do të zbatohet kur popujt autoktonë (PA) janë të pranishëm në zonën e ndikimit të një nënprojekti sipas identifikimit gjatë procesit të shqyrtimit social dhe mjedisor ose më pas gjatë VNMS-së. Zhvilluesit e nënprojekteve dhe EZ-të janë përgjegjës për zbatimin e veprimeve të nevojshme për të përmbushur kërkesat e përshkruara nga ky kuadër.

Nuk ka përkufizim të pranuar botërisht për Popujt Autoktonë. Popujt autoktonë mund të njihen në vende të ndryshme me terma të tillë si pakica etnike autoktone, autoktonë, fise kodrash, kombësi pakicash, fise të planifikuara, kombe të para ose grupe fisnore. Politika e Popujve Autoktonë e FKGj-së siguron përkufizimin dhe zbatueshmërinë e dispozitave që lidhen me popujt autoktonë për projektet që do të mbështeten nga FKGj-ja. Ky KPPA i referohet politikës së popujve autoktonë të FKGj-së, duke njohur përkufizimin e ndryshëm dhe merr parasysh kriteret e pranuara dhe të zbatuara zakonisht për identifikimin e popujve autoktonë, duke respektuar vetë-identifikimin si autokton ose fisnor si kriter themelor për përcaktimin e zbatimit të tij.

2. Kërkesat e përgjithshme të KPPA

Zhvilluesit e nënprojekteve dhe EZ-të do të identifikojnë, përmes kontrollit social dhe mjedisor dhe VNMS-së, komunitetet e popujve autoktonë që mund të jenë të pranishëm në zonën e ndikimit të nënprojektit, si edhe natyrën dhe shkallën e ndikimeve të pritshme sociale, ndikimet në burimet kulturore fizike, ndikimet në mjedis, si edhe përfitimet e mundshme për Popujt Autoktonë. Zhvilluesit e nënprojekteve do të vendosin të gjitha masat e nevojshme për të shmangur ndikimet e papëlqyeshme për popujt autoktonë. Kur shmangia nuk është e realizueshme, nënprojektet do të minimizojnë, zbutin ose kompensojnë këto ndikime në mënyrë të përshtatshme kulturore. Veprimet e propozuara do të zhvillohen me pjesëmarrjen e informuar të Popujve Autoktonë të prekur dhe do të përfshihen në një Plan të Popullit Autokton të kufizuar në kohë (PPA), ose në një plan më të gjerë të zhvillimit të komunitetit, në varësi të natyrës dhe shkallës së ndikimeve. Kur nënprojekti konsiderohet me ndikim të lartë për shkak të rrezikut tjetër të mundshëm siç është konflikti rreth burimeve natyrore, nënprojekti duhet të përfshijë masa për marrjen e pëlqimit të lirë, paraprak dhe të informuar dhe një proces të rënë dakord për ruajtjen e këtij pëlqimi për nënprojektin para fillimit të nënprojektit.

Nënprojektet do të vendosin marrëdhënie të vazhdueshme me popujt autoktonë dhe komunitetet e prekura sa më shpejt të jetë e mundur në planifikimin e nënprojekteve dhe gjatë gjithë jetës së nën-projektit. Përmes asistencës teknike të Programit (AT), specialistët mund të angazhohen për të ndihmuar zhvilluesit e nënprojekteve dhe EZ-të për të hartuar dhe zbatuar qasje të përshtatshme konsultimi. Nënprojektet me komunitetet autoktone në zonën e projektit, procesi i konsultimit do të sigurojë pëlqimin e tyre të lirë, paraprak dhe të informuar (PLPI) dhe do të lehtësojë pjesëmarrjen e informuar të komuniteteve për çështje që i prekin ato, të tilla si masat e propozuara për zbutjen e ndikimit, ndarjen e përfitimeve të zhvillimit dhe mundësitë dhe çështjet e zbatimit. Procesi i angazhimit të komunitetit do të duhet të jetë i përshtatshëm nga ana kulturore dhe të korrespondojë me rreziqet dhe ndikimet e mundshme për popujt autoktonë. Në veçanti, procesi do të përfshijë hapat e mëposhtme:

(a) përfshirjen e përfaqësuesve ose organeve përfaqësuese të popujve autoktonë siç janë këshillat, pleqtë, etj .;

(b) sigurinë se konsultimi do të përfshijë gra, burra dhe grupmosha të ndryshme;

(c) sigurimin e kohës së mjaftueshme për procesin e vendimmarrjes kolektive;
(d) lehtësimin e shprehjes së pikëpamjeve, shqetësimeve dhe propozimeve në gjuhën e zgjedhur prej tyre, pa manipulime të jashtme, ndërhyrje ose detyrime, dhe pa kërcënime;
(e) sigurinë se mekanizmi i ankesave i vendosur për projektin është i përshtatshëm nga ana kulturore dhe i arritshëm për komunitetet e popujve autoktonë; dhe
(f) sigurinë se PPA-ja dhe planet e tjera si edhe dokumentet e projektit janë në dispozicion të popujve autoktonë dhe komuniteteve të prekura në formë, mënyrë dhe gjuhë të përshtatshme.
Qëllimi është marrja e aprovimit të lirë, paraprak dhe të informuar për nënprojektet. Ky përcaktim përgjithësisht bazohet në shprehjen kolektive dhe të evidentuar të pikëpamjeve mbështetëse në lidhje me qëllimet, planet dhe rregullimet e zbatimit të nënprojekteve. Ky përcaktim nuk kërkon unanimitet pasi mbështetja mund të ekzistojë edhe kur ka mosmarrëveshje të brendshme brenda komunitetit ose kur ka kundërshtim të kufizuar për qëllimet e nënprojekteve ose rregullimet e propozuara. PPA-ja në nivelin e nënprojekteve do të përshkruajë bazën e përcaktimit, si edhe procesin e konsultimit të ndërmarrë.
Kërkesat për aprovim të lirë, paraprak dhe të informuar përshkruhen në standardin e mbrojtjes së AFD-së dhe FKGj-së për popujt autoktonë dhe përafrohen me kërkesat e politikës së popujve autoktonë të FKGj-së.

3. Përfitimet e zhvillimit
Përmes procesit PLPI dhe pjesëmarrjes së informuar të komuniteteve të PA-ve të prekura, nënprojektet do të identifikojnë mundësitë për përfitime të përshtatshme kulturore të zhvillimit. Mundësitë e tilla duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e ndikimeve të projektit, që synojnë përmirësimin e standardeve të jetesës së tyre dhe të jetesës në një mënyrë të përshtatshme kulturore, dhe nxitjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të burimeve natyrore nga të cilat varen. Përfitimet dhe procesi i rënë dakord për ndarjen e përfitimeve do të dokumentohen përmes PPA-së dhe do t'u jepen popujve dhe komuniteteve autoktone në kohë dhe në mënyrë të drejtë për të ndihmuar në diskutim dhe vendimmarrje.

4. Plani i Zhvillimit të Popujve Autoktonë
Aty ku identifikohen popuj dhe komunitete autoktone në zonën e projektit përmes procesit të shqyrtimit, do të përgatitet një PPA nga zhvilluesit e nënprojekteve. PPA-ja do të përbehet nga një vlerësim social dhe ekonomik, si pjesë e VNMS-së, dhe proceset e konsultimit. Plani do të përcaktojë masat përmes të cilave nënhuamarrësit do të sigurojnë që (a) popujt autoktonë të prekur nga nënprojektet të marrin pjesë në përfitime të përshtatshme shoqërore dhe ekonomike kulturore; dhe (b) nëse identifikohen efektet e mundshme anësore mbi popujt autoktonë, ato efekte anësore do të shmangen, minimizohen, zbuten ose kompensohen. PPA-ja do të sigurojë kontribut të rëndësishëm për hartimin dhe strukturën e nënprojekteve. Përmbajtjet treguese të një PPA-je janë të përfshira në Shtojcën 7 të KMS.
5. Vlerësimi Social
Vlerësimi social do të përfshijë elementet e mëposhtme, sipas lidhjes:
(a) përshkrimi i nënprojekteve dhe çështjeve të mundshme ose ndikimeve në komunitetet, përfshirë popujt autoktonë, duke treguar nëse ka nëngrupe të tilla si popujt autoktonë që mund të preken ndryshe;
(b) identifikimin e komuniteteve përkatëse dhe palëve të tjerë kryesore të interesit që do të konsultohen;

(c) informacionin bazë për karakteristikat demografike, sociale, kulturore dhe ekonomike të komuniteteve përkatëse;
(d) vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative dhe përfitimet që mund të shoqërohen me projektin, përfshirë pikëpamjet mbi ato që rrjedhin nga konsultimet; dhe
(e) përmbledhjen e preferencave dhe shqetësimeve të komuniteteve në lidhje me objektivat e projektit, aksesin dhe përshtatshmërinë kulturore të përfitimeve të projektit, zbutjen e çdo ndikimi të papëlqyeshëm dhe rregullimet e zbatimit të projektit.

6. Kërkesa të veçanta

Për shkak se popujt autoktonë mund të jenë veçanërisht të prekshëm nga rrethanat e nënprojekteve, do të kërkohen kërkesa të përshtatshme siç janë ato që lidhen me adresimin e ndikimeve në tokat tradicionale dhe zakonore, zhvendosjen e popujve autoktonë dhe burimet kulturore. Kur zbatohet ndonjë prej këtyre rasteve të veçanta, Programi do të angazhojë ekspertë të jashtëm të kualifikuar përmes asistencës teknike të tij (AT) për të ndihmuar në kryerjen e vlerësimit shoqëror dhe sigurimin e përfshirjes së tyre si duhet në PPA ose në planin e zhvillimit të komunitetit.
(a) Ndikimet në tradita ose zakone
Popujt autoktonë janë të lidhur me tokat e tyre zakonore dhe burimet natyrore dhe kulturore në tokë. Përdorimi i tokës, përfshirë përdorime sezonale ose ciklike, nga popujt dhe komunitetet autoktone për jetesën e tyre, ose qëllime kulturore, ceremoniale ose shpirtërore që përcaktojnë identitetin dhe bashkësinë e tyre, mund të vërtetohen dhe duhet të dokumentohen siç duhet. Nëse vendndodhja e nënprojekteve vendoset të jetë në tokë tradicionale ose të zakonshme dhe priten ndikime të papëlqyeshme në mjetet e jetesës ose përdorime kulturore, ceremoniale ose shpirtërore që përcaktojnë identitetin dhe bashkësinë e popujve autoktonë, zhvilluesit e nënprojekteve do të sigurojnë që procesi i blerjes së tokës respekton përdorimin e tokës prej tyre. Kjo do të bëhet duke marrë masat e mëposhtme:
(i) zhvilluesit e nënprojekteve do të dokumentojnë përpjekjet për të shmangur ose të paktën minimizuar gjurmën e propozuar të nënprojekteve;
(ii) ekspertët do të angazhohen për të dokumentuar përdorimet e tokës në bashkëpunim me komunitetet e prekura të popujve autoktonë pa paragjykuar pretendimin e tyre për tokë;
(iii) komunitetet e prekura të popujve autoktonë janë të informuar për të drejtat e tyre në lidhje me tokën e tyre sipas ligjeve kombëtare, veçanërisht ato që njohin të drejta zakonore ose përdorim;
(iv) nënprojektet mund t'u ofrojnë komuniteteve të prekura autoktone kompensim të drejtë dhe proces të rregullt siç janë mekanizmat e ndarjes së përfitimeve; dhe/ose kompensim i bazuar në tokë dhe/ose në natyrë në vend të kompensimit në para kur është e mundur; dhe
(v) zhvilluesit e nënprojekteve hyjnë në negociata me mirëbesim me komunitetet e prekura të popujve autoktonë dhe dokumentojnë pjesëmarrjen e tyre të informuar dhe rezultatet e konsultimeve.
(b) Zhvendosja e popujve autoktonë

Zhvilluesit e nënprojekteve dhe EZ-t ë do të marrin në konsideratë planet alternative të nënprojekteve për të shmangur zhvendosjen e popujve autoktonë nga toka e tyre tradicionale ose zakonore e mbajtur në bashkësi. Nëse zhvendosja e tillë është e pashmangshme, nënprojektet nuk do të vazhdojnë, përveç rasteve kur ka pasur negociata me mirëbesim dhe dokumentim të aprovimit të lirë, paraprak dhe të informuar (PLPI) si rezultat i negociatave dhe i vërtetuar nga EZ-ja dhe AFD-ja. Çdo zhvendosje e Popujve Autoktonë do të duhet të jetë në përputhje me standardet e AFD-së dhe

Fkgj-së për blerjen e tokës dhe zhvendosjen e pavullnetshme. Mundësia që popujt autoktonë të zhvendosen në tokën e tyre, nëse arsyeja për zhvendosjen e tyre nuk vlen më, duhet të ruhet gjatë gjithë ciklit të projektit.

(c) Burimet kulturore

Kur një nënprojekt propozon të përdorë burimet kulturore, njohuritë ose praktikat e popujve autoktonë për qëllime tregtare, nënprojektet do të dokumentojnë dhe informojnë popujt dhe komunitetet autoktone për: (ii) fushëveprimin dhe natyrën e zhvillimit të propozuar tregtar; dhe (iii) pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë. Nënprojektet nuk do të vazhdojnë me një komercializim të tillë përveç nëse: (i) hyn në negociata me mirëbesim me pojt dhe komunitetet e prekura autoktone; (ii) dëshmojnë pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar si rezultat i negociatave dhe një aprovim i tillë të vërtetohet nga EZ-ja dhe AFD-ja; dhe (iii) parashikon ndarjen e drejtë të përfitimeve.

Shtojca 9 – Skica treguese e Planit të Popujve Autoktonë (PPA)

A. Përmbledhja ekzekutive e planit të popujve autoktonë: përshkruan në mënyrë të përmbledhur faktet kryesore, gjetjet domethënëse dhe veprimet e rekomanduara
B. Përshkrimi i projektit: Përshkrimi i përgjithshëm i projektit, zona e projektit dhe përbërësit/veprimtaritë që mund të çojnë në ndikime në popujt autoktonë
C. Përshkrimi i popujve autoktonë: Një përshkrim i njerëzve autoktonë të prekur dhe vendndodhjet e tyre, përfshirë:

i. përshkrimin e komunitetit ose bashkësive që përbëjnë popujt e prekur (p.sh. emrat, etnitë, dialektet, numrin e vlerësuar të tyre, etj.);
ii. përshkrimin e burimeve, tokave dhe zonave territoriale që do të preken dhe lidhjet/marrëdhëniet e popujve të prekur me ato burime, toka dhe territore; dhe
iii. identifikim të çdo grupi të prekshëm brenda popujve të prekur (p.sh. popuj të pakontaktuar dhe të izoluar me vullnetin e tyre, gra dhe vajza, me aftësi të kufizuara dhe të moshuar, të tjerë).

D. D. Përmbledhje e të Drejtave Themelore dhe Kuadri Ligjor: përshkrim i të drejtave themelore të popujve autoktonë dhe kuadri ligjor në fuqi, përfshirë:

i. Analizë të ligjeve të zbatueshme vendore dhe ndërkombëtare që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e popujve autoktonë (përfshirë vlerësimin e përgjithshëm të zbatimit të qeverisë për të njëjtën).
ii. Analizë nëse Projekti përfshin veprimtari që varen nga vendosja e të drejtave të njohura ligjërisht për tokat, burimet ose territoret që popujt autoktonë tradicionalisht kanë në pronësi, kanë pushtuar apo përdorur ose blerë. Aty ku ekziston një situatë e tillë e paparashikuar (shih shënimin udhëzues të standardit 6, pjesët 6 dhe 7), përfshirë:
   a) identifikimin e hapave dhe afatit përkatës për arritjen e njohjes ligjore të pronësisë, profesionit ose përdorimit të tillë me mbështetjen e autoritetit përkatës, përfshirë mënyrën në të cilën caktimi i kufirit dhe titullit do të respektojë zakonet, traditat, normat, vlerat , sistemet e zotërimit të tokës dhe pjesëmarrjen e efektshme dhe domethënëse të popujve të prekur, me njohjen ligjore të dhënë për titujt me aprovimin e plotë, paraprak dhe të informuar të popujve të prekur; dhe
   b) listën e veprimtarive që janë të ndaluara derisa të përfundojë përcaktimi i kufijve dhe titulli.
iii. Analizë nëse Projekti përfshin veprimtari që varen nga njohja e personit juridik të Popujve Autoktonë të prekur. Kur ekziston një situatë e tillë e paparashikuar, duhet të bëhet:
   a) identifikimi i hapave dhe afateve shoqëruese për arritjen e një njohjeje të tillë me mbështetjen e autoritetit përkatës, me pjesëmarrjen dhe pëlqimin e plotë dhe të efektshëm të popujve autoktonë të prekur; dhe
   b) lista e veprimtarive që janë të ndaluara derisa të arrihet njohja.

E. Përmbledhje e Masave të Vlerësimit dhe Zbutjes Sociale dhe Mjedisore

i. Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve të studimeve të kërkuara paraprake të ndikimit social dhe mjedisor (p.sh. vlerësimi i kufizuar, VNMS, VSMS, sipas vlefshmërisë) - specifikisht ato që lidhen me popujt autoktonë, të drejtat e tyre, tokat, burimet dhe territoret. Kjo duhet të përfshijë mënyrën në të cilën popujt autoktonë të prekur kanë marrë pjesë në një studim të tillë dhe pikëpamjet e tyre mbi mekanizmat e pjesëmarrjes, gjetjet dhe rekomandimet.
ii. Kur identifikohen rreziqet e mundshme dhe ndikimet e papëlqyeshme për popujt autoktonë, tokat, burimet dhe territoret e tyre, detajet dhe afatet kohore të ndërlidhura për masat e

planifikuara për të shmangur, minimizuar, zbutur ose kompensuar për këto efekte anësore. Identifikimi i masave të veçanta për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e popujve autoktonë, përfshirë pajtueshmërinë me normat dhe zakonet e brendshme të njerëzve të prekur.

iii. Nëse Projekti do të rezultojë në zhvendosjen e popujve autoktonë nga tokat dhe territoret e tyre, përshkrim i procesit të konsultimit dhe PLPI që çon në marrëveshjen që rezulton për zhvendosjen dhe kompensimin e drejtë, përfshirë mundësinë e kthimit.

iv. Përshkrim i masave për të mbrojtur njohuritë tradicionale dhe trashëgiminë kulturore në rast se Projekti do të rezultojë në dokumentimin dhe/ose përdorimin dhe përvetësimin e njohurive dhe trashëgimisë së tillë të popujve autoktonë dhe hapat për të siguruar PLPI para se të ndodhë kjo

F. Pjesëmarrja, Konsultimi dhe Proceset e PLPI

i. Përmbledhje e rezultateve të konsultës së përshtatshme kulturore dhe, kur kërkohet, proceseve të PLPI të ndërmarra me popujt e prekur që kanë çuar në mbështetjen e popujve autoktonë për Projektin.

ii. Përshkrim i mekanizmave për të kryer procese përsëritëse të konsultimit dhe aprovimit gjatë gjithë zbatimit të Projektit. Identifikoni aktivitetet e veçanta të Projektit dhe rrethanat që do të kërkojnë konsultim dhe FPIC.

G. Përfitimet e duhura: Një identifikim i masave që duhen marrë për të siguruar që popujt autoktonë të marrin përfitime të barabarta shoqërore dhe ekonomike që janë të përshtatshme nga ana kulturore, duke përfshirë një përshkrim të proceseve të konsultimit dhe pëlqimit që çojnë në aranzhimet e përcaktuara të ndarjes së përfitimeve.

H. Mbështetje me kapacitete

i. Përshkrimi i veprimtarive të Projektit që synojnë rritjen e kapacitetit brenda qeverisë dhe/ose popujve autoktonë të prekur, dhe lehtësimin e shkëmbimeve, ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit midis të dyve.

ii. Përshkrimi i masave për të mbështetur aftësitë sociale, ligjore, teknike të organizatave të popujve autoktonë në zonën e projektit për t'i mundësuar ata që të përfaqësojnë më mirë popujt autoktonë të prekur në mënyrë më të efektshme

iii. Ku është e përshtatshme dhe e kërkuar, përshkrimi i hapave për të mbështetur aftësitë teknike dhe ligjore të institucioneve përkatëse qeveritare për të forcuar përputhshmërinë me detyrat dhe detyrimet e vendit sipas ligjit ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e popujve autoktonë.

I. Zgjidhja e ankesave: Përshkrim i procedurave të disponueshme për të adresuar ankesat e sjella nga popujt autoktonë të prekur që vijnë nga zbatimi i Projektit, përfshirë mjetet juridike në dispozicion, mënyra si mekanizmat e ankesave marrin parasysh ligjet zakonore të popujve autoktonë dhe proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe kapaciteti i efektshëm i popujve autoktonë sipas ligjeve kombëtare për të denoncuar shkeljet dhe për të siguruar mjete juridike për të njëjtën gjë në gjykatat e brendshme dhe proceset administrative.

J. Monitorimi, Raportimi, Vlerësimi

i. Mekanizmat dhe standardet e përshtatshme për Projektin për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e përbashkët transparent, me pjesëmarrje, përfshirë një përshkrim të përfshirjes së popujve autoktonë të prekur.

ii. Përcakton mekanizmat e vendosur për të lejuar rishikimin periodik të PPA-së në rast se rrethanat e reja të Projektit kërkojnë modifikime të zhvilluara përmes proceseve të konsultimit dhe aprovimit me popujt autoktonë të prekur.

K. Marrëveshjet Institucionale: Përshkruan përgjegjësitë e marrëveshjeve institucionale dhe mekanizmat për plotësimin e kushteve të përfshira në PPA, përfshirë mekanizmat pjesëmarrëse të popujve autoktonë të prekur. Përshkruan rolin e enteve të pavarura, të paanshme për të audituar, kryer vlerësime sociale dhe mjedisore siç kërkohet, dhe/ose për të kryer mbikëqyrjen e projektit.

L. Buxheti dhe Financimi: Një plan me kosto të përshtatshme, me buxhet të ndarë të mjaftueshëm për të ndërmarrë në mënyrë të kënaqshme aktivitetet e përshkruara.

Shtojca 10 – Skica treguese e angazhimit të palëve të interesuara

Angazhimi i palëve të interesit do të kryhet në përputhje me Standardet MS të Grupit të Bankës Botërore:
http://www.worldbank.org/en/projects-operations/environmental-and-social-framework/brEZf/environmental-and-social-standards#ess10

https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/938f1a0048855805beacfe6a6515bb18/IFC_StakeholderEngagement.pdf?MOD=AJPERES

1. Hyrje
1.1. Prezantimi i Projektit
1.2. Konteksti i Projektit
1.3. Parimet e angazhimit të palëve të interesit në lidhje me projektin

2. Rregulloret e zbatueshme në lidhje me angazhimin e palëve të interesit
2.1. Rregulloret e zbatueshme kombëtare dhe kërkesat përkatëse
2.2. Standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe kërkesat përkatëse
2.3. Standarde të zbatueshme të tjera

3. Analiza e grupeve të interesit të projektit
3.1. Qasja ndaj identifikimit të palëve të interesit
3.2. Përkufizimi dhe qasja e propozuar për grupet e palëve të interesit

4. Veprimtaritë në lidhje me angazhimin e palëve të interesit
4.1. Komunikimi dhe ndarja i informacionit për projektin dhe studimet përkatëse
4.2. Veprimtaritë e konsultimit të kryera deri më sot
4.3. Veprimtaritë dhe treguesit e monitorimit për angazhimin e palëve të interesit

5. Mekanizmi i zgjidhjes së ankesave
5.1. Parimet
5.2. Procedurat

6. Monitorimi dhe raportimi për veprimtaritë e angazhimit të palëve të interesit
6.1. Monitorimi
6.2. Raportimi i veprimtarive
6.3. Raportimi vjetor

Shtojcat
- Lista e palëve të interesit

- Skema e komunikimit dhe ndarjes së informacionit

- Skema e zgjidhjes së ankesave

Shtojca 11 _ Modeli i Planit të Angazhimit Mjedisor dhe Social (PAMS)

Tema	Veprimi	Burimet dhe përgjegjësitë	Financimi	Kronogrami dhe afatet	Treguesi i arritjeve
1. Vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve dhe ndikimeve MS					
2. Kushtet e punës					
3. Efiçenca e Burimeve, Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes					
4. Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit					
5. Blerja e Tokës dhe Zhvendosja e Vullnetshme					
6. Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla					
7. Popujt Autoktonë					
8. Trashëgimia Kulturore					
9. Ndërmjetësit Financiarë					
10. Përhapja e informacionit dhe përfshirja e palëve të interesit					

Shtojca 12_ Udhëzime për raportin e monitorimit Mjedisor dhe Social

Udhëzime për raportin e monitorimit Mjedisor dhe Social

Lista e mëposhtme paraqet informacionin minimal që duhet të përfshihet në raportin e monitorimit mjedisor dhe social të projekteve. Qëllimi i këtij raporti është të sigurojë përputhshmërinë e projektit me kuadrin normativ të zbatueshëm, përfshirë rregulloren kombëtare (lejet mjedisore, ligji i punës ...)

Informacion i përgjithshëm, statusi i projektit dhe evoluimi i ndikimeve MS

- Emri dhe vendndodhja e projektit
- Periudha e raportimit
- Autorët e raportit (zotëruesi i projektit / inspektimi / konsulenti) dhe natyra e burimeve (auditimi i brendshëm, vizita në terren, dokumentacioni MS, raporti i monitorimit të ndërtimit, etj.)
- Statusi teknik i projektit dhe ndryshimet e mundshme në projektin fillestar (veprimtari të reja, shtrirja e zonës së ndikimit, zona të reja, mbyllja e zonës së punimeve)
- Numri i punonjësve gjatë periudhës raportuese duke specifikuar nëse ata janë burra / gra, të përhershëm / të përkohshëm, pronar i projektit / nënkontraktor.
- Çdo çështje e re mjedisore ose sociale e identifikuar dhe mënyra si është trajtuar ajo.

Përputhshmëria me zotimet MS

• Zbatimi i kushteve pararendëse dhe sipërmarrjeve MS

• Zbatimi i Planit të Zotimit Mjedisor dhe Social (PZMS) duke përdorur, për shembull, tabelën vijuese të dhënë më poshtë

• Zbatimi i masave të Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) dhe/ose Planit të Veprimit për Zhvendosje (PVZh), duke ndjekur procedurat e monitorimit të përcaktuara në këto dokumente

• Rezultatet e inspektimeve nga autoritetet vendore, nëse ka, ose të auditimit të palëve të treta

Raporti do të paraqesë mospërputhjet e identifikuara dhe masat përkatëse zbutëse ose korrigjuese, vështirësitë ose vonesat në zbatim, nëse vlen, si edhe progresin në masat e identifikuara më parë.

Tabela përcjellëse e Planit të Zotimit Mjedisor dhe Social (PZMS)

PZMS Origjinal			**Periudha e Monitorimit**		
Veprimi	Afati dhe përgjegjësia	Treguesi i arritjes	Statusi/komente për progresin	Në përputhshmëri/jo në përputhshmëri	Veprimi plotësues (përfshirë afatin dhe përgjegjësinë)

- **<u>Menaxhimi i performancave mjedisore dhe sociale</u>**

- Evoluimi i buxheteve të shpenzuara për çështje mjedisore dhe sociale dhe buxheti i përkohshëm për vitin e ardhshëm

- Ekipet përgjegjëse për temat MS (Menaxheri i MShS, Menaxheri i Burimeve Njerëzore; Menaxheri i Marrëdhënieve me Palët e Interesit, etj.) te zotëruesi i projektit, nënkontraktorët dhe kompanitë.

- Evoluimi i treguesve kryesorë mjedisorë dhe socialë të matur gjatë viteve / muajve të mëparshëm, siç janë:

o Numri i mospërputhshmërive

o Statistikat e mosmarrëveshjeve/aksidenteve midis zotëruesit të projektit dhe nënkontraktorëve (thuajse aksident, rastet e ndihmës së shpejtë / plagosje të lehta, incidente që rezultojnë në më shumë se tri ditë mungesë, fatkeqësi)

o Numri dhe lloji i ankesave

o Treguesit e identifikuar në PMMS/PVZh, të tilla si:

  - Matjet e zhurmës, analiza e cilësisë së ajrit, shkarkimet e ujërave të ndotura
  - Zbulimi arkeologjik
  - ...

• Analiza e efektshmërisë së masave të zbatuara, të ndikimeve të mbetura sociale dhe mjedisore dhe masave korrigjuese përkatëse të mundshme.

• Çdo politikë e sapo prezantuar MS ose ndryshimet e bëra në politikat ekzistuese dhe/ose nismat e përmirësimit MS (certifikimet ISO, auditime të jashtme, etj.)

<u>Ngjarjet kryesore MS</u>

Lloji i ngjarjes	**Po**	**Jo**
Fatkeqësi me viktima	☐	☐
Greva	☐	☐
Konflikte me komunitetet rreth e përqark	☐	☐
Ndotja (rrjedhjet, shpërthimet, derdhjet e pakontrolluara…)	☐	☐
Vëmendje negative në media	☐	☐
Paditë gjyqësore / procedurat e menaxhimit të ankesave nga AFD-ja	☐	☐
Të tjera	☐	☐

Rrethanat / veprimi përmirësues

Për çdo ngjarje madhore të përmendur më lart, jepni një shpjegim të hollësishëm të rrethanave (natyra, shkaqet themelore), pasojat dhe planin e veprimit të zbatuar ose që do të zbatohet (veprimet përmirësuese dhe parandaluese me burimet korresponduese dhe personat e ngarkuar).

Shtojcat

Bashkëngjitni fotografi, studime plotësuese ose ndonjë dokument tjetër që mund të ilustrojë masat e marra dhe të japë hollësi mbi informacionin e paraqitur dhe evoluimit e ndikimit MS të projektit.